

LE MONDE. *shqip* diplomatique

Lufta
njëzetvjeçare?
Nga Serge Halimi
/ Faqe 3

Nr. 796 / Viti i 67 i botimit / Gusht 2020

MARRËVESHJA KOSOVË-SERBI NË SHTËPINË E BARDHË

U dridh mali, polli miu!



NGA VISAR YMERI

Duke qenë një dakordim për zotime, ajo që po quhet marrëveshje nuk i vë pikën asnjë gjëje. Duke qenë tekst që mbulon fusha të ndryshme, pas asnjë lidhje logjike të njëres me tjetrën, ky tekst nuk e trajton asnjëherë prej pikave siç duhet. Duke pasur pika të cilat lidhen me raportet me Kosovës dhe Serbisë, pika që ndërlidhen me raportet mes Serbisë dhe SHBA-ve, të tilla që ndërlidhen me raportet (në ngjizje) mes Kosovës //faqe 2

MEKA E ZHYTUR NË TURIZMIM MASIV FETAR

Haxhi, nafta tjetër e sauditëve



Haxhi në Mekë, shtylla e pestë e Islamit, garanton të hyra të përjetshme për autoritetet saudite. Për të pritur një numër gjithnjë në rritje të vizitorëve, udhëheqësit wahhabi nuk hezitojnë ta shndërrojnë qytetin e shenjtë në një kantier të përhershëm ndërtimi, edhe nëse duhet ndryshuar pamja e vendit. Ambicia për të mirëpritur gjithnjë e më shumë haxhilerë, paraqet probleme serioze për shëndetin dhe sigurinë.

NGA MOHAMED LARBI BOUGUERRA

Mbretëria e Arabisë Saudite, eksportuesi më i madh i naftës në botë (10 milion fuçi në ditë), është gjithashtu djepi dhe qendra nevralgjike e Islamit. Është shteti

i vetëm me ulëse në Kombet e Bashkuara i cili mban emrin e një familje. Ky vend përvetëson ekskluzivitetin e shehadetit – të deklaruarit të fesë islame – të cilin e ka paraqitur në flamurin e tij,

për t'iu treguar 1.8 miliardë besimtarëve të identifikuar në të gjithë botën, se sovranët e këtij vendi janë "shërbëtorët e vendeve të shenjta". Meka ku lindi profeti Mohamed, kibla (drejtimi) e pesë lutjeve ditore dhe Medina ku ai

prehet, mbeten fusha ekskluzive të monarkut. Mjetet financiare kolosale të tërhequra nga arka e naftës konsolidojnë udhëheqjen fetare të mbretërisë mbi Umetin (komunitetin e besimtarëve), por monarkia e di se //faqe 3

Vështrim

Drejt paradigmës së ekonomisë qarkulluese

Nga Ditjon Baboçi / Faqe 7

B iologjikisht secilit prej nesh i nevojiten 90W energji për të jetuar, njësoj sa një llampë e thjeshtë inkandeshente. Por prej gati dy shekujsh si qenie urbane secili prej nesh konsumon mesatarisht 100 herë më shumë nga sa i nevojitet. Revolucioni industrial është pasuar nga një ortek inovacioni çka e ka shtyrë Paul Crutzen

Debat

Tingujt e tranzicionit

Nga Shkodran Hoti / Faqe 4-5

D uke qenë dy shtete të veçanta, Shqipëria dhe Kosova kanë edhe veçoritë e tyre, në fushën e jetës kulturore. Ideologjike, politike, kulturore dhe historike.

Kroaci

Konformizmi i artistëve ndaj së kaluarës socialiste

Intervistoi : Nikolla Radiq / Faqe 6

I lindur më 1972, Zhelko Lluketiç është një kritik, gazetar dhe kurator i ekspozitave të specializuara në muzikën dhe kinemanë jugosllave. Student i doktoratës në Departamentin e Letërsisë, Filmologjisë, Kulturës dhe Arteve Skenike të Fakultetit Filozofik

Kulturë

Për çka shërbejnë artistët?

Nga Evelyn Pieiller / Faqe 19

F enomenal: politikanët tanë e shohin sot artin me një sy shumë të mirë. Si duket kjo është madje edhe zgjidhja, mrekulli e problemeve të shkaaktuara ose të zmadhuara nga « kriza » sanitare dhe sociale e sotme. Ne jse, mos ta teprojmë,

MARRËVESHJA KOSOVË-SERBI NË SHTËPINË E BARDHË

U dridh mali, polli miu!



Duke qenë një dakordim për zotime, ajo që po quhet marrëveshje nuk i vë pikën asnjë gjëje. Duke qenë tekst që mbulon fusha të ndryshme, pas asnjë lidhje logjike të njëres me tjetrën, ky tekst nuk e trajton asnjëherë prej pikave siç duhet. Duke pasur pika të cilat lidhen me raportet me Kosovës dhe Serbisë, pika që ndërlidhen me raportet mes Serbisë dhe SHBA-ve, të tilla që ndërlidhen me raportet (në ngjizje) mes Kosovës dhe Izraelit, pika që flasin për raportin që Serbia ka vendet e treta (p.sh. Kina), etj, ky tekst nuk ka se si të përfundojë ndryshe përveç se i nënshkruar nga secili përfaqësues me veten.

NGA VISAR YMERI

“U dridh mali, polli miu” – mbase ky do të kishte me qenë përshkrimi më i saktë i takimit dhe marrëveshjes ‘historike’ në Shtëpinë e Bardhë. Kjo, sepse po ta shohim retrospektivisht, ka pasur një insistim afatgjatë të Administratës Trump që ta rinis dialogun me premtimin se kjo është faza përfundimtare. Ndërkohë që në Kosovë, lirisht mund të thuhet se dy qeveri, ajo Haradinaj, dhe këtë vit qeveria Kurti, kanë rënë për shkak të qasjes ndaj dialogut, ose më mirë thënë për shkak të pengesave të shkaktuara karshi tij. Për çka? Që të zotohemi se, ndër të tjera, do të punojmë bashkë me Serbinë për zbatimin e marrëveshjeve tashmë të nënshkruara në Bruksel? Duket se kostoja e rrëzimit të dy qeverive nuk e mbulon as për së afërmi rezultatin e marrëveshjes.

Ky është njëri prej leximeve të mundshme të marrëveshjes. Tjetri lexim shkon mbase një hap më tutje, drejt interesave (për të cilat mund të hamendësohemi e spekuojmë pa qenë të informuar saktë) gjeostrategjike të SHBA-ve në rajon. Pikat që kanë të bëjnë me energjinë (lexo gazin rus) dhe teknologjinë telekomunikuese 5G (lexo investimet kineze në Serbi) janë të lidhura drejtpërdrejt me luftën tregtare e gjeopolitike të SHBA-ve karshi Kinës veçanërisht. Pra përmes kësaj marrëveshje ka një insistim të Shtëpisë së Bardhë që Serbia përfundimisht të rreshtohet gjeopolitikisht krahas SHBA-ve. Madje edhe pika që kërkon të punohet me vendet të

cilat duan ta kriminalizojnë LGBTQI+ duket të lidhet me Serbinë dhe marrëdhënien e saj me Rusinë. Rusia aktualisht është një prej vendeve të mëdha që është duke ecur drejt kriminalizimit të orientimeve tjera seksuale, përveç atij heteroseksual.

Ose edhe një lexim shtesë në drejtimin gjeostrategjik. Marrëveshja mbulon një çështje kogja të ndjeshme për Lindjen e Mesme dhe konfliktin atje – atë të pranimit të Jerusalemit si kryeqytet të Izraelit. Ishte i menjëhershëm reagimi i zyrtarëve amerikanë, përfshirë Presidentin, për të deklaruar se Kosova është vendi i parë mysliman që e njuh Jerusalemin si kryeqytet të Izraelit. Kështu madje Presidenti Trump shkoi një hap tutje duke e parë këtë marrëveshje dhe pikën konkrete për njohje nga Izraeli, e njohjen e Jerusalemit nga Kosova, si hap të rëndësishëm për paqen në Lindjen e Mesme! Njohja e Jerusalemit si kryeqytet të Izraelit fillimisht nga Presidenti Trump ka qenë hap i kundërshtuar nga një pjesë e madhe e botës. Bashkimi Evropian e ka kundërshtuar një gjë të tillë. Këshilli i Sigurimit i OKB-së e ka miratuar një rezolutë që e kundërshton këtë hap.

Në njëjtën linjë shkon edhe zotimi i palëve (Serbisë dhe Kosovës) për ta shpallur Hezbollahun organizatë terroriste (gjë që Kosova tashmë e ka bërë). Pikë kjo që lidhet me interesat e Izraelit në rajonin e Lindjes së Mesme, por edhe me interesat gjeostrategjike të SHBA-ve duke e

pasur parasysh përkrahjen që Hezbollah ka nga Irani.

Por ka diçka edhe për Kosovën dhe raportet e Kosovës me Serbinë. Një pikë që ka zgjuar interesim e diskutim është padyshim pika ku palët zotohen se do të bashkëpunojnë me Departmentin Amerikan të Energjisë në ndërmarrjen e një studimi fizibiliteti për Liqenin e Ujmanit, i cili do ta analizojë e përmbledh potencialin energjetik e të furnizimit me ujë nga ky liqen artificial. Kjo është pikë nevralgjike, meqë paraqet një prej resurseve kryesore sociale e ekonomike në pjesën veriore të Kosovës, për të cilën ka një kohë të gjatë që thyhen shtizat mes Kosovës dhe Serbisë. Studimi i fizibilitetit duket të jetë zgjidhja e ndërmjetme ndaj kundërshtimit fillestar të palës së Kosovës për ta ndarë menaxhimin e Ujmanit mes Kosovës dhe Serbisë (siç kishte qenë e shkruar në njërin prej drafteve të mëhershme të Marrëveshjes). Megjithatë kjo zgjidhje e ndërmjetme është zgjidhje e spostuar për më vonë. Studimi i fizibilitetit mund të tregojë çdo gjë. Ose asgjë. Varësisht interesave të palëve. Liqeni i Ujmanit, përveç se burim jetik për furnizim me ujë të pijes e vaditje të tokave bujqësore në Rrafshin e Kosovës, është jetik edhe si furnizim uji për termocentralin eventual të ri energjetik i cili planifikohet të ndërtohet dhe pronësohet nga një kompani amerikane. Pjesa dërrmuese e sipërfaqes së ujit të Ujmanit gjendet në territorin e Republikës së Kosovës, ndërkohë që një pjesë e vogël (afërsisht 20%) në territorin

e Serbisë.

Drafti fillestar i marrëveshjes i zbuluar nga mediat në fjalinë e parë të tij ku i definon palët kontraktuese kishte folur për Republikën e Kosovës dhe atë të Serbisë. Më pas kishte ndryshuar në Kosovo (Pristina) – Serbia (Belgrade). Një përkufizim i tillë i palëve, në vijë me qëndrimin e ndërmjetësuesit, do të mund ta definojnë dialogun si dialog për njohje. Refuzimi i përfaqësuesve të Serbisë ka bërë që ajo fjali të ndryshojë. Pala e Kosovës e kishte pranuar ndryshimin e fjalisë për arsye të cilat nuk janë bërë publike. Sidoqoftë prania e asaj fjalie aty tregon që ky dialog i nisur në Shtëpinë e Bardhë ka pasur (dhe mbase ka) një qëllim që të arrijë tek zgjidhja përfundimtare. Por edhe kjo duket të lihet për më vonë. Siç janë lënë çdo gjë tjetër në këtë marrëveshje për më vonë.

E vetmja gjë konkrete nga marrëveshja është njohja që Izraeli i bën Republikës së Kosovës. Kjo megjithatë është një fitore e rëndësishme për Republikën e Kosovës. Por siç u përmend më lartë nuk është njohje që nuk sjellë probleme në politikën tonë të jashtme.

Ndërkohë që po ashtu vërehet (nëse e krahasojmë draftin e mëhershëm të publikuar me versionin final të firmosur) se gati të gjitha zotimet që i ka marrë përsipër Serbia janë përgjithësuara në gjuhë e në kohë zbatimi. Si të tilla, ato bartin rrezikun serioz të moszbatimit. Por kjo mbetet të shihet.

Duke qenë një dakordim për zotime, ajo që po quhet marrëveshje nuk i vë pikën asnjë gjëje. Duke qenë tekst që mbulon fusha të ndryshme, pas asnjë lidhje logjike të njëres me tjetrën, ky tekst nuk e trajton asnjëherë prej pikave siç duhet. Duke pasur pika të cilat lidhen me raportet me Kosovës dhe Serbisë, pika që ndërlidhen me raportet mes Serbisë dhe SHBA-ve, të tilla që ndërlidhen me raportet (në ngjizje) mes Kosovës dhe Izraelit, pika që flasin për raportin që Serbia ka vendet e treta (p.sh. Kina), etj, ky tekst nuk ka se si të përfundojë ndryshe përveç se i nënshkruar nga secili përfaqësues me veten. Kryeministri Hoti nënshkruajti marrëveshje me veten. Presidenti Vuçiq nënshkruajti marrëveshje me veten. Presidenti Trump nënshkruajti një dokumenti dëshmie që ka qenë i pranishëm kur zyrtarët e lartë shtetëror të Kosovës dhe Serbisë respektivisht kanë nënshkruar (secili me veten) nga një listë me zotime për angazhim në pika të ndryshme.

Fundi i kësaj fabule mund të jetë kështu “...dhe kështu mali u dridh. Kur shikua se çfarë po ndodh, na u tha që do të pjellë miu. Por me t’u qetësuar mali e kuptua se miu mbase mund të pjellë. Por këtë mbetet ta shohim pas një kohe. Dhe mbase mund të mos pjellë mi. Mbase diçka tjetër...”

(Autori është Drejtor ekzekutiv i Institutit për Politika Sociale “Musine Kokalari” në Prishtinë)

MEKA E ZHYTUR NË TURIZMIM MASIV FETAR

Haxhi, nafta tjetër e sauditëve

Haxhi në Mekë, shtylla e pestë e Islamit, garanton të hyra të përgjithshme për autoritetet sauditë. Për të pritur një numër gjithnjë në rritje të vizitorëve, udhëheqësit wahhabi nuk hezitojnë ta shndërrojnë qytetin e shenjtë në një kantier të përhershëm ndërtimi, edhe nëse duhet ndryshuar pamja e vendit. Ambicia për të mirëpritur gjithnjë e më shumë haxhilerë, paraqet probleme serioze për shëndetin dhe sigurinë.

NGA MOHAMED LARBI BOUGUERRA*

Mbretëria e Arabisë Saudite, eksportuesi më i madh i naf-tës në botë (10 milion fuçi në ditë), është gjithashtu djepi dhe qendra nevrlogjike e Islamit. Është shteti i vetëm me ulëse në Kombet e Bashkuara i cili

mban emrin e një familje. Ky vend për- vetëson ekskluzivitetin e shehadeit – të deklaruarit të fesë islame – të cilin e ka paraqitur në flamurin e tij, për t’iu treguar 1.8 miliardë besimtarëve të identifikuar në të gjithë botën, se sovranët e këtij vendi

janë “shërbëtorët e vendeve të shen- jta”. Meka ku lindi profeti Mohamed, kibra (drejtimi) e pesë lutjeve ditore dhe Medina ku ai prehet, mbeten fusha ekskluzive të monarkut. Mjetet financiare kolosale të tërhequra nga arka e naf- tës konsolidojnë udhëheqjen fetare të mbretërisë mbi Umetin (komunitetin e besimtarëve), por monarkia e di se duhet të kujdeset për të ruajtur legjitimitetin e saj si kujdestare e vendeve të shen- ja. Prandaj edhe ndërmerr përpjekje të mëdha për ta siguruar mbarëvajtjen e haxhit që bëhet në tokën e saj. Në vitin 2019, Rijadi nuk ngurroi t’i besojë sig- urinë e perimetrit të haxhit një degës së kompanisë izraelite G4S. Sfidat logjis- tike, shëndetësore dhe të sigurisë është e konsiderueshme. Dy deri tre milion haxhilerë shkojnë çdo vit në haxh, i cili është shtylla e pestë e Islamit. Hax- hi është i detyrueshëm një herë në jetë për çdo musliman që gëzon shëndet të mirë dhe që i ka mundësitë. Ai kryhet çdo vit për së paku pesë ditë gjatë muajit Dhul Hixhe, muaji i fundit i kalendrit të hixhrit (hënor). Ai përbën apoteozën e jetës së besimtarit dhe e lanë atë nga të gjitha mëkatet e tij. Është gjithashtu një moment i ribashkimit për muslimanët nga e gjithë bota, një faktor uniteti dhe shkëmbimi.

Mesatarisht, haxhi sjell në mbretëri 10 deri në 15 miliardë dollarë në vit. Në këtë arkë duhet shtuar 4 deri 5 miliardë dollarë të sjellura nga tetë milion haxhi- erë që kryejnë umren, një pelegrinazh jo i detyrueshëm në Mekë i cili mund të kryhet në çdo datë të vitit (jashtë haxhit) dhe që arrin vlerë kulminante gjatë Ra- mazanit. Sipas Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në Mekë, 25% deri 30% e të ardhurave të sektorit privat në dy qytet- e e shenja varen nga pelegrinazhi. Në total, të ardhurat e kumuluar të haxhit dhe të umrës përbëjnë zërin e dytë më të madh të të ardhurave për shtetin Saudi pas shitjeve të naftës. Në vitin 2018, Ri- jadi parashikoi që këto dy pelegrinazhe do t’i sillnin të hyra prej 150 miliardë dollarë gjatë pesë viteve të ardhshme. Dhe mbretëria dëshiron më shumë. Sipas ekspertëve që hartuan planin “Vizion 2030”, plan i diversifikimit ekonomik të mbretërisë, përpiluar nën mbikëqyr- jen e Princit trashëgimtar Mohamed bin Salman, tridhjetë milion njerëz pritet të kryejnë umrën çdo vit brenda dhjetë vjetësh. Sipas këtij dokumenti, “turizmi fetar është një opsion i qëndrueshëm për Arabinë Saudite”, në një kohë kur vendi duket se ka humbur mjetet për të qenë stabilizuesi i vetëm i çmimeve të lëndës së papërpunuar.

Marka luksoze dhe ‘fast-food’

Në mënyrë që të rriten të ardhurat nga haxhi, komuniteti i biznesit saudit dëshiro- n suprimimin e kuotave të haxhilerëve të imponuar për secilin shtet që nga viti 1988. Edhe pse nuk e konsiderojnë këtë shfuqizim, autoritetet po punojnë vazh- dimisht për të rritur numrin e haxhive dhe rregullojnë ambientin në përputhje me rethanat. Fondi i investimeve pub- like sauditë i cili menaxhon pasuritë prej 230 miliardë dollarë i ka dhënë Mekës një infrastrukturë masive për



ta përballuar valën gjigande me njerëz që po pushton qytetin e shenjtë. Midis viteve 1950 dhe 2017, falë aeroplanit, numri i përgjithshëm i pelegrinëve (haxhi dhe umreha) kaloi nga 50.000 në 10 milion, jo pa shkakuar tragjedi të papër- shkrueshme dhe mijëra vdekje.

Vetë Meka ka ndryshuar. Me 100.000 dhoma hoteli, shtatëdhjetë restorante luksoze, pesë helipada dhe vende të shumta të dizajnuara për të akomoduar në tenda pelegrinët më të varfër, vendi është shndërruar në një xhungël betoni pa pemë, e shtruar me mermer dhe e rrethuar me vinça dhe rrokaqiejt sikurse “Kullat e Shtëpisë [së Allahut]” (Abraj al Baït) – që rrethojnë shenjtërinë e të shen- jtërve, Qaben. Me rreth 60 tunele lidhëse që bashkojnë tre vendet e tjera të pelegrin- azhit, qyteti i shenjtë duket shumë më tepër si “një shkrije e Disneyland-it dhe Las Vegas-it” se një qytet në Lindjen e Mesme. Metamorfoza e tij “me ndërtesa groteske prej qelqi dhe çeliku” është veçanërisht e shëmtuar dhe “lëkundet midis shibles dhe kinemasë”, thotë antropologu maroken Abdellah Ham- moudi. Rreth ‘Qaabës’ dhe Xhamisë së Madhe ‘el-Haram esh-Sherif’ në të cilën mund të mblidhen dy milion besimtarë ka vetëm hotele luksoze dyzetekatëshe, marka luksoze por edhe ‘fast-food’. Asnjë vend nuk është rezervuar për kulturë dhe pothuajse asnjë artefakt i së kaluarës së qytetit nuk i ka rezistuar tërbimit iko- noklastik wahhabi kundër idhujtarisë, shkatërrimi i parë i të cilit filloi me push- timin e qytetit në vitin 1924 nga mbreti Abdelaziz Ibn Saud. Nuk është kursyer as vendi i lindjes së profetit që u shndër- ruan në një parking, as vendi ku lindi gru- aja e parë e tij Khadija, ku u ndërtua një bllok sanitar! Arkitektura tradicionale që i përshtatet shumë klimës së nxehtë me anë të “moucharabieh”-ëve, pajisje të ventilimit natyror, është shkatërruar për t’i lënë hapësirë shëmtisë së betonit dhe zhurmës së kondicionerëve, sepse asgjë nuk duhet ta kujtojë të kaluarën e gjatë osmane të qytetit të shenjtë. Në këtë mjedis, haxhi – një fjalë që do të thotë përpjekje – zbrazet nga pesha e tij fetare, shpirtërore dhe historike duke u shndërruar në një respektim mekanik të ritualeve dhe në një nxitje për shopping.

Këto ndryshime dhe zhvillimi i vazh- dueshëm e vëjnë gjithashtu qytetin në rrezik të përmbajtjeve të papritura, të ndotjes së shtesave nëntokësore të ujit dhe të degradimit të mjedisit. Një stu- dim i autostradave, tuneleve dhe kycjeve të qytetit i cili është kryer gjatë haxhit në vitin 2012 ka treguar nivele shumë të larta të ozonit, monoksidit të karbonit, benzenit, komponimeve organike të paqëndrueshme (VOC) toksike nga gazërat e automjeteve dhe komponimet e fluoruara CFC-12 të kondicionerëve. Pelegrini duhet të jetojë në këtë mjegull fotokimike duke lëvizur në rrugët e stërngranguara që çojnë nga xhamia e madhe në tre vendet e detyrueshme në drejtim të malit Arafat, 20 km në lindje.

“Çdo ditë, autobusët dhe veturat në Mina [vend i detyrueshëm i ritualit të haxhit, 5 km larg Mekës] lëshojnë 80 tonë gazra gjatë periudhave të pikut. Shumica e pelegrinëve kalojnë më shumë kohë duke kollitur se duke u lutur. Efektet e dëmshme të tymrave të shkarkimeve të automjeteve, nxehtësia dhe rraskapitja ishin shumë të qarta: pashë njerëz duke u alivanosur, pashë njerëz duke vdekur”, shkruan shkri- mtar dhe studiuesi anglo-pakistanez Zi- auddin Sardar, i cili punoi për pesë vjet në Qendrën e Kërkimit të Pelegrinazhit në Mekë (Hajj Research Centre) në Xhedah. Sardari ka studiuar problemet logjistike “apokaliptike” që lindin nga haxhi për të gjetur zgjidhje. Ai tregon se rekomandimet e Qendrës kurrë nuk janë zbatuar, madje edhe kur ai paralajmëron- te se “të dy cilësitë e veçanta të Qytetit të Shenjtë, “bukuria” dhe “përtjetësia” do të zhduken nën efektin e planifikimit modern”.

Haxhi është gjithashtu një sfidë gjigante financiare dhe logjistike për josauditët. Me një kosto mesatare prej 5000 deri në 8000 euro (transporti, akom- odimi në vend dhe ushqimi), Haxhi detyron shumë haxhilerë të bëjnë sakri- fica të mëdha financiare (Islami ndalon të merret borxh për të shkuar në haxh). Ndonjëherë, shtetet sigurojnë një pjesë të kësaj shume, por pjesa kryesore mbetet përgjegjësi e haxhiut të ardhshëm (personi që e ka përfunduar haxhin). Në Nigeri, si në shumë vende myslimane, paga e ulët minimale (30 dollarë) i pa- mundëson shumicës së popullatës të konsiderojë udhëtimin, duke shkaktuar frustrime dhe zemërim kundër au- toriteteve. Në Tunizi, islamologu Badri Madani, duke kritikuar koston e tepruar të haxhit, vlerësoi në prill të vitit 2020, se mirëmbajtja e shkollave dhe spitaleve ishte më e levërdishme se pelegrinazhi dhe umreja. Në Francë, ku mesatarisht 25.000 persona marrin vizë për të shkuar në Mekë çdo vit, vetëm rreth gjashtëdhjetë agjenci janë të akredituara nga ministria sauditë e haxhit dhe umre-së. Këto agjenci përfitojnë shumë nga pozicioni i tyre pothuajse i monopolit, ndërsa dal- lavergjinjtë nuk hezitojnë t’i keqpërdorin kandidatët që nuk i kanë marrë vizat e tyre përmes kanalit normal.

Haxhi është gjithashtu një çështje e tensioneve diplomatike. Për të “ndësh- kuar” një vend që nuk ndan pikëpamjet e tij, Riadi mund ta ulë në mënyrë të njëanshme kuotën e tij të pelegrinëve. Një situatë e kritikuar nga Turqia, Irani dhe madje edhe Indonezia dhe Malajzia, të cilat kanë përjetuar këtë lloj hakmar- rje dhe që rregullisht evokojnë krijimin e një lloj Vatikani Mysliman që shpëton nga diktati Saudi.

* Profesor Universitar, anëtar i Akade- misë së Shkencave, Letërsisë dhe Artit të Tunizisë Beit El Hikma (Carthage).

Lufta njëzetvjeçare?

NGA SERGE HALIMI



Ushtarët tetëmbëdhjetë vjeçar amerikanë që shko- jnë sot në luftë në Afgani- stan nuk kishin lindur akoma kur ajo pati filluar. Më 2012, z.Donald Trump thoshte me vendosmëri: « Është koha të largohemi nga Afganistani ». Nuk është ende e sigurt se a do t’ia dalë më mirë se paraardhësi i tij z.Barack Obama. Sepse secila përpjekje për t’i shkëputur ushtarakisht Shtetet e Bashkuara nga çdo vend – Siri, Libi, Kore, Gjermani – provokon një ngrit- je shpatash në Washington. Lobi i luftës menjëherë jehon: Rusët janë atje! Rusët po vijnë!

Ndonëse buxheti ushtarak i Shteteve të Bashkuara (738 miliardë dollarë në vitin 2020) mund të jetë dhjetë herë më i madh se ai i Rusisë, lëkundja e kampionit të Moskës mjafton për t’i bashkuar republikanët dhe demokratët në reagimin e tyre. Dhe ata mund të llogarisin në mbështetjen editoriale të New York Times.

Më 26 qershor, kjo e përditshme amerikane publikoi një rrjedhje in- formacioni nga Central Intelligence Agency (CIA), sipas së cilës Rusia kishte paguar kryengritës afganë për të vrarë ushtarë amerikanë. Dhe secili kujtohet se në muajt e paralufutës në Irak, New York Times kishte luajtur një rol vendimtar në përhapjen e la- jmeve të rrejshme në lidhje me “armët e shkatërrimit në masë” të Sadam Huseinit. Psikoza anti-ruse e kësaj të përditshme të madhe liberale tërheq vëmendjen e secilit i cili kërkon fjalët « Rusi » dhe « Putin » në Google tëjt.

Lajmi senzacional afgan, për të cilin New York Times dukej se dyshon- te vetëm tetë ditë pasi e publikuan, parashtron disa pikëpyetje të tjera. Kush përfiton nga ky “informacion”, në një kohë kur tërheqja e trupave të fundit amerikane duket pak a shumë e vendosur? A kanë Shtetet e Bash- kuara arsye të shqetësohen që një nga kundërshtarët e tyre po i ndih- mon kryengritësit afganë; përderisa aleati i tyre, Pakistani, e bën këtë që një kohë të gjatë, e që vetë Shtetet e Bashkuara të Amerikës midis viteve 1980 dhe 1988 i pajisen me armë të sofistikuar muxhahedinët që luftonin me Moskën, me të cilat u vranë mijëra ushtarë sovjetikë? Pastaj, si të shpjeg- ohet se e përditshmja e New-Yorkut nuk rreshti të na ofrojë portretet e gja- ta emocionale të tre marinsave, gjoja viktimat të të “paguarëve rus” ? Një marins kishte mustaqe të mëdha dhe bënte bodybuilding, tjetri pëlqente ta rishikonte filmin Star Wars dhe ai i fundit adhuronte tri vajzat e tij. Por gazeta “harronte” të na informoj se një agjenci tjetër e inteligjencës amerikane, National Security Agency (NSA), nuk e konfirmonte asesi la- jmin senzacional të CIA-s.

Më 1 korrik, një koalicion i gjerë parlamentarësh, demokratë dhe re- publikanë, përdori “zbulimet” e New York Times, për ta bërë më të vështirë tërheqjen amerikane nga Afganistani. Edhe pse mënyra më e mirë për ta parandaluar vdekjen e ushtarëve të huaj do të ishte që ata të mos jenë tutje të pranishëm.

KOSOVË-SHQIPËRI: MUZIKA MIDIS TRANSFORMIMEVE IDEOLOGJIKE DHE HISTORIKE

Tingujt e tranzicionit

E frymëzuar dhe e zhvilluar në kontekstin historik e shoqëror të kohës, muzika në Shqipëri dhe Kosovë nuk përbën përjashtim lidhur me transformimet e saj në kohërat e tranzicioneve nga sistemi monist socialist në atë pluralist kapitalist. Nga censurat ideologjike shtetërore në periudhën e pasioneve nacionaliste, ajo përballet sot me sfidat komercializuese të tregut të lirë kaotik.

NGA SHKODRAN HOTI

Duke qenë dy shtete të veçanta, Shqipëria dhe Kosova kanë edhe veçoritë e tyre, në fushën e jetës kulturore. Ideologjike, politike, kulturore dhe historike.

Në Kosovë, që për rreth pesë dekada ishte nën Jugosllavinë e regjimit të Tito-s, që konsiderohej më liberal kundrejt lirive kulturore, bashkëjetuan përgjithësisht në hapësirën publike dhe private muzika folklorike shqiptare, muzika e huaj dhe muzika tradicionale. Ndërsa, në Shqipërinë e Enver Hoxhës, censura shtetërore ishte më e ashpër, sidomos ndaj muzikës që simbolizonte “kapitalizmin perëndimor”.

Por rënia e sistemeve moniste në të dy anët e kufirit, sado që prodhoi më shumë liri, shfaqti realitete dhe probleme të reja.

Si ishte ndërlidhja e politikës (ideologjisë) dhe muzikës në regjimet moniste në Kosovë e Shqipëri? Çfarë arikullonte muzika nën këto dy regjime? Si u zhvillua ajo në periudhën e tranzicionit në të dyja vendet? Si u zhvilluan trendet muzikore moderne dhe kush ishin sinjalizuesit e parë? Ç’paraqet muzika sot, nga kuptimi vleror dhe komercial?

Për këto tema bashkëbisuam me gazetaren nga Shqipëria, Kozeta Kurti; si dhe gazetarin, publicistin dhe muzikantit nga Kosova, Agron Shala.

– Si është zhvilluar lidhja midis muzikës dhe politikës në Kosovë nën Jugosllavinë e viteve 1945-1990?

Agron Shala: Për dallim nga vendet e Perëndimit ku konceptet kulturore e filozofike ndikojnë edhe në rrjedhat e politikës, arti dhe kultura në Kosovë varej nga liritë dhe të drejtat që ua lejonin shqiptarëve, kërret e ish-Republikës Socialiste Federative e Jugosllavisë (RSFJ). E, siç dihet, deri në vitin 1966 – pra deri në Plenumin e IV-të të Komitetit Qendror të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë (i njohur si Plenumi i Brionëve)

– politikën kundrejt shqiptarëve e ideonte famëkeqi Aleksandër Rankoviçi. Megjithatë, nga viti 1945 ka nisur të krijohet një shtresë intelektuale në Kosovë, me muzikantë të shkolluar, me hulumtues të folklorit, pastaj me shkrimtarë, piktorë, kritikë, profesorë e profesionistë të lëmenjve të ndryshëm. Kjo shtresë do t’i shtyjë gjërat para, pas Brionëve, kur nënkryetari i Jugosllavisë, Rankoviçi, me një numër bashkëpunëtorësh shkarkohen prej pozitave politike dhe shtetërore. Nga kjo kohë ishte një ndërlidhje mes politikës, artit dhe kulturës. Dhe, është pikërisht shtresa intelektuale ajo që ndikon në rrjedhat e ardhshme politike në Kosovë.

Nëse pas Luftës së Dytë Botërore (1945) vazhdon kultivimi i muzikës folklorike, popullore, qytetare... në vitet 1960, çdo herë e më shumë vend do të zënë muzika “e lehtë” dhe ajo rock. Në ato vite formohen këto rock-grupe: ‘Fan’ në Mitrovicë, ‘Blue Stars’ në Prishtinë, ‘The Lord’ në Ferizaj, ‘Farazimus’ në Gjakovë, ‘Marimanga’ në Prizren etj. Fatkeqësisht – nga këto grupe – gjurmë me incizime ka lënë vetëm ‘Marimanga’ (vlenë të ceket, po ashtu, se një shqiptar nga Kosova, Alberto Krasniqi, është bashkëthemelues i rock-grupit të parë në ish-Jugosllavi, ‘VIS Dinamiti’ – të parit grup rocku që i dedikohet një pllakë përkujtimore në Ballkan).

Pra, pas rënies së Rankoviçit ishte një si marrëveshje e heshtur mes elitës politike dhe asaj intelektuale për përpërimin e popullit shqiptar. Artistët mbështeten, për ta krijuar kushte më të mira për punë. E, si dëshmi e këtij emancipimi është edhe muzika rock, që në një mënyrë simbolizon vitalitetin e një shoqërie. Një shoqëri pa këtë skenë duket pasive, larg vlerave që përfaqëson një shoqëri perëndimore. Teksa Kosova kishte një skenë të tillë, të denjë, mbizotëronte një frymë rebeluese. Ndaj, nuk është e çuditshme që në vitet 1990, kur Kosova ishte në pushtim klasik serb, skena rock e merr tatëpjetën. Mund të gaboj, por i vetmi album tamam rock në ato vite ishte ‘Ndoshta me një blues’ i BB Poqit. Në ato vite ende kishte një marrëdhënie mes elitës politike dhe asaj intelektuale, por me institucionet kulturore e arsimore të mbyllura e të uzurpuara, me institucione paralele shqiptare e nën një pushtet shtypës serb, që shumicën e shqiptarëve i la të pa punë dhe me sharlatanët që nisnin të hapin media të shtypura, produksione “filmi” e “muzikë”, ishte e pamundur të vazhdohej



trendi i mëparshëm i vlerave, në cilin do zhanër muzikor.

– Z. Shala, në kohën e Tito-s, rinia, sidomos e zonave urbane, dëgjonte ritme dhe zhanre që buronin edhe nga perëndimi si: punk, new wave, cold wave, rock etj. Njëkohësisht, kishte bende dhe këngëtarë nga e tërë ish-Jugosllavia të cilët adhuroheshin edhe nga shqiptarët që dëgjonin njëkohësisht edhe këngët e tyre patriotike. Ndonëse edhe kishte këngë vendore të ndaluara, si ato që cilësoheshin si shoveniste nga regjimi, bashkëjetonin muzika e huaj, muzika në të gjitha gjuhët e Jugosllavisë dhe ajo tradicionale/patriotike shqipe. Në Kosovë dëgjohehin njëkohësisht Rolling Stones, Bjelo Dugme, Gjurmët, Lepa Brena dhe Dërvish Shaqa. Si e shpjegoni këtë?

Agron Shala: Këngët me tekste patriotike dëgjohehin fshehurazi gjatë monizmit. Siç dëgjohej fshehtas edhe Dërvish Shaqa i cili, për shkak të dhunës që ushtrohej në Rrafshin e Dukagjinit, në atë që njihet si Koha e Rankoviçit, më 1958 ikën në Shqipëri. Shqiptari ia doli të përparojë në ish-RSFJ, pra ta dëshmojë se është i guximshëm dhe i dijshtëm, por megjithatë ishte një rregull strikt: arti nuk duhej të cenonte komunizmin (vetëqeverisës) dhe ideologjinë e vëllazërim-bashkimit që e proklamonte Jugosllavia e Tito-s. Në këtë aspekt, këngët që transmetoheshin në radiot e Kosovës deri më 1990, pra ato “legalet”, kishin tekste të mira, por jo me motive të heroizmave shqiptarë në luftërat kundër serbit apo malazezit. Krahasuar me degradimet e sotme, çdo tekst i mirë për mua sot ka vlerë patriotike. Por, duhet ta dini se këngët e shahirave dëgjohehin kryesisht në oda ose përmes kasetofonave (dhe atë “Grunding” se zani dilte “ma mirë”). E, shumëkush për këtë hante burg.

Të njëjtën kohë, shqiptari nuk ka mundur të jetë imun ndaj trendeve që e dominonin Jugosllavinë. Pra, një pjesë e madhe e tyre ishin të informuar për atë se çfarë ndodhte në skenën muzikore jugosllave. Mund edhe ta pëlqenin atë. Por, në përgjithësi, nuk mendoj se kishte bashkëjetesë mes muzikës shqiptare dhe sllave (e kam fjalën këtu për ata

që flisnin gjuhën e dikurshme serbokroate – serbët, kroatët dhe boshnjakët – e që i dominonin trendet muzikore të shtetit të sllavëve të jugut). Sepse, Lepa Brena dëgjohej me raste nga një shtresë, e Bijelo Dugme nga një shtresë tjetër e shoqërisë. Të dy emrat ishin simbole të propagandës dhe komercializmit; atraksione që mblidhnin turmat dhe krijonin një iluzion se gjithçka është moderne dhe në rregull në socializmin liberal të RSFJ-së. Por, ky iluzion shitej veç te shtetet tjera komuniste, e jo edhe në Perëndim.

Në anën tjetër ishin shqiptarët, populli i tretë më i madh në atë shtet (por që konsiderohehin pakicë), ku shumica dërmuese kurrë nuk e kanë ndjerë veten pjesë të identitetit jugosllav. Etnia dhe gjuha i veçonte dhe i distancoonte nga preferencat e shumicës në Jugosllavi. Kështu, pos muzikës folklorike e popullore (që ndikohej edhe nga muzika e Shqipërisë, me të cilën mund të thuhet se “bashkëjetonte”), ata kishin edhe rock-skenën e tyre, të mirë e të barabartë me të tjerët. Natyrisht me audiencë më të kufizuar, por që frymëzohej nga trendet dhe grupet perëndimore.

Në situatë të ngjashme ishin edhe sllovenët, që kishin shumë grupe të mira rocku, por po ashtu me audiencë të kufizuar. Sllovenët kishin edhe grupin ‘Laibach’ – të anatomuar në komunizëm e që ia del të jetë fenomen global që frymëzon grupet e mëdha (si p. sh. ‘Sisters of Mercy’ apo ‘Rammstein’). Në fakt, emri ‘Laibach’ është i vetmi që përmendet në enciklopeditë e rockut botëror. Asnjë grup tjetër nga ex-YU! E, kjo tregon se rocku në Jugosllavi, pra edhe ai i Kosovës, ishte para shteteve komuniste apo atyre në zhvillim, po jo në nivel kreativ apo inovativ me ato të Perëndimit.

“UNË E SHOH NJË PARALELE MES RINISË SHQIPTARE TË VITEVE 1980 DHE ASAJ NË PERËNDIM TË VITEVE 1960, DHE MENDOJ SE RINIA JONË E ATYRE VITE ISHTE MË PËRPARIMTARE, MË E SHKOLLUAR E MË KREATIVE SE ÇDO GJENERATË TJETËR DERI SOT” – AGRON SHALA

– Zonja Kurti, njihen rastet kur janë burgosur njerëz në Shqipërinë e Enver Hoxhës, vetëm sepse kishin dëgjuar muzikë të huaj, sidomos ato që simbolizoheshin me “kapitalizmin perëndimor”. Por paralelisht kishte edhe këngë të ndaluara në gjuhën shqipe. Si do ta kishit përshkruar politikën ideologjike të Enver Hoxhës në raport me muzikën, të huaj dhe shqipe?

Kozeta Kurti: Në një shoqëri tërësisht analfabete siç ishte Shqipëria pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, që krejtësisht e lehtë që përqëndrimi i pushtetit në duart e një udhëheqësi të kontrollonte gjithçka, përfshirë të gjithë mjetet e komunikimit masiv dhe shprehjet e të gjithë mesazheve nëpërmjet gjinive të artit, muzika kryesisht, e cila e ka më të thjeshtë të depërtojë e të krijojë ndjesi, duke qenë se është një gjini e artit që as nuk preket, as nuk shihet. Sipas ideologjisë së Hoxhës, arti duhej të vihej në shërbim të masave, si mënyrë për të ndihmuar Partinë për ta shpërndarë “tru-shpëlarjen” për stilin perfekt të jetesës dhe nëpërmjet shtypit të kohës, çdo sipërmarrje artistike perëndimore, duhej të go-ditej si armik për vdekje, sepse ky art qe ai i botës që po shkatërrohej. Partia dhe udhëheqësi, nuk mund ta pranonin nderimin e artistëve që s’duhej të vdisnin vetëm, por kërkonin vëmendjen e publikut të tyre. Duke qenë se shteti i kohës “shiste dhe blinte” krijimtarinë artistike, i pajiste artistët me “leje krijimtarie”, mëntonte çdo të drejtë mbi to.

– Ju keni sjellur antologjinë “Era e ndryshimit”, rreth lëvizjes muzikore moderne shqiptare të viteve të 90-ta. Flasim për kohën ku publiku shqiptar, të cilit për dekada i ishin imponuar këngët për Partinë dhe Enver Hoxhën, mund të dëgjonin tashmë lirshëm bende si: Metallica, Deep Purple, Rolling Stones, Pink Floyd... etj. Në këto kohë gjejmë sinjalat e para të muzikës rock nga Shqipëria, nga Elton Deda, Bledar Sejko, Gjergj Jorgaqi, Ilir Ibrahimit etj. Çfarë shënonte rënia e Murit të Berlinit për Shqipërinë në raport me muzikën?



Agron Shala

Kozeta Kurti : Në shoqëritë e qyteteve të fund viteve '60 e fillim viteve '70, kryesisht në Tiranë e në Durrës, ku është porti më i madh i vendit, kishte përpjekje për të kapur copëza të Perëndimit, me kasete që futeshin nga marinarët dhe shpërndaheshin fshehurazi në duar herë të sigurtë e herë jo (sepse siç keni përkrahur edhe ju më lart, ndëshkimet kanë ardhur edhe si pasojë e këtyre shkëmbimeve). Nuk dua të harroj edhe hitparadet e së premtes pas mesdite, ndikimin e televizionit dhe muzikës italiane, megjithatë ky rreth ishte i ngushtë, i fshehtë. Në fillim të viteve '90, me përmbysjen e diktaturës së fundit e ndoshta më e egra në vendet e lindjes, është e vërtetë që pati frymëmarrje për krijimtari artistike, por sidoqoftë Shqipëria ishte me dekada vonesë. Ndërsa bota po promovonte disa nën rryma të tjera, si muzika alternative apo grunge, në Shqipëri po vinte ajo që në Britani apo SHBA, kishte ndodhur në vitet '70. Në gjykimin tim, kjo erdhi për dy arsye: për shkak të ndikimit që grupet e lartpërmendura prej jush kishin tek kompozitorët dhe interpretuesit shqiptarë, por edhe sepse një pjesë e mirë e këtyre këngëve ishte kompozuar në fund të 70'ës apo fillim të '80'ës dhe kishin mbetur në sirtarë për shkak të kohës e regjimit. Përpjekjet për të krijuar grupe, albume, "Djemtë e Detit", "ARB", "RITFOLK" apo "Thunderway" të cilët realizuan në vitin 1994 një album në Shkup, të tërin në gjuhën angleze "The order executors", u shuan shpejt, thajse në fund mesin e viteve '90, për shkak të mungesës së financimeve, situatës së krijuar në vitin 1997 etj. Ëndrra perëndimore për grupe dhe turne, zgjati shumë pak.

Kulminacioni i kaosit

– Pas largimit të forcave serbe nga Kosova më '99 dhe fillimit të zbehjes së muzikës patriotike, në mesin e shqiptarëve të Kosovës pati edhe përplasje mes vlerash tradicionale me ato moderne. Si p.sh. në një libër shkollor në Kosovë, i botuar në vitin 2004, ku një paragraf i mësonte nxënësve se "muzika rock është akt kriminal". Për vite të tëra, nxënësit kosovarë e mësuan rokun si një dukuri negative, të krahasuar me pornografinë. Natyrisht se këtë lloj etiketimi mund ta quajmë me lehtësi si relik i një kohe të kaluar i cili shpërfaq pak a shumë 'shpirtin e asaj kohe' (një lloj antiperëndimi revolucionar i përzier me tradicionalizëm patriarkal). Por çka nëse nuk na flet vetëm për kohë?

Agron Shala: Një popull e merr tatëpjetën kur i shkatërrohet arti dhe kultura. Ajo nisi më 1990, por degradimi i vlerave del më shumë në pah pas vitit 1999. Pas këtij viti nuk ndodhë përplasje mes tradicionales dhe modernes, siç thoni ju, por ndodhë një si kulminacion i kaosit të viteve 1990, pasi vlera (në çdo sferë e profesion) zë vend pak e më pak. Degradohet sistemi arsimor, teatri, muzika, filmi, media... Shpallen artistë njerëz që nuk kanë lidhje me artin. Prandaj, nuk është çudi që nëpër shkolla nxënësit mësojnë gjëra koti dhe formulime pa fije logjike që ka mundur t'i bëjë vetëm sistemi enverist,

si: "Muzika rok, pornografia, dhuna në televizion – që janë akte jo të mira – janë provuar plotësisht si kriminale"! (sic.)

Sot secili e quan veten autor, secili e quan veten artist. Dhe, gjen mbështetës në media e institucione kulturore për këtë dëlir tyre të madhësisë. Pra, po degradohet tradicionalja dhe modernia. Sepse, mungon patriotizmi (e me këtë edhe këngët patriotike që duhet të merren me tema tjera në kohë lirie). Këtu ka veç nacionalizëm, të cilin Harley Austin e shpjegon mirë si mjet i zgjuar i qeverisë për t'u pëlqyer nga popullata. Ai nacionalizmin nuk e ndan nga dëshira për pushtet, teksa për patriotët thotë se janë njerëz që e trajtojnë vendin e tyre me respekt e që janë të gatshëm të luftojnë kundër një qeverie tiranike që kërcënon të drejtat e tyre (për dallim nga nacionalistët që bien pre e gënjeshtrove të pushtetarëve). Nëse më herët shtresa intelektuale kishte ndikim tek rrjedhat politike, pas vitit 1999, pjesa më e madhe e intelektualëve (në këtë rast ndoshta më mirë është të themi të njerëzve me shkollë e me nam) bëhen vegla të politikës. Fatkeqësisht.

– **Historia e muzikës së popullarizuar në Perëndim prej Luftës së Dytë Botërore mund lehtë të lexohet edhe si historia shoqërore e atyre vendeve. Kalimi nga Rock-u në Punk, e prej Punk në Post Punk, lidhet ngushtë me periudhat kohore të kalimit nga kapitalizmi zhvillimor te ai financiar-monopolist. Pra muzika Rock e viteve gjashtëdhjetë paraqet shpirtin e rebeluar të të rinjve të cilët, në kuadër të mirëqenies sociale rebeloheshin kundër pushtetit të autoritetit (pushteti politik, ai akademik, mediatik e kulturor). Ky rebelim e solli 1968'tën. Pas kësaj liberalizimi shoqëror që u përjetua si një dimension i ri lirie, në fakt e solli liberalizimin e privatizimin e shkajshëm ekonomik. Ky transformim e solli muzikën Punk, që e reflektonte ankthin e ri që solli liria e re. Kjo liri e tregut e filloi deindustrializimin neoliberal, i cili solli depresionin kolektiv (të shprehur më së shumti mbase në vendet si Britania e Madhe). Ky depresion dëgjohej e ndihet në vargjet e tingujt të muzikës post-punk. A kemi një ndërlikim të tillë të sentimentit kolektiv e perceptimit kolektiv për mirëqenien e lirinë me muzikën e kohës në Kosovë dhe Shqipëri?**

Agron Shala: Punk, New Wave, Cold Wave që i përmendët më lartë, janë zhanre të muzikës rock që pak e hiç kanë zënë vend të shqiptarët. Me New Wave janë identifikuar 'Gjurmët', në fazat e para. Ndërsa, këngë a vetme punk në Kosovë është "Citroeni" i grupit Bankrot (punk i moderuar, nën ndikimin e grupit 'The Clash' dhe ritmeve reggae).

Mos të harrojmë se muzika punk (me të cilën identifikohet pjesa e dytë e viteve 1970) nuk ka pasë jetë të gjatë. Punksi rëndësi më të madhe ka si subkulturë e jo si muzikë. Përfaqësuesit e këtij zhanri, instrumentistët dhe këngëtarë mesatarë po të zhurmshëm, mendonin se kështu po e mbajnë gjallë frymën rebeluese të rockut. Por, asgjë e

mençur e me vlerë nuk del nga britmat, paçka që sot thuhet se pankerët ishin një reagim ndaj lakmisë së korporatave, autoritarizmit apo konsumerizmit (reagimi më i mirë për këtë është albumi "Animals" i grupit Pink Floyd).

Muzika rock nis në Angli, nga të rinjtë që pëlqenin muzikën e njerëzve me ngjyrë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Meqë nuk ishin as instrumentistë të mirë e as nuk e kishin atë ndjesinë e amerikanëve, e krijuan një trend të ri muzikor. Me këtë trend muzikor, që zhvillohet dhe krijon identitet, do të identifikohet edhe revolucioni kulturor i të rinjve, subkultura apo kunderkultura e viteve 1960: lëvizja e hipikëve me bazë San Franciskon e SHBA-ve dhe "luhatja" (Swinging London) – nëse mund të përkthet kështu – me bazë në Londër të Anglisë.

Mos të harrojmë se rinia angleze e sidomos ajo amerikane, e lindur gjatë apo pas Luftës së Dytë Botërore, i takonte kryesisht e shtresës së mesme. Kjo rini ballafaqohej me një lloj konservatorizmi, me autoritetin ushtarak të imponuar nëpër shkolla dhe në familje, që kërkonte konformizëm dhe bindje. Pra, ishte rebelim ndaj autoriteteve politike e ekonomike; një tendencë për një revolucion shpirtëror, për çka proklamoni paqen, dashurinë dhe lirinë individuale. Synimi i kësaj rinie ishte që të barazohet individi me institucionin. Në fakt, realiteti i sotëm dëshmon se ata ia dolën (Bill Clinton dhe Tony Blair ishin pjesëmarrës të kësaj lëvizjeje; Steve Jobs dhe Steve Wozniak – themeluesit e gjigantit "Apple"; Steward Brand – ideologu i internetit etj.). Por, një gjë duhet ditur se mesazhet dhe synimet përçoheshin gjithmonë me muzikë të mirë dhe me tekste të mira.

Rocku ndër shqiptarë (të Kosovës, sepse në Shqipëri nuk ka pasur dhe ende nuk ka rock, pra edhe një frymë rebelimi, për çka nuk është çudi që atje më së shumti njihet një grup që s'ka lidhje me rock, si 'Fisnikët'), si në vendet tjera të Jugosllavisë, ka nisur më shumë për arsye tjera: për t'u dukur më modernë dhe më atraktivë për vajzat (ishte kjo koha e trendit të "ball-ove", ndejave me muzikë e vallëzim). Por, gjërat ndryshojnë pas demonstratave të shqiptarëve më 1981, kur skena rock në Kosovë e arrin kulminacionin me më shumë grupe, me më shumë ide dhe kreativitet, dhe me tekste më të angazhuara, si: 403, Gjurmët, Seleksioni 039, Telex, Ilirët, Lindja, Bankrot, Babilon, Fillimi i fundit (nuk duhet harruar këtu divën e rockut shqiptar, Violeta Rexhepagiqin)... Rockerët më nuk ishin indiferentë ndaj padrejtësive që u bëheshin. Por, kur është fjala të politika, përdorëshin metaforat (p.sh. "Mikrofoni" i Gjurmëve, "Zvarraniku" i Lindjes, "Këngë mllëfi" i Minoritorit etj.).

Unë e shoh një paralele mes rinisë shqiptare të viteve 1980 dhe asaj në Perëndim të viteve 1960, dhe mendoj se rinia jonë e atyre vite ishte më përparimtare, më e shkolluar e më kreative se çdo gjeneratë tjetër deri sot (gjë që vërtetohet edhe me skenën rock të asaj kohe). Por, ishte edhe fatkeq, sepse detyrohet të shpërngulet në vitet 1990 – të krizës ekonomike dhe mungesës së perspektivës për ta dhe tërë Kosovën.

Kozeta Kurti: Unë mendoj se muzika e çdo lloji, e çdo kohe ka qenë e tillë: pra, e frymëzuar nga konteksti historik e social i një kohe të caktuar. Nëse krijuesit nuk kanë një burim frymëzimi, ngjarje që të ndikojë psikikën e tyre,

të nxisë emocionin, si do t'i kishin mbushur aq shumë letra me fjalë e pentagramë në nota? Dhe sikundër e dini, jo vetëm muzika, por çdo gjini e artit ka prodhuar kryevepra në rastet e ndikimit nga drama të mëdha, nga pësimet, nga zhgënjimet, nga mungesat, nga malli, nga kufizimet.

Përdalja komerciale

– **Jo rallëherë ka zëra që thonë se në kohën e monizmit dhe komunizmit në Ballkan, muzika kishte më shumë censurë por më shumë vlera, e sot muzika pothuajse nuk censurohet në emër të konkurrencës së lirë të tregut, por se ajo ka më pak vlera?**

Kozeta Kurti: Deri para disa vitesh kam menduar ekzaktesisht të njëjtën gjë dhe thoja si ka mundësi që i mbajmë mend, i fërshëllem këngët e së shkuarës dhe nga të sotmet, nuk mbajmë mend thajse asgjë? Sot kam një mendim tjetër. Censura moniste i bënte njerëzit të përqëndroheshin dhe atë që merrnin, e përthithnin, e bënin të tyren, ndërsa sot, në këtë bombardim me informacion, ne nuk po kemi kohë as të jemi përzgjedhës. Mund të ketë materiale shumë të mira, por që ne nuk kemi kohë as t'i dëgjojmë, t'i shohim. Mungesa e institucionit të kritikës profesionale dhe të shëndetshme, rankimi, promot mediatike të pakujdesshme, janë një minus shumë i madh në orientimin dhe edukimin e shijeve estetike.

Agron Shala: Më lart e përmenda këngën "Citroeni". Një pjesë e vargut original ishte: "Në vece (WC), jemi ne". Por, fjala WC nga "censori" zëvendësohet me "cece" (CC). Sepse, shoqëria nuk ishte shumë e hapur për të dëgjuar, në familje, fjalë të papërshtatshme (mos të harrojmë se në shumicën e familjeve, radioja dhe televizori ishin pajisje të shtrenjta ndaj dëgjoheshin bashkërisht). Po ashtu, thash se në komunizëm nuk lejohej të prekej drejtpërdrejt shteti dhe politika. Gjithçka tjetër ishte censurë pozitive, për vlera, qoftë në tekst apo muzikë (edhe muzika verifikohet e nuk ishte e lehtë të incizohej kënga që nuk ishte origjinale).

Dikur ishte vetëm një studio incizimi në Kosovë, në Radio Prishtinë. Grupet prisnin për termin, ndaj ushtronin mirë që kënga të incizohej si duhet. Pasi ka kaluar disa filtra, ajo këngë pastaj promovohet e plasohet si duhet. Këngët e mira merrnin mbështetje edhe nga udhëheqësit e emisioneve, që ishin njerëz që dinin e jo injorantë. Prandaj, njiheshin grupet me vlerë (si këto që u përmenden më lartë) dhe atyre u jepej prapë shansi për incizime tjera.

Nuk duhet harruar se dikur janë incizuar edhe shumë këngë të dobëta (p.sh. si të Fisnikëve). Por, në përgjithësi kishte konkurrencë të vlerave; kishte njerëz që njihnin dhe promovonin vlerën; dhe, kryesorja, tentohej që masat ta njohin atë vlerë. Për këtë "censurë", apo më mirë të themi për këta filtra vlerësimi dhe promovimi,



Kozeta Kurti

kemi më shumë se kurrë sot nevojë, kur mediokriteti ka kapluar artin dhe kulturën tonë.

– **Gjykuar nga ajo që po shohim sot, kush kë e ndikon më shumë: tregu muzikën apo muzika tregun?**

Kozeta Kurti: Që të flasim për këtë, duhet të kemi edhe treg, edhe muzikë. Kemi pak muzikë, shumë përpjekje të mundimshme "fast food" për të bërë muzikë dhe zero treg. Në këto kushte, unë e kam të pamundur të flas për raportin midis tyre. Kur një konsumator muzike të më thotë se si dhe ku e blen muzikën shqiptare, kur një krijues të më thotë se ku e shet muzikën e vet (në rastet më të mira në club-e, ku sukcesi varet nga sa fatura alkooli priten në banak) atëherë secili nga ne, do ta ketë më të thjeshtë të japë përgjigje. Tregu i muzikës nuk matet nga numri i ndjekësve në rrjete sociale.

"SOT, KEMI PAK MUZIKË, SHUMË PËRPJEKJE TË MUNDIMSHME "FAST FOOD" PËR TË BËRË MUZIKË DHE ZERO TREG" – KOZETA KURTI

Agron Shala: Që të dyja. Sepse, tregu është i çoroditur dhe muzika e çoroditur. Sot nuk kultivohet as muzika folklorike e as ajo popullore dhe ata që dikur merrshin me këto zhanre, degraduan në favor të të mirave materiale. Rocku është në margjina dhe ka pak gjasa ta zë vendin që kishte dikur. Prandaj, shoqërinë e karakterizon më shumë servilizmi sesa fryma e rebelimit.

Në anën tjetër, shpesh dëgjoj se si hip-hopi i Kosovës është kinse nga më të zhvilluarit në rajon. E thash më lart, edhe rocku në Kosovë dikur ka qenë para shumë shteteve, mbase edhe para Rusisë e Kinës, por etalon vlerësimi ishte dhe mbetet Perëndimi.

Tash gjithçka është tallava. Sidomos tekstet. Ka pak ide e mendime. Askush nuk merret me të vërtetën. Gjithçka është mashtrim, përderisa promovohet një subkulturë e huaj dhe një realitet i rrejshëm. Askush nuk tenton ta rregullojë këtë treg. Madje ky kaos gjen mbështetje nga politika, e sidomos nga mediat, për çka ky marsh i çoroditjes po merr çdo herë e më shumë ndjekës.

Për fund, të ndalemi pak te muzika punk. Një nga momentet më të rëndësishme të kulturës që përfaqësonte kjo muzikë, është kur Johnny Rotten (Sex Pistols), fanellës me grupin Pink Floyd, lart ia shton fjalët "I Hate" (Urrej). Më vonë, kur i bën do vjet e piqet me përvojë e dije, deklaroi se nuk e ka urreyer grupin Pink Floyd. Sepse, vërtetë, cili njeri që di diçka mund ta ketë këtë urrejje? Kjo të shtyn të mendosh se te ne, fatkeqësisht, ka veç tinxherë të përtjetshëm që nuk piqen. Prandaj... bëhet mirë!?

KROACI: ZHELKO LLUKETIQ, KURATOR I EKSPOZITAVE TË MUZIKËS DHE KINEMASË JUGOSLLAVE

Konformizmi i artistëve ndaj së kaluarës socialiste

Shumë artistë propagandonin të mirat e socializmit gjatë periudhës jugosllave. Përderisa disa e besonin me të vërtetë, kjo propagandë promovohet para së gjithash nga regjimi, që financoi qindra disqe muzikore për lavdinë e tij. Në korrik, një ekspozitë në Zagreb gjurmoi dhe shfaqti historinë e këtyre disqeve muzikore "revolucionare dhe patriotike". Intervistë.

INTERVISTOI : NIKOLLA RADIQ

Lindur më 1972, Zhelko Lluketiq është një kritik, gazetar dhe kurator i ekspozitave të specializuara në muzikën dhe kinemanë jugosllave. Student i doktoratës në Departamentin e Letërsisë, Filmologjisë, Kulturës dhe Arteve Skenike të Fakultetit Filozofik në Zagreb, ai e inicioi organizimin jofitimprurës të arkivimit dhe studimeve audiovizuale 'Jučer Danas Sutra' (Dje Sot Nesër), si dhe themeloi labelin 'Fox&His Friends' kushtuar ribotimit në vinil, të gjërave të rralla muzikore nga ish-Jugosllavia. Lluketiq është kurator i ekspozitës "Grafizmi utilitar i socializmit të kënduar më 1947-1990", kushtuar dizajnimit të kopertinave vinile të "muzikës revolucionare dhe patriotike" të Jugosllavisë socialiste, të organizuar nga 14 deri më 24 Korrik në galerinë e Shoqatës së Grafistëve të Kroacisë (HDD) në Zagreb.

– Si u zhvillua lidhja midis muzikës dhe politikës në Jugosllavi nga 1947 në 1990? A ishte e qëndrueshme diskografia "revolucionare dhe patriotike"?

Zhelko Lluketiq: Sponsori më i madh ishte shteti, me institucionet dhe strukturat e tij të ndryshme. Kjo varionte nga vetë Partia Komuniste, e cila xhironte disqe për kongreset e saj, e deri te organizatat rinore dhe kulturore, pa i haruar administratat komunale, të ngarkuara me vendet përkujtimore, të cilat mund t'i përdorin ato për përkujtimet e tyre. Por disqe të tjera ishin vepra spontane, të prodhuara nga muzikantët e frymëzuar sinqerisht nga ideja e një identiteti supranacional jugosllav. Disa të tjerë edhe kishin ndonjë interes ekonomik për t'u bashkuar kësaj mode. Në të vërtetë, disa nga këto këngë bëheshin hite dhe shiteshin shumë. Mund të themi se kjo lëvizje muzikore revolucionare dhe patriotike ishte një simbiozë teorikisht e suksesshme e politikës, muzikës dhe propagandës.

Periudha e mbuluar nga ekspozita shkon nga 1947, vit ky i krijimit të 'Jugoton', kompania e parë dhe më e madhe diskografike jugosllave, e deri më 1990, vit i shpërbërjes së Jugosllavisë dhe i daljes së « Ustanak i more » (Kryengritja dhe deti), përmbledhje e këngëve më të mira nga programi eponim i Festivalit të varietetit të Splitit kushtuar muzikës revolucionare dhe

patriotike.

Nga 1990, disqet braktisin kodet vizuale të socializmit, që do të thotë emblemat, kokardat dhe monumentet e revolucionit dhe të rinisë së lumtur në punishtet, duke i zëvendësuar ato me peisazhe të Splitit që gjasonin me karta postare.

Në vitet 1960, Jugoton shtypte deri në dhjetë million vinile në vit. Labele të tjera u krijuan përgjatë viteve dhe ky numër nuk ka ndaluar së rrituri. Por disqet revolucionare dhe patriotike nuk firmoheshin nga producentët zyrtarë. Partneri im, ligjëruesi universitar Leri Ahel dhe unë grumbulluam 1000 disqe të muzikës revolucionare, 200 prej të cilave i kemi shfaqur në kuadër të ekspozitës.

– Si e inkurajonte shteti prodhimin e kësaj muzike propagandistike? Dhe si po monitorohej apo edhe censurohej muzika dhe modeli i kopertinës?



Zhelko Lluketiq

ZH.LL: Duke i financuar koncertet dhe kompozimin, duke organizuar festivale të specializuara, por edhe indirekt duke i përjashtuar artistët nga e famshmja « taksa mbi këngën », të vendosur më 1971. Të gjitha disqet me "vlerë të jashtëzakonshme muzikore" lroheshin automatikisht prej saj, ndërsa taksoheshin shumë muzikat që vlerësoheshin nga komisionet kulturore, se i nënshtroheshin shijes së ulët të masave. Ato kushtonin dy herë më shtrenjtë dhe rrjedhimisht, ato ishte një investim i rrezikshëm për producentët. Sa për kopertinat, kompanitë diskografike i refuzonin rrallëherë. Vetëm disa kopertina u refuzuan në historinë e diskografisë jugosllave, si p.sh : versionet e modifikuara ose ato të Bijello Dugme (grupi pop-rock i Goran Bregoviqit, shënim i redaktorit) që nuk u shtypën kurrë.

Viktima e parë e kësaj takse



ishte Jugo, moja Jugo (1971) e këngëtares Silvana Armenuliq, një mishërim i neo-folkut që këndohej për disa vjet në kafana (kafehanat e njohura burleske). Kopertina me gjoksin shumë të ekspozuar të këngëtares nuk përputhej aspak me vizionin e partisë, që e pretendonte promovimin e muzikës cilësore. Nga ana tjetër, muzika tradicionale tolerohej, si shprehje e muzikës autentike popullore. Një seri e tërë e këtyre këngëtarëve i këndonin revolucionit, Titos dhe dashurisë së tyre për federatën socialiste, të veshur me rroba tradicionale të popujve të ndryshëm jugosllav.

Në përgjithësi, militantizmi propagandistik titist përpiquej ta kufizonte ndikimin kulturor të 'kapitalizmit të kalbur', por i censuronte rrallëherë prodhimet muzikore. Ky sistem "fleksibël", i paklasifikueshëm, që gjindej në muzikë, kinematografi, dizajn dhe disiplina të tjera kulturore, nuk ishte aq i ngurtë sa ai pra Perdes së Hekurt, por ishte sistem i veçantë, herë lejues, herë vetëmohues, por edhe i hapur ndaj ndikimeve.

Komisionet e ndryshme shtetërore kishin disa rregulla të shenjta. Për shembull, shoku Tito duhej të paraqitej në kopertinën e çdo kopertine të këngëve për nder të tij ose pjesë nga fjali-met e tij. Komisionet siguronin që përfaqësimi i Tito-s të ishte klasik dhe figurativ, sa më pak eksperimental. Numri i disqeve dhe i porosive muzikore nga organet politike u rrit pas Pranverës Kroate të vitit 1971. Ideja ishte të afroheshin produktet muzikore me audiencën më të re pop-rock. U relaksuan rregullat ndaj të cilave nënshtroheshin muzika dhe dizajni, para se të zhdokeshin krejtësisht pas vdekjes së Tito-s, kur mbrëmjet me muzikë revolucionare dhe patriotike u bën pjesë e festivaleve të estradës si 'Zagrebfest' ose Festivali i Varieteteve në Split.

– Shumë yje të famshëm jugosllavë, si Gjorgje Ballasheviq ose Zdravko Čolliq për shembull, prodhuan këngë në këtë regjistër. Si e pozicionojnë veten këta artistë sot në lidhje me këto episode të karrierës së tyre?

ZH.LL: Disa e bënin vetë, të tjerët ftoheshin në festivale. Festivale të transmetoheshin në televizion dhe këngëtarët bëheshin shumë të popullarizuar. Në një vend me 25 milion banorë dhe me vetëm dy kanale televizive, kjo nënkuptonte një shikueshmëri të jashtëzakonshme për interpretuesit. Nga ana tjetër, gjatë shërbimit të tyre ushtarak, muzikantët lejoheshin të bënin muzikë, në vend se të mbanin kujdestari natën dhe të pastronin armët. Për shembull, në kopertinën e 'Tri put sam video Tita' (Unë pashë Titon tre herë) nga grupi i tij 'Rani mraz', Gjorgje Ballasheviq pozon me uniformë ushtarake pranë një busti të Tito-s. Kishte artistë si ai që i besuan sinqerisht idesë së Jugosllavisë dhe kishte të tjerë prej cilëve pritej të jepnin kontribute të tilla.

Kompozitorët që kam intervistuar së fundmi thonë se askush nuk i ka detyruar ata. Për shembull, 'Korni grupa' e Kornelije Kovač regjistroi albumin konceptual të rokut progresiv '1941' me vokalistët Josipa Llisac dhe Dado Topiq, një projekt i edituar nga RTB e TV Beogradit, ndërsa 'Alfi Kabiljo' u ftua nga TV Zagrebi për ta regjistruar këngën e serialit 'Nepokoreni grad'. Për këta artistë, kjo ishte një mundësi për të punuar në kushte të shkëlqyera dhe për ta pasur produksionin më të mirë të mundshëm.

Megjithatë ka disa artistë që sot e mohojnë këtë të kaluar ose përpiquej ta fshijnë nga biografitë e tyre, qoftë për shkak se tani i përkasin kampit kundërshtar politik,

qoftë për shkak se pretendojnë se ishin të detyruar të veprojnë në atë mënyrë. Sidoqoftë, në vend se të përpiquej ta fshihim ose ta mohojmë këtë të kaluarë, sigurisht se do të ishte më mirë ta debatohet hapur.

– A nxitu ekspozita juaj reagime negative?

ZH.LL: Jemi befazuar më së shumti me jehonat pozitive, mbulimin mediatik, interesimin dhe reagimet e publikut. Ndodhi vetëm një incident, kur gjatë montazhit të ekspozitës, një i panjohur hyri në galeri duke bërë titur: "Tito, kriminel!". Iku po aq shpejt sa hyri. Pastaj duhet kuptuar se ekspozita nuk ka të bëjë me Titon dhe Partinë. Ajo nuk është as ndonjë projekt jugonostalgjik, por thjesht një shpërfaqje e marrëdhënies historike midis muzikës, propagandës dhe dizajnit.

– Pse artistët në Kroaci kanë frikë t'i fërkojnë supet me të kaluarën e tyre socialiste jugosllave? Dhe si e shihni faktin që shumë prej këtyre kopertinave përfunduan në plehra pas luftërave të viteve '90?

ZH.LL: Të gjitha prodhimet kulturore dhe artistike, pavarësisht kontekstit nga vijnë, duhet të ruhen dhe studiohen. Neveritem kur i shoh sot të shkatërruara, por mbase është çështje psikologjike. Këtë heshtje domethënëse, të cilën ju e interpretoni si frikë, unë e shoh më shumë si konformizëm. Leri Ahel dhe unë gjurmuan në tregjet e sendeve të vjetra dhe bodrumet me pluhur, për të shpëtuar disa nga disqet që i ekspozuam. Prej se e themeluan 'Jučer Danas Sutra', njerëzit na japin edhe koleksionet e tyre private ose gjërat që donin të hidhnin, sepse e dijnë që ne do t'i ruajmë, restaurojmë, digjitalizojmë dhe zbulojmë për publikun.

(Courrier des Balkans)

VËSHTRIM

Drejt paradigmës së ekonomisë qarkulluese

Zhvendosja e ekonomisë së vendeve të zhvilluara drejt shërbimeve gjatë tridhjetë viteve të fundit ka patur pasojë të matshme në pabarazinë sociale dhe ekonomike. Ndërsa fabrika e shekullit XX siguronte një rrugë të qëndrueshme drejt klasës së mesme, ekonomia e mijëvjeçarit të ri ka shenjuar një thyerje të ashpër midis punonjësve të keqpaguar të shërbimit dhe bonuseve të larta të klasës krijuese në ekonominë e re të dijes.

NGA DITJON BABOÇI

Biologjikisht secilit prej nesh i nevojiten 90W energji për të jetuar, njësoj sa një lllampë e thjeshtë inkandeshente. Por prej gati dy shekujsh si qenie urbane secili prej nesh konsumon mesatarisht 100 herë më shumë nga sa i nevojitet. Revolucioni industrial është pasuar nga një ortek inovacioni çka e ka shtyrë Paul Crutzen ta quajë kohën në të cilën jetojmë si era e antropocenit: tashmë shfrytëzohet në një mënyrë apo në tjetër më shumë se 50% të sipërfaqes së planetit. Përgjatë treqind viteve të fundit popullsia e tokës është dhjetëfishuar, ndërsa konsumi i energjisë është gjashtëmbëdhjetëfishuar vetëm në shekullin e fundit.

Antropoceni në fakt nuk është thjesht një shenjues i historisë, por një mentalitet i ri i cili duhet metabolizuar një orë e më parë. Dekadat e fundit ka patur një ndjeshmëri gjithnjë në rritje ndaj riskut të panjohur të pasojave të ekonomisë tradicionale bazuar në prodhim dhe konsum masiv. Është e qartë tashmë se modeli ynë ekonomik ka rreshtur së funksionuari: kjo ndihet në çdo aspekt të jetës njerëzore, nga impakti në klimë te pabarazia ekonomike.

Shprehja “çudia më e madhe zgjat tre ditë” ilustron me së miri vështrësinë e trurit për ta kuptuar ndryshimin midis rritjes aritmetike dhe asaj eksponenciale. Çuditë eksponenciale rëndom shkelin kufinj të arsyeshmë. Rritja e ekonomisë botërore në dyqind vitet e fundit ka një kurbë eksponenciale. Kjo do të thotë se e ardhmja, bëhet e tashmja, gjithnjë e më shpejt. Një nga arsytet përse problemet me të cilat përplasemi ngjajnë gjithnjë e më të vështira apo të pamundura për t'u zgjidhur, është fakti se zhvillimi ekonomik botëror po arrin një pikë kritike. Sfidat e tridhjetë viteve të ardhshme janë një provim pa mundësi përsëritjeje. Dilemat energjiti dhe mjedisore me të cilat do të duhet të përballlemi nuk kanë ekzistuar më parë dhe nuk do të ekzistojnë më, nëse arrijmë t'i tejkalojmë me sukses. Situata që po kalojmë veçse e rrit ndjeshmërinë ndaj jetës në shekullin XXI: e paqëndrueshme, e pasigurtë, e paqartë dhe tejet komplekse. Pandemia amplifikon mëtej nevojën për të marrë disa vendime të rëndësishme: mund të jetë një shans për ta përmirësuar status quo-n, ose mund ta rizgjojë instiktin e konsumit të papërgjegjshëm të shekullit të fundit. Në vitin 1854, Londra kishte aq riciklues urbanë sa nëse një ditë do të themelonin qytetin e tyre do të ishin qyteti i pestë më i madh në Britani: mbledhës leckash apo riperdorues bakri, ata përbënin një rjet kompleks ricikluesish informal të cilët i mbijetonin përditshmërisë duke nxjerrë bukën e gojës nga plehrat e qytetit.

Konsumi

Prodhimi në masë e si pasojë modulariteti dhe standardizimi i mes-shekullit të kaluar bëri të mundur mirëmbajtjen e paisjeve dhe teknologjisë. Të gjithë e kemi çuar të paktën njëherë, televizorin te tekniku gjatë viteve 90. Në dekadën e fundit ama edhe riparimi apo mirëmbajtja u cilësua anatëmë e komodifikimit të mëtejshëm të produkteve të përditshme: kështu smartphone-ve tanë sot nuk

mund t'i ndërrojmë më as baterinë. Kjo patjetër lehtëson vjetërimin e qëllimshëm dhe të panevojshëm të produkteve të konsumit.

Paradigma aktuale tenton t'i minimizojë kostot nëpërmjet prodhimit në masë e duke injoruar të gjitha eksterenalitetet e ngulitura në produktin final. Këto jashtësi ama nuk zhduken në eter: ato precipitojnë rreth e rrotull nesh: në ajrin që thithim, në ujën që pijmë e ushqimin që hamë. Shpërdorimi në prodhim ama nuk duhet të na çudisë. Në fund të fundit biznesi ka për qëllim parësor rritjen e fitimit, jo të efikasitetit të materialeve.

Nuk duhet haruar se asnjë ndryshim i paradigme aktuale nuk mund të ndodhë pa adresuar thelbësisht qasjen kulturore ndaj prodhimit dhe konsumit. Tendencat për “konsum të dukshëm”, pra shpenzimi i parave për produkte të shtrenjta që shërbejnë si një reklamë publike e pasurisë së blerësit është identifikuar që në 1899 nga Thorstein Veblen. Makina e shtrenjtë e një shoferi që jeton me qira, është shembulli ‘par excellence’ i Veblenit në Evropën Lindore të shekullit XXI.

Të bërit pazar shihet nga disa edhe si reaktion ndaj modernitetit. Një akt kaq i rëndomtë që formëson gjysëm-fshehur klasat sociale dhe ekonomike të një shoqërie moderne. Pa dashje gjeneron edhe një spirale palumturie: aspiratat për të konsumuar produkte gjithnjë e më të shtrenjta rriten proporcionalisht me zerot në llogarinë bankare, një tjetër universale e përmbledhur nga togëfjalshi tradicional: “njeriu do atë që s'ka”.


Politikisht është thuar se pamundur të imagjinohet një lider që i premtonte qytetarëve më pak, ose në rastin më të mirë, kaq sa ç'kemi sot. Konsumi material në shoqërinë e sotme i përngjason në fakt një varësie psikologjike, por që ndryshe nga duhani apo bixhozi, është mimitizuar përtej kufijve kulturorë e kombëtarë, si një sjellje normale e shoqërisë njerëzore.

Degradimi mjedisor dhe shoqëror

Çelësi në adresimin e modelit “merr-përdor-hidh” është shmangia e aktiviteteve që zhvlerësojnë materialet në çdo cikël të prodhimit a përdorimit.

Ekonomia qarkulluese përngjason me të vetmin variant të së ardhmes që mund të ruajë prosperitetin ekonomik, por duke e divorcuar atë nga degradimi i pashmangshëm mjedisor dhe shoqëror. Një politikë më e shëndetshme mund të incencivojë edhe një kosto më të lartë në prodhim, me qëllim ruajtjen ose akoma

teknikisht dhe të mirëpaguar. Riparimi dhe përmirësimi i produkteve ekzistuese është një traditë e rëndësishme dhe ndërësa ka kosto më të lartë direkte, ka shumë më pak eksternalitete sesa modeli aktual i komodifikimit të punës. Rivlerësimi i punës prodhuese do të ndihmonte edhe në adresimin e pabarazive strukturore, duke rritur thellën e të ardhurave nga puna kundrejt të ardhurave nga kapitali.



Përtej skepticizmit gjakxehtë të pandemisë e ardhmja e botës do të jetë kokëfortësisht urbane. Pavarësisht situatës ku ndodhemi ama, prej vitesh gjenerata e internetit ka një qasje gjithnjë e më autarkike, sidomos në terma të ekonomisë e prodhimit. Vlera e shtuar në nivel lokal a rajonal do të marrë gjithnjë e më shumë rëndësi, ndihmuar nga teknologjia dhe dëshira për të qenë sa më i pavarur nga një sistem që siç u tregua edhe nga pandemia funksionon një hap larg buzës së greminës. Impakti i printimit aditiv 3D, duke minimizuar përdorimin e materialeve, por ndërkohë duke lejuar produkte ad-hoc të dizajnuara sipas dëshirave të individit, ka potencialin ta kthejë përmbyss modelin e sotëm.

Dekada e fundit ka parë një sërë ndryshimesh në qasjen ndaj ekonomisë së shërbimeve. Një rol kyç ka luajtur ekonomia e bashkëpërdorimit (Airbnb apo Uber) ku një objekt në pronë të dikujt vihet në dispozicion të dikujt tjetër sipas kërkesës. Ky model ka stimuluar një përdorim më eficient të disa aseteve. Gjithashtu shumë prej nesh janë tashmë të “abonuar” në shërbime të ndryshme: makineta e kafesë me kapsula apo dekoderi i televizorit gjendet në shumë shtëpi të kryeqytetit. Ky model abonimi rrit interesin që ofruesi i shërbimit ka në jetëgjatësinë e produktit. Sa më rrallë të ndryshohet dekoderi apo makineta, aq më të larta fitimet e biznesit.

Tërmeti i nëntorit të vitit të kaluar në Shqipëri, ishte një provë e dhimbshme se asgjë nuk është e përrjetshme. Si çdo produkt tjetër, edhe ndërtesat kanë një jetëgjatësi të përlogaritshme. Në bazë të materialit dhe tipit të teknologjisë së ndërtimit një strukturë moderne mund të jetojë për 50 deri në 100 vjet, duke kërkuar pastaj ndërhyrje mirëmbajtjeje progresive që shumë shpejt tejkalojnë kostot e rindërtimit. Por sfida nuk është vetëm të ndërtesat që duhen rindërtuar. 70% e objekteve që do të duhen për të

na strehuar në vitin 2050 ende nuk janë ndërtuar. E ardhmja e industrisë së ndërtimit duhet të jetë fleksibël dhe modulare. Teknologjia duhet të minimizojë përdorimin e materialeve të virgjëra dhe të rrisë lehtësinë e mirëmbajtjes dhe riparimit të çdo komponenti të ndërtesës së të ardhmes. Infrastruktura e të nesërme do të duhet të gjenerojë energjinë e saj dhe të funksionojë me një cikël të mbyllur të ujit e materialeve të tjera.

Këmbëngulja e minoritetit për ndryshime të mëdha

Katër janë qasjet më të mundshme që na çojnë drejt këtij ‘zeitgeist’ të ri të ekonomisë urbane: dizajni eficient i produkteve, nikoqirllëk në proceset prodhuese, ripërdorim e rijetësim efikas i produkteve dhe incencivim i përdorimit të materialeve të rinovueshme. Potenciali i dizajnit në produkte apo ndërtesa do të kishte impakt të lartë, aktualisht rreth 30% e materialeve të një strukture mund të kursheshin nëpërmjet një projekti më të mirë. Amballazhet e produkteve të konsumit mesatarisht prodhojnë 30kg mbeturina plastike në vit për çdo banor të BE. Një dizajn më i mirë i tyre mund të kishte një impakt të qenësishëm në plehrat e dëmshme plastike. Më tej rreth 25% e çelikut dhe 50% e aluminit nuk arrijnë kurrë në duart e konsumatorit, por shpërdorohen gjatë proceseve prodhuese. Trajtimi i këtyre mbetjeve si skrap ka kosto të konsiderueshme energjiti dhe dizajni me eficient do të ndihmonte në uljen e mbetjeve të paarsyeshme në procesin e prodhimit.

Duhet mbajtur mend ama se rritja e efikasitetit nuk sjell detyrimisht ulje të volumit absolut të konsumit. Kjo ide disi kontradiktore është artikular në shekullin XIX nga ekonomisti William Stanley Jevons. Një shembull i thjeshtë i paradoksit të Jevonsit është konsumi i automjeteve. Edhe pse efienca matur në km/litër është rritur në mënyrë të vazhdueshme në shekullin e fundit, volumi total i karburantit të përdorur për lëvizshmërinë është rritur eksponencialisht. Pra në historinë e botës pas revolucionit industrial, rritja e efikasitetit së përdorimit të një resursi nuk ka sjellë kursim, por është përkthyer në rritje të volumit total të konsumit të këtij të fundit: shembuj tjetër është energjia elektrike, e cila kushton qindra herë më lirë se para një shekulli në sajë të rritjes së efikasitetit, dhe pikërisht për këtë arsye shërben dhe si infrastruktura jetësore e jetës njerëzore.

Nassim Taleb shpjegon se si vendosmëria e një grupi të vogël kokëfortë mund të precipitohet ndryshime të mëdha të një shumicë e painterësuar. Nëse 3-4% e klientëve në një lokal do të kërkonin me këmbëngulje mospërdorimin e pipave plastike, do të ishte në interesin e lokalit të kapërdinte koston margjinalisht më të lartë të pipave të kartonit për ta shmanjur sikletin dhe kërkesën e përhershme të minoritetit kokëfortë. Kjo edhe sepse shumicës së painterësuar të klientëve nuk i bën ndryshim materiali i pipës në kokteilin e tyre. Ndaj ndryshimi i një paradigme ekonomike dyqind vjeçare me interesa të ngulitura biznesi nuk është i thjeshtë, por nuk është as i pamundur. Duhet veçse këmbëngulje nga një minoritet kokëfortë.

(Autori është Arkitekt nga Tirana)

TEORITË E KOMPLOTEVE DHE KONSPIRACIONI NACIONALIST

Konspiracionet ballkanike dhe shteti-komb

Si përfundojnë teoritë e komplotëve duke ndikuar shoqëri të tëra? Shpërbërja e Jugosllavisë ndodhi edhe sepse politikanët mundësuan dhe zhvilluan ide konspiracioniste. Një fenomen ky që po përhapet sot në pjesët e tjera të botës.

NGA SINISHA MALLESEVIQ*

Njerëzit që nuk besojnë në teori konspirative iu duket të menduarit konspirativ qesharak apo i çuditshëm. Teoricienët konspiracionist shpesh konsiderohen të jenë psikologjikisht jostabil, naiv apo të shkëputur nga realiteti. Disa studime psikologjike tregojnë se individët që i besojnë fuqishëm konspiracionit kanë çregullime të personalitetit skizotipike dhe kanë prirje të gjenerojnë kuptime dhe qëllime nga asgjëja.

Përderisa identifikimi i profilit psikologjik mund të na ndihmojë ta kuptojmë kornizën e mendjes të një konspiracionisti tipik, ky hulumtim nuk përben mjet adekuat për ta shpjeguar teorinë konspirative si fenomen masiv. Kur konspiracionistët mbeten në margjinat e shoqërisë, ata edhe mund të anashkalojnë si jostabil psikologjikisht apo paranojak. Por shpjegimi psikologjik nuk është i mjaftueshëm kur miliona individë fillojnë të besojnë në konspiracion dhe kur kjo kornizë interpretuese shndërrohet në diskurs dominues shoqëror.

Konspiracionet në hapësirën jugosllave

Në fund të 80-tave dhe në fillim të 90-tave, Jugosllavia ka pësuar një zhvendosje dramatike interpretuese. Shpërbërja dramatike e shtetit federativ është paraprirë dhe pasuar nga përhapja e papritur e teorive të ndryshme konspirative, si idetë që shteti qenka copëtuar qëllimisht nga Vatikani, Masonët e Lirë, Lobi Hebrej, etj.

Këto teori të ndryshme pretendonin se CIA dëshironte të ndërtonte "Rendin e Ri" amerikan, që islamistët dëshironin krijimin e "Trajektores së Gjëlber" që do t'i lidhte popujt myslimanë evropianë me Turqinë, apo që Gjermania e bashkuar synon të themeloi "Reich-un e Katërt" dhe kështu me radhë. Populli jugosllav deri atëherë indiferent ndaj teorive të komplotit e pranoi papritmas dhe masivisht

këtë kornizë interpretuese, si në sferën private ashtu edhe në atë publike. Prej atëherë, ato mbeten të pranishme në debatet intelektuale, media, zhvillime politike dhe fetare, si dhe në protesta masive. Ato janë po ashtu të pranishme në bisedat personale midis miqve dhe anëtarëve të familjes. Megjithatë këto teori konspirative kanë nevojë për rrëfime të ndryshme dhe shpesh reciprokisht përjashtuese, si dhe për një larmi kërcënimesh dhe armiqsh, të gjitha këto ide u mblodhën rreth një teme të përbashkët: "Kombi është në rrezik".

Prandaj teoritë konspirative serbe, të cilat ishin më të mëdha në këtë periudhë, u përqëndruan në aktorët e jashtëm, për të cilët gjykohej se ishin duke komplotuar në shpërbërjen e Jugosllavisë dhe të popullit serb: Vatikani po synon ta dobëson ose zhdukë Kishën Ortodokse Serbe duke i konvertuar me forcë serbët në katolicizëm; Urdhëri Masonik; Lobi Hebre dhe korporatat amerikane synon kapjen e tregjeve të reja duke e shkatërruar ekonominë serbe dhe jugosllave; Gjermania e bashkuara e kancelarit Kohl dhe e Ministrisë të Jashtëm Gensher favorizojnë Slloveninë dhe Kroacinë duke aspiruar kolonizimin e serbëve dhe përfshirjen e tyre nën sundimin e "Reichut të Katërt"; politikanët amerikanë si Bush dhe më vonë Clinton synojnë krijimin e "Rendit të Ri" Botëror në kurriz të Rusisë dhe Serbisë; fuqitë myslimane si Turqia dhe Arabia Saudite komplotojnë për ta përçarë dhe skllavëruar popullin serb përmes themelimit të "Korridorit të Gjëlber" në mes të Bosnjës, Sanxhakut në Serbi, Kosovës, Shqipërisë e deri në Turqi etj. Në të gjitha këto rrëfime, populli serb paraqitej si viktimë i cili po përballlej me armiq të pamëshirshëm dhe që duhej mposhtur me çdo kusht.

Teoritë konspirative kroate përqëndroheshin në komunizmin dhe në Jugosllavinë, si diçka që i imponua kroatëve kundër vullnetit të tyre për ta avancuar

krijimin e Serbisë së Madhe në tokat kroate. Në disa nga këto narrativa komplotiste, SHBA, Mbretëria e Bashkuar dhe lobi hebre-masonik-serb fajësoheshin për themelimin dhe ruajtjen e shtetit jugosllav. Disa konspiracione tjera rrëfenin se si serbët dhe Kisha Ortodokse Serbe komplotonin vazhdimisht gjatë historisë për t'i asgjësuar ose konvertuar kroatët, si dhe për shkatërrimin e besimit të krishterë në Kroaci. Disa rrëfime shpërfaqnin dhe komplotin hebreo-bolshevik si nxitës të dominimit komunist të Kroacisë dhe të rezistencës ndaj pavarësisë së Kroacisë. Konspiracione të tjera rrëfenin për komplotin mysliman për zhvendosjen e kroatëve nga Bosnja dhe Hercegovina, ashtu që të themelohej një kalifat mysliman në Evropë.

Megjithatë këto teori konspirative qarkullonin shumë kohë para shpërbërjes së Jugosllavisë, ato u bënë korniza dominuese interpretuese për shumë qytetarë, vetëm pak vite para shembjes së shtetit. Elitat politike dhe kulturore luajtën një rol qendror në krijimin e hapësirës për përhapjen e shpejtë të këtyre narrativave konspirative. Kur këto narrativa arritën të zënë vend qendror në mediat e mëdha dhe në mjetet e tjera propaganduese shtetërore, ato kontribuan në shpërthimin e dhunës dhe në arsyeshmërinë e qëllimeve të luftës.

Gjatë luftërave 1991-1995 në Kroaci dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë, teoritë e konspiracionit ishin përbërësi kryesor i propagandës zyrtare shtetërore. Përkundër larmisë së qartë të përmbajtjes së këtyre rrëfimeve, të gjitha artikulojnë dhe shpallën idenë se si kombet e tjerë janë përpjekur gjithmonë të "na" shkatërrojnë dhe se duhet t'i luftojmë "ata" për të mbijetuar. Ky mesazh ishte ngulitur fort në rrëfimet historike të viktimit dhe të trimërsë. Në konspiracionet serbe, serbët ishin gjithmonë fitimtarë në luftëra, por më pas tradhëtoheshin nga të tjerët. Autorët nacionalistë artikulojnë fraza

të tilla sikurse "serbët ishin trashëgimtarët e njerëzve të masakruar" ose që "serbët fitojnë gjithmonë në luftë, por humbin gjithmonë në paqe".

Në rrëfimet konspirative kroate, kroatët përshkruheshin si të vuajtur përgjatë tërë historisë, për shkak të veprimeve perfide të kombeve të tjerë që prodhuan skllavërimin e tyre. Kësisoj, liderët nacionalistë kroat përhapën nocionet pothuajse mistike të vazhdimësisë mijëvjeçare të kombit kroat, ku secili kroat duhej ta ndiqte devizën: "Gjithçka dhe gjithmonë për Kroacinë, për Kroacinë tonë të vetme dhe të përjetshme, e për asgjë tjetër në botë".

Logjika konspirative që i nënkupton këto vizione e paraqesin historinë si një lojë pa fitues, ku kombet fqinje dhe aleatët e tyre kanë komplotuar gjithmonë kundër "neve", porse pavarësisht forcës së tyre superiore dhe ligësisë së tyre çnjerezore, nuk kanë arritur kurrë të na mposhtin. Këto rrëfime kundërthënëse legjitimuan shpërthimin e luftës, mobilizuan individë për të luftuar dhe më vonë justifikuan mbi 120.000 të vdekur dhe zhvendosjen e afër 5 milion njerëzve. Teoritë e komplotit luajtën një rol qendror në shpërbërjen e dhunshme të Jugosllavisë.

Teoritë konspirative në SHBA dhe Mbretërinë e Bashkuar

Në vitet e fundit vërejmë një përhapje të ngjashme të shpejtë të ligjërimeve konspirative në shumë pjesë të botës. Disa sondazhe në shkallë të gjerë kanë konfirmuar se teoritë e konspiracionit janë bërë mainstream dhe shumë të popullarizuara në gjithë globin. Disa nga këto rrëfime sfidojnë shpjegimet shkencore të fenomeneve të ndryshme me komplotet kundër vaksinimit që fajësojnë "Big Farma", Bill Gates ose lobin shkencor, për programet e shpërthimit dhe vaksinimit të Covid 19, ndërsa komplotistët anti-teknologji lidhin

përhapjen globale të pandemisë me rrjetin 5G dhe përdorimin e telefonave celular. Konspiracionet e tjera janë përqëndruar në korporatat e biznesit, interesat mjedisore dhe pushtetin shtetëror (d.m.th. Chemtrails, kampet FEMA, patatet e skuqura RFID etj.). Disa konspiracioneve i është rritur ndikimi në prag ose gjatë Brexit, si dhe me zgjedhjen e Donald Trump në SHBA.

Disa anketa tregojnë qartësisht se mbështetësit e Brexit dhe Trump kanë më shumë prirje të besojnë në teoritë e komplotëve dhe konspiracioneve nacionaliste. Sondazhi i "YouGov" tregon se afër 50% e njerëzve që votuan për Trump dhe Brexit besojnë se qeveria po e "fsheh të vërtetën" në lidhje me imigracionin. Ata gjithashtu mbështesin deklaratat si: "Imigracioni mysliman është pjesë e një plani më të madh për t'i bërë myslimanët shumicë" dhe se "Pavarësisht se kush është zyrtarisht në krye të qeverive dhe të organizatave të tjera, ekziston një grup i vetëm njerëzish që fshehurazi kontrollon ngjarjet dhe sundon botën". Përkrahësit e Brexit shpesh e kanë përshkruar BE-në si një komplot imperialist për ta pushtuar dhe privuar Mbretërinë e Bashkuar nga sovraniteti i saj dhe për ta zbehur strukturën e saj etnike. Ndërsa mbështetësit e Trump identifikohen me komplotet nacionaliste, si ato lidhur me idetë e Gjenocidit të Bardhë, Deep State, Planit Azatlan, projektit të Unionit të Amerikës së Veriut dhe të shumëllojshmërive komplotiste që përfshijnë George Soros.

Komploti i Gjenocidit të Bardhë fajëson hebrenjtë dhe liberalët për promovimin e përzjerjes së specieve njerëzore, integrimin racor, abortin dhe imigracionin jo të bardhë në shkallë masive, për ta shkatërruar SHBA-në, si një komb me shumicë të bardhë. Unioni i Amerikës së Veriut dhe Plani Azatlan janë teori konspirative që dyshojnë në ekzistimin e një plani për dorëzimin e sovranitetit

amerikan tek liderët e huaj, duke e bashkuar njëherësh SHBA-në, Kanadën dhe Meksikën, për t'ia lejuar pastaj Meksikës që t'i pushtojë shtatë shtetet jug-perëndimore të SHBA-ve. Komploti mjaft popullor i 'Deep State' i referohet idesë që sistemi politik i SHBA-ve drejtohet nga sundimtarët e fshehur dhe të pazgjedhur, të cilët pengojnë qeverinë legjitime dhe përdorin miqësitë dhe nepotizmin për ta mbajtur pushtetin. Financuesi miliarder Soros përmendet po ashtu në shumë konspiracione të ndryshme, si: Deep State, Gjenocidin e Bardhë dhe Unionin e Amerikës së Veriut. Ai etiketohet si financuesi kryesor i imigracionit jo të bardhë në SHBA. E përbashkëta e të gjitha këtyre teorieve konspirative është nacionalizmi etnik dhe nocioni që kombi ynë (shumica e bardhë) është në rrezik.

Sikurse në rastin e Jugosllavisë, këto teori konspirative veprojnë me një logjikë manikeane ku grupet nacionale dhe racore janë natyrisht në luftë me njëri-tjetrin dhe se vetëm një grup mund të ngadhënjë. Konspiracionistët e interpretojnë historinë përmes prizmit të kompleteve të vazhdueshme, ku Tjetri gjithmonë e kërcënon ekzistencën e kombit tonë etnik dhe se kombi ynë do të luftoj dhe fitoj, pavarësisht fuqisë dhe ndikimit të të tjerëve. Megjithatë këto narrativa qarkullojnë për vite me radhë, zhvillimet e fundit politike si zgjedhja e Trump dhe Brexitit i kanë katapultuar ato në diskutimin dominues publik.

Sikurse në hapësirën ish-jugosllave, teoritë e kompleteve janë tashmë të pranishme gjithkund në sferën publike dhe private, përderisa mediat më me ndikim dhe rrjetet sociale i japin atyre hapësirë. Pjesa dërmuese e popullit i kanë përqaftuar këto interpretime dhe herë pas herë ata veprojnë sipas këtyre ideve, duke përdorur dhunë ndaj imigrantëve, ose pakicave etnike dhe fetare. Pjesëtarët e policisë, ushtrisë dhe aparateve të tjera të sigurisë, si dhe milicistë e armatosura legjitimojnë veprimet e tyre të dhunshme përmes teorieve të komplotit.

Nacionalizmi dhe teoritë e komplotit

Konspiracionet nacionaliste nuk janë të vetmet që janë shumëfishuar në vitet e fundit. Ka teori konspiracioni në pothuajse çdo aspekt të jetës njerëzore: politikë, ekonomi, industri, shkencë, teknologji, sport dhe argëtim. Megjithatë, konspiracionet nacionaliste janë më efikase dhe më të qëndrueshme. Ato kanë një pushtet tërheqës më të gjerë, sepse mbështeten në idiomat që tashmë janë të mirëngulitura në jetën e përditshme. Idetë që rrjeti 5G ka shkaktuar Covid 19, që Agjencioni Federal për

grupin specifik të komplotistëve: Eurokratët imperialistë, emigrantët meksikanë, George Soros, elita globaliste etj.

Meqenëse nacionalizmi është ideologjia më operative e modernitetit, diskutet që i referohen kombit gjëjnë mbështetje më të madhe popullore dhe si të tilla nuk mund të çrrënjosen lehtë. Ndryshe nga shumë konspiracione të tjera të cilat nuk kanë njohje institucionale, konspiracionet nacionaliste mbijetojnë dhe lulëzojnë pikërisht sepse përdorin diçka që është thellësisht e bazuar në botën moderne – botëkuptimi i realitetit

riprodhohen edhe në shoqërinë civile, në sferën intime të miqësive të ngushta dhe të rrjeteve farefisnore. Prandaj, në kohë krizash të thella shoqërore, konspiracionet nacionaliste janë shumë tërheqëse, sepse nxisin atë që tashmë ekziston. Ato vetëm i shndërrojnë këto mite dhe praktika në diçka më radikale dhe më përjashtuese. Ato ushqehen nga e ekzistuar dhe vendosin diskurse të përqendruara përreth kombit, duke identifikuar qartësisht kërcënimet dhe faktorët që komplotojnë për ta shkatërruar kombin. Frikat dhe pasiguritë e gjeneruara nga polarizimi i thellë politik mund t'i in-

parazitare duke ushqyer diskurse tashmë ekzistuese në institucione dhe në praktika të përditshme.

Rrëfimet nacionaliste dhe teoritë e kompleteve ndajnë nganjëherë një tipar të rëndësishëm të përbashkët: ato nuk mund të ndërtohen mbi të vërtetën. Qëllimi i tyre nuk është të gjenerojnë njohuri objektive, por ta lehtësojnë kohezionin shoqëror. Si të tilla, ato i rezistojnë si analizave shkencore, ashtu dhe provave faktike. Askush nuk dëshiron të dëgjoj se kombi i tij është inferior, se ka të kaluar të turpshme, cilësi mediokre ose paraardhës frikacakë.

Vetë ekzistenca e kombit bazohet mbi idenë e cilësive të veçanta që nënkuptojnë një lloj epërsie. E njëjta gjë vlen për teoritë e kompleteve. Ato janë të padeputueshme nga arsyeja, sepse japin ndjenjë sigurie për individët, si dhe një lloj drejtimi dhe një ndjenjë epërsie përmes qasjes 'unike' në informacionet që nuk i kanë të tjerët. Konspiracionet nacionaliste e sjellin të kuptuarit e

realitetit që e vë kombin në qendër drejt konkluzionit të tij logjik. Në kohë trazirash të thella shoqërore, idiomat e zakonshme nacionaliste mund lehtësisht të shndërrohen në konspiracione popullore nacionaliste.

**Sinisha Mallesheviq është profesor i sociologjisë në 'University College' të Dublinit dhe kërkues i asociuar në 'Conservatoire national des arts et métiers' në Paris.*

Referencat :

De Waal, J.R. (2018), *Brexit and Trump voters are more likely to believe in conspiracy theories*, *International YouGov Poll-Cambridge Centre*.

Hart, J., & Graether, M. (2018). « *Something's going on here : Psychological predictors of belief in conspiracy theories* », *Journal of Individual Differences*, 39(4), 229–237

Malešević, S. (2019), *Grounded Nationalisms*, Cambridge University Press.

(Ky artikull është shkruar në kuadër të projektit "Yugoslaving the world")



Situata Emergjente (FEMA amerikane) po ndërton kampe përqendrimi, apo mitet lidhur me Chemtrails, mund lehtë të hidhen poshtë përmes provave shkencore.

Por mbetet mjaft e vështirë të luftohen teoritë e kompleteve nacionaliste. Shumica e tyre ndërtohen mbi narrativat e mirëvendosura të superioritetit, viktimizimit dhe sakrificave. Në vend që t'i sfidojnë këto rrëfime, teoritë e kompleteve nacionaliste i radikalizojnë mitologjitë ekzistuese nacionaliste. Për shembull, Brexit dhe konspiracioni Aztlan mbështeten në pikëpamje popullore tashmë të betonuara, se sovraniteti kombëtar është i shenjtë dhe se është diçka që duhet mbrojtur me çdo kusht. Në këtë perspektivë, shteti-komb është forma e vetme e organizimit territorial legjitim në një botë ku çdo përpjekje për ta vërë në pikëpyetje rendin ekzistues konsiderohet si kërcënim.

Konspiracionet nacionaliste bazohen në këtë pikëpamje konvencionale që është e ngulitur thellë për ta radikalizuar mesazhin e tyre: kërcënim i nuk është abstrakt, por ndodhet në

shoqëror të përqendruar në Komb.

Të gjithë kemi lindur, punojmë, jetojmë dhe vdesim në kohëra politike që justifikojnë ekzistencën e tyre përmes idesë se Kombi është forma përfundimtare e solidaritetit kolektiv dhe legjitimitetit politik: Shteti-komb. Sistemet tona arsimore, mediat tona dhe sfera publike riprodhojnë çdo ditë vizionin mbi botën ku Kombi është në qendër. Nga fëmijëria deri në vitet tona të pjekurisë, ne jemi vazhdimisht të ekspozuar ndaj mitologjive nacionaliste të së kaluarës, së tashmes dhe së ardhmes, ku kombet tona përshkruhen si të veçanta dhe të jashtëzakonshme. Këto rrëfime portretizojnë kombet si entitete trans-historike që kanë ekzistuar gjithmonë dhe që nuk do të vdesin kurrë: kombet tona kanë histori të lavdishme, traditë të gjatë të civilitetit, moralitetit, heroizmit dhe sakrificës. Ndryshe nga fqinjët tanë, ne nuk i kemi tradhtuar kurrë vlerat tona morale dhe kemi vuajtur për t'i ruajtur.

Këto botëkuptime nacionaliste jo vetëm që krijohen dhe përhapen në institucionet e Shtetit-komb, por

tensifikojnë këto rrëfime nacionaliste dhe të krijojnë kushtet që i mundësojnë teoricientëve të komplotit të zhyten në besimet popullore. Individët të cilët janë edukuar me këto besime të përqendruara përreth çështjes së kombit janë më të prirur t'i besojnë teoritë të komplotit. Kur individët rriten duke besuar se të gjithë serbët kanë vuajtur përgjatë 500 viteve të dominimit osman, apo se britanikët heroikë e kanë mposhtur të vetëm Gjermaninë naziste, ata janë më të gatshëm të mendojnë mbi komplotet e huaja kundër kombit të tyre.

Të gjitha teoritë e kompleteve lulëzojnë në kohë krizash, polarizimesh shoqërore dhe vakumesh pushteti. Ato ofrojnë hartat të thjeshta njohëse për atë që duket të jetë një botë e pakuptueshme dhe e frikshme. Ato ofrojnë një ndjenjë kontrolli dhe sigurie në kohë thellësisht të pasigurta. Megjithatë, jo të gjitha konspiracionet janë të njëjta. Ndryshe nga shumica e diskurseve të tjera konspirative, konspiracionet nacionaliste janë më të fuqishme, më të qëndrueshme dhe si të tilla edhe më të qëndron në cilësinë e tyre

KUR NJË GRUP SHOQËROR GRUMBULLON RRETH VETES DIJEN, PUSHTETIN DHE PARANË

Borgjezia intelektuale, një elitë trashëguese

Shpeshherë lexojmë se shoqëria është e ndarë midis 1% më të pasur dhe 99% të tjerë. Por ky përgjithësim shmang pabarazitë e lidhura me të diplomuarit. Ai e fshihet rolin e luajtur nga borgjezia intelektuale, e cila edhe kur i shërben 1% i pëlqen të paraqitet se i takon kampit të të shtypurve. Kjo shtresë shoqërore e dalur nga « meritokracia » ia bartë privilegjet e saj pasardhëse, sikurse aristokracia e dikurshme.

NGA PIERRE RIMBERT

Në verën e vitit 1957, sociologu anglez Michael Young shëtitet në një plazh të Uellsit. Për një kohë të gjatë, ai ishte hulumtues në Partinë Laburiste britanike. Aty e shkroi manifestin e partisë të vitit 1945. Në tavolinë, ai ripërtyp : njëmbëdhjetë botues e patën refuzuar dorëshkrimin. Papritmas, ai e shih një çift shokësh në breg të detit. Ndalet me ta dhe flet për dorëshkrimin e tij, të cilin askush nuk e do. Fati e deshi që shokët e tij të cilët botonin libra arti vendosin ta përfshijnë librin e tij në katalogun e tyre.

Titulli: « *Ngritja e Meritokracisë* ». Young bashkoi termin nga latinishtja dhe greqishtja, duke e mishëruar me sarkazëm. Pesëqind mijë kopje të shitura në disa vjet e sjellin shprehjen “meritokraci” në gjuhën e përditshme. Me koston e një keqkuptimi gjigant.

Sepse vepra e Young, shkruar në prag të “1984” nga George Orwell dhe “Më e mira e botëve” të Aldous Huxley, portretizon një distopi: makthi i një bote moderne të sunduar “jo aq nga populli, sa nga njerëzit më të zgjuar”. Shkurt, qeveri e intelektualëve.

Ngjarja zhvillohet në fillim të vitit 2034 dhe rrëfyeti, një sociolog i fryrë, përmbledh me entuziazëm transformimin e shoqërisë britanike të shekullit XX, në një tirani të ushtruar nga të diplomuarit e arsimit të lartë. Nën pretekstin e “barazisë së shansave”, hierarkitë tani janë të shkallëzuara sipas inteligjencës; rendi shoqëror përjetësohet nga shkolla e cila i shndërron privilegjet e klasave në “dhurata” dhe “merita”. “*Të talentuarit*”, shprehet i lumtur rrëfyeti, “kanë pasur mundësinë të rriten në nivelin që u përgjigjet aftësi të tyre dhe prandaj klasat e ulëta janë rezervuar për më pak të aftë”. Si të legjitimuar, regjimi nderon heronjtë e tij. “*Janë fryer rendet e shkencëtarëve dhe teknologëve, artistëve dhe mësuesve. Edukimi i tyre i është përshatur fatit të tyre të lartë gjenetik. Është rritur fuqia e tyre për të bërë mirë. Përparimi është ngadhënjimi i tyre; bota moderne monumenti i tyre*”.

Për një Sartre, njëqind menaxherë të dëgjueshëm

Në këtë valë, përbërja e qeverisë së “inteligjentëve” është ajo që e tërheq vëmendjen: profesionistë letrarë ose shkencorë, të ngarkuar për prodhimin e njohurive, riprodhimin e elitës, administrimin e shtetit dhe bizneseve. Në Francë, Institutit Kombëtar të Statistikave dhe Studimeve Ekonomike (INSEE) i bashkon ata në kategorinë “Kuatrot dhe profesionet e larta intelektuale”. Aty janë një grumbull drejtorësh të burimeve njerëzore dhe prefektë, noterë dhe astronomë, gazetarë dhe juristë, reklamues dhe kirurgë dentarë. Asnjë kategori tjetër socio-profesionale nuk e ka parë anëtarësinë e saj të rritet kaq

shpejt, që nga botimi i librit të Michael Young. Mishërim sociologjik i shoqërive “post-industriale”, të orientuara drejt dijes. Ishin 900.000 në 1962 (4.6% e popullsisë aktive franceze); tani janë 5 milion (18%).

Të dalur nga shkollat dhe universitetet më selektive, pjesa e epërme e këtij grupi përfaqëson 5% deri 10% të popullsisë aktive perëndimore. Ajo përfshin të famshmin 1% më të pasur, por shkon shumë përtej tij. Për këtë inteligjenci të pasur do të diskutojmë këtu. Pavarësisht nëse ata punojnë në profesione liberale ose nëse popullojnë kreun e organizatave të biznesit, këta individë të suksesshëm marrin çdo muaj dividendë të kapitalit të tyre arsimor dhe kulturor. Ata zotërojnë pushtetin e përshkrimit. “*E dinë nga çka po vuanjmë dhe i japin diagnozat e vlefshme*”, ironizon esecisti amerikan Thomas Frank. Ndoshta edhe do t’i quanim “intelektualë” nëse, që nga çështja Dreyfus, ky emërtim nuk do ta kishte marrë kuptimin që e njohim.

Legjenda feston në intelektualin, jo vetëm si krijues dhe depozitues të dijes, por edhe si kundërshtar i rendit të vendosur, duke e ndjekur shembullin e famshëm të dhënë nga Jean-Paul Sartre, intervistuar më 15 gusht 1967 nga Radio Kanada: një fizikan bërthamor mbetet një “tekniciant i njohurive praktike” për sa kohë ai kontribuon në zhvillimin e bombës atomike, por shndërron në intelektual sapo të filloj të protestoj kundër saj. Por sa kemi sikur Sartre, Beauvoir dhe Bourdieu përballë miliona menaxherëve, juristëve dhe urbanistëve të dëgjueshëm? Megjithatë, miti mbijeton, sepse profesionet intelektuale shkruajnë historinë e të gjitha grupeve shoqërore, përfshirë edhe ato të tyre. Dhe pak është të thuhet se i ndihmojnë njëri-tjetrit. Yje në artin e universalizimit të interesave të tyre, ata madje mund të reagojnë ndaj një rënie të kredive në sektorët e tyre, duke nisur një “Apel kundër luftës ndaj inteligjencës”, siç ishte rasti në Francë në shkurt 2004.

Përderisa zhvendosja e fshatarësisë, revolta e jellekëve të verdhë ose pasiguria e punonjëseve sociale analizohen në debatin publik me ndihmën e kategorive gjenerike si “fermerë”, “punëtorë”, “shërbime për persona”, klasat më të arsimuara e portretizojnë veten e tyre në veçantësi të tyre delikate. Detajojnë rrymat e tyre të mendimit dhe zbusin mosmarrëveshjet e tyre. “E tëra ndodh sikur që një formë e materializimit më rudimentare ishte zakonisht më e zbatueshme për studimin e klasave të varfëra, përderisa hollësitë teorike që synojnë ta shpëtojnë autonominë e subjektit janë të rezervuara për klasat e kultivuara”, rezymon sociologu Jean-Claude Chamboredon. Për ta rivendosur barazpeshën, intelektualët duhen konsideruar jo më si një seri individësh unikë, por si një grup shoqëror.



Ndonëse historia shpesh mban rolin progresiv të shtresave të shkolluara – enciklopedistë të ditur, avokatë revolucionarë, shkrimtarë joshës, “ushtarë të Republikës” ...- ajo e minimizon përfshirjen e tyre në episodet më pak të lavdishme. Vichy ishte, më shumë se çdo grup tjetër shoqëror, një krijesë e eksperimenteve dhe e anëtarëve të profesioneve liberale”, kujton historiani amerikan Robert Paxton. Ta gjykojë Vichy është ta gjykojë elitën franceze ».

Roli i intelektualëve brenda sistemeve të dominimit rrënjësohet në periudhat e gjata dhe në shoqëritë para-kapitaliste. Në Perëndimin mesjetar, klerikët e lartë fetarë, zotëruar të monopolit të qasjes në shkrimet e shenja, legjitimuan pushtetin e pronarëve të tokave duke zotëruar një të katërtën e tokave. Juristët e shndërruar në këshilltarë dhe vezirët formojnë pastaj bazamentin administrativ të shtetit mbretëror. Në Kinë perandorake (-221 para Jezu Krishtit e deri më 1911), “*klasa e funksionarëve – të arsimuarit – një shtresë e vogël në numër, e plotfuqishme për sa i përket forcës, ndikimit, pozitës, prestigjit të saj – është e vetmja zotëruese e pushtetit, pronari më i madh, nënvizon sinologun Etienne Balazs. Ajo ka të gjitha privilegjet, para së gjithash të drejtën për t’u riprodhuar: zotëron monopolin në arsim*”.

Rasti i Indisë para-koloniale na fton po ashtu t’i relativizojmë virtetet progresiste, të cilat ja japin ndonjëherë dijes: sistemi i kastës, dhushëm i pabarabartë, bazohet kryesisht në dominimin e ushtruar nga intelektualët; si Brahmanët, të cilët e gëzojnë një prerogativë ekskluzive të qasjes në njohuritë e shenja. “*Janë ata dhe jo mbretërit, princat ose ushtarët, pronarët ose borgjezët, të cilët e sigurojnë në këtë shoqëri një formë veçanërisht operative të zbutjes së masave*”, shkruan studiuesja Isabelle Kalinowski, përkthyesja e Hinduizmit dhe Budizmit, studim ky i përpiktë nga sociologu Max Weber botuar në vitet 1916-1917.

Epoka kapitaliste nuk e ka transformuar natyrën e kësaj pune. Nga ana tjetër, ajo e ndryshoi formën e saj, pasi revolucioni industrial dhe zgjerimi i arsimit përforcuan peshën e të diplomuarve dhe theksuan heterogjenitetin e grupit: zbutja e masave dhe e një pjesë të madhe të të diplomuarve në vetvete, vepron në emër të racionalitetit ekonomik

dhe “kompetencave” të vërtetuara nga shteti i cili kërkon zbatimin e tij. Analizat e para që paraqesin intelektualët, si një klasë e re shoqërore e themeluar në monopolin e dijes dhe që aspirojnë pushtetin, shfaqen në shekullin XIX, në të njëjtën kohë me funksionet publike e të diplomuarëve, administratat e para të mëdha të ndërmarrjeve dhe më pas partitë e centralizuara të punëtorëve. Saint-Simon (1760-1825) ëndërronte një rend të dominuar nga dijetarët dhe industrialistët (bletat) të cilët do ta kthenin fisnikërinë dhe klerikët (brirët) në kotësinë e tyre. Në anën tjetër të Rinit, në Gjermani, shteti modern i imagjinuar nga Hegeli qëndron mbi funksionarët e ndritur të cilët, sipas filozofit, formojnë një “*klasë universale*” (Filozofia e së drejtës, 1821). Disa dekada më vonë, në Shkrimet kundër Marksit, Mikhail Bakunin rebelohet kundër perspektivës së një shteti socialist: “*E gjithë kjo do ta kërkojë një shkencë të pamasë dhe shumë tru të tejmbushur. Do të jetë mbretërimi i inteligjencës shkencore, më aristokratike, më despotike, më arrogante dhe më përbuzëse nga të gjitha regjimet*”. Një “*socializëm i intelektualëve*” më shumë se një fuqi punëtore, siç e paraqet më vitin 1905 një anarkist tjetër, Jan Waclav Makhaiski (në Bankroti i socializmit të shek.XIX).

« T’i japim fund ideologjive »

“Trurët e tejmbushur” nuk kanë mjete prodhimi, por dijen të cilën e monedhizojnë tek pronarët, të cilët ju delegojnë atyre mbikëqyrjen e punëve, kontrollin e prodhuesve dhe organizimin e punës, kujdesin për rritjen e produktivitetit përmes teknologjisë. Por shkolla i prodhon tru të tepri. Socialisti Karl Kautsky analizoi, më 1892, procesin e inflacionit-zhvlerësimit të diplomave midis punëtorëve të dijes: “*Ata që janë të thirrur për punë publike duhet të presin me vite, shpesh më shumë se dhjetë vjet, para se ta marrin një vend pune më të ulët, të paguar keq. Tek të tjerët, papunësia dhe puna e tepërt zëvendësojnë njëra-tjetrën. (...) Së shpejti, një karakter i vetëm do t’i dallojë këta proletarë nga paguesit e tjerë: të themi pretendimet e tyre*” (Programi socialist). Si një klasë dominuese në ndërtim ose një proletariat që mund të mobilizohet kundër rendit që ia ndryshon klasat, përfaqësimi që të diplomuarit kanë për veten e tyre lëkundet që një shekull e gjysmë midis këtyre dy fateve, të cilat në realitet

bashkëjetojnë në të gjitha kohërat.

Kur Michael Young shkroi « *Ngritja e Meritokracisë* » në fund të viteve 1950, tema e intelektualëve si klasë sunduese rishfaqet, këtë herë me një ton mjaft pozitiv. Në bllokun e Lindjes, sistemi arsimor sovjetik prodhon miliona inxhinierë dhe kuadro administrative të mbidiplomuar, duke shkaktuar një “shtytje lartë të elementeve shoqërore më të arsimuar”. Në Bllokun Perëndimor, organizata shkencore e prodhimit industrial e krijuan në vitet 1920 nga Taylor dhe e forcuar gjatë New Deal të Rooseveltit arrin shpejtësinë e lundrimin. Një inteligjencia e ngarkuar për koordinimin dhe planifikimin e qarqeve ekonomike tentakulare po përhapet: “teknokultura”, e përshkruar nga ekonomisti John Kenneth Galbraith në librin e tij « Shteti i ri industrial (1967).

Në këtë neoborgjezi të kultivuar rekrutohen baza shoqërore e së Majtës së Re protestuese dhe ajo e administratës së Kennedy-t, këta të diplomuar të shkëlqyeshëm që do ta mendojnë luftën në Vietnam. Përtej prirjeve të tyre politike, ata ushqejnë një mosbesim ndaj ekstremeve, kolektivizmit dhe tradicionalizmit. Ideja e “*t’i japim fund ideologjive*” imponohet në mënyrë më spontane në sytë e tyre, saqë mbështesin qeveri të eksperimenteve, domethënë shumëzimin e karrierës së mirë, që i hapin mundësi intelektualëve për të fituar para nga aftësitë e tyre akademike. Dhe përderisa fraksioni radikal i grupit djeg zjarret e fundit të viteve 1968, një grup ekonomistësh, juristësh, gazetarësh, fillojnë ofensivën që do të shpice në “*Kthimin e Madh prapa*” liberal dhe krijimin e qindra mijëra pozicioneve të larta drejtuese të paguara shumë nga institucionet financiare. Megjithatë, deri në fund të viteve 1970, mbizotëron bindja se “*klasa e re është forca më progresive e shoqërive moderne; se është në qendër të të gjitha emancipimeve të mundshme njerëzore për të ardhmen e parashikueshme*”, siç shkroi sociologu Alvin Gouldner më 1977 në një libër të shquar.

Njëzet vjet më parë, Michael Young ishte më pak optimist.

Sepse, ndërsa shfletojmë faqet, ‘*Ngritja e Meritokracisë*’ kthehet në një makth. Qeveria e klasave të kultivuara, e cila instaloi fëmijët më të ndritshëm të botës së punës në pozita të pushtetit për ta devitalizuar opozitën, tani përbëhet

vetëm nga ekspertët. Masa e të padiplomuarve e shndërruar në “të papunësueshëm” nga mrekullitë e “automatizimit” – tashmë! – e sheh veten të përfshirë me forcë si staf i brendshëm i intelektualëve. “*Sapo të gjithë gjenitë të jenë në mesin e elitës dhe të gjithë debilët në mesin e punëtorëve, ç’nënkupton barazia?*», pyet rrëfyesi. Në fiksonet e Young, qeveria e intelektualëve maturohet në fillim të shekullit XXI. Të pajisur me privilegje – apartamente të rehatshme, darka të shijshme, pushime të kushtueshme – klasa e arsimuar edukon fëmijët e tyre në institucione të veçanta arsimore dhe riprodhohet tanimë midis saj. “*Elita është në rrugë për t’u bërë trashëguese; parimet e trashëgimisë dhe meritës përbashkohen*”, vëren rrëfyesi, i shqetësuar në mënyrë të paqartë për kthesën e ngjarjeve. Por historia nuk mbaron këtu...

Duke pritur zbulimin e epilogut, duhet pranuar se bota distopike e ekspozuar në këtë sociofiksim i shkruar para më shumë se 60 vjet duket fuqishëm si e jona. Në Shtetet e Bashkuara, si në Evropë, ekziston një hendek midis pakicës së vogël të të diplomuarëve të cikleve të larta dhe selektiv (5% deri në 10% të popullsisë së vendeve perëndimore) dhe pjesës tjetër. Theksi në vitet e fundit në kundërshtimin midis 99% të popullsisë dhe 1% më të pasur ka tërhequr vëmendje nga grupi më i madh i cili ka përfitur nga konkurrenca meritokratike për gjysmë shekulli, dhe pa të cilin 1% nuk mund ta instaloi dhe ta përjetësoi dominimin e tij. Nëse ky vizion i luftës së klasave është përparësi për meritokratët që e popullarizojnë atë për ta vendosur veten në kampin e të shtypurve, së bashku me zonjat pastruese, ajo zhdruk dy fenomene thelbësore të identifikuar nga Young në fabulën e tij parashikuese: monopoli e pushtetit politik të mbajtur nga intelektualët dhe karakteri gjithnjë e më i trashëgueshëm i dominimit të tyre.

Demokracia e të diplomuarëve

Për ta justifikuar krijimin e Shkollës së lirë të Shkencave Politike – e cila do të bëhet Science Po -, profesori Emile Boutmy bëri, më 1871, këtë deklaratë të famshme: “*Të detyruara t’i nënshtrohen të drejtave të më të shumtëve, klasat që e quajnë veten e tyre klasa të larta mund ta mbajnë hegemoninë e tyre politike vetëm se duke u thirrur në të drejtën e më të aftëve*.”

Pas mbylljes së shkatërruar të prerogativave të tyre dhe të traditës, rrjedha e demokracisë duhet të dalë përballë një pjerrëtësie të dytë të ndërtuar nga merita të shkëlqyera dhe të dobishme, të epërsive, prestigji i të cilave imponohet, si dhe të kapaciteteve nga të cilat nuk mund të privohemi pa çmenduri”.

Një shekull e gjysmë më vonë, shfletimi i një trombinoskopi politik pothuajse do t’ju bënte të harroni se postet e deputetit, Presidentit të shtetit ose qeverisë, nuk kërkojnë zyrtarisht ndonjë diplomë. Autorët e një sondazhi për udhëheqësit politikë të gjashtë vendeve evropiane, Mark Bovens dhe Anchrist Wille, konfirmojnë se regjimet aktuale përfaqësuese janë të ngjashme me “*demokratitë e të diplomuarëve*”. “*Të diplomuarit e arsimit të lartë kanë aritur t’i dominojnë të gjitha institucionet dhe arenat politike, qofshin partitë, parlamentet dhe kabinetet, grupet e presionit, vendet e diskutimeve apo madje edhe konsultimet në internet*”.

Më 2016, 100% e ministrave belgë dhe gjermanë kishin përfunduar arsimin e lartë, si 95% e ministrave francezë. Në Britani të Madhe, 60% e ministrave

vinin nga universitetet elitare të Oxford ose Cambridge. Megjithatë, studiuesit vërejnë se “*qytetarët pa arsim të lartë përfaqësojnë rreth 70% të elektoratit*”. A prodhon vërtetë përsosmëria akademike të zgjedhur më efektivë, parlamentarë më të zgjuar? Pyetja – o befasi – nuk i magjeps universitarët dhe disa nga punimet e rralla ekzistuese zbulojnë se politikanët e diplomuar “*nuk janë më të zellshëm, nuk kontribuojnë më shumë në prodhimin parlamentar dhe nuk zgjidhen përsëri*”. Do të kundërshtohet me të drejtë që fenomeni nuk është i ri. Dhe ky është pikërisht problemi: demokracitë në zhvillim kishin premtuar një qeveri “nga dhe për popullin” bazuar në arsimin universal.

Si përjetësohet dominimi i një shtrese të vogël udhëheqësish dijetarësh kur universiteti makineron pa pushim ushtri aspirantësh? Që nga fillimi i shekullit XIX, përqindja e të diplomuarëve të lartë është rritur nga më pak se 1% e popullsisë së rritur në Shtetet e Bashkuara dhe nga rreth 35% në Evropë. Për ta ruajtur pengesën, mjafton të ngresh nivelin duke krijuar pengesa të reja kulturore dhe financiare, të pakapërcyeshme jo vetëm për të diplomuarit më pak të arsimuar, por edhe për të diplomuarit në numër të lartë. Në Shtetet e Bashkuara, sitat e kombinuara të dijes dhe të parave sigurojnë një renditje shoqërore kaq efektive sa, siç e kishte parashikuar Young, ajka e meritokratëve tani riprodhohet nga brezi në brez, si një klasë sunduese të trashëgueshme. Jo të gjithë të diplomuarit janë të pasur, por pothuajse të gjithë të pasurit janë të diplomuar: më 2017, 98.4% e amerikanëve që fitojnë më shumë se dy herë e gjysmë pagën mesatare – ose 94.300 dollarë – kishin një diplomë bachelor ose më shumë. Në vend se tituj fisnikërie, prindërit së pari u kalojnë pasardhësve të tyre titujt më prestigjiozë dhe më të shtrenjtë universiteti, si miliardërit e Silicon Valley, të cilët ia kushtojnë pasurinë fondacioneve filantropike dhe fëmijët e tyre Stanfordit ose Harvardit.

Tipike për borgjezinë e iluminuar të shekullit XIX, mënyra e lehtë e jetës, shpenzimet e dukshme, vendosja e fëmijëve në përkujdesje që janë kthyer në praktika të kundërta: ajka e intelektualëve të pasur punon shumë dhe shpenzon një pjesë të rëndësishme të të ardhurave dhe kohës në arsim, mirëqenie, kulturë dhe shëndetin e pasardhësve të saj. Dadot dygjuhëshe, çerdhet elitare të 50.000 dollarëve në vit, mësimet private në zgjimin e arteve figurative nga moshë tre vjeçare, më pas çerdhat elitare me gjuhë të huaj dhe seksionet shkencore që përzgjedhin vetëm 5% të kandidatëve (sidomos ato të shkruara nga një konsulent i punësuar për këtë qëllim nga familja), zhvillimi i hershëm i “kapitalit njerëzor” justifikon të gjitha investimet. Më 2014, shpjegon sociologja Elizabeth Currid-Halkett, “1% e më të pasurve shpenzuan 3,5 herë më shumë në arsim sesa në vitin 1996 (në vlerë absolute dhe si pjesë e shpenzimeve). Dhe 8.6 herë më shumë se mesatarja kombëtare”; 5% frymëzohen nga shembulli i tyre.

Këto shpenzime të riprodhimit dinastik, të cilat përfshijnë gjithashtu ato të mësuesit kujdestar (për të cilin familjet më të vendosura shoqërohen edhe me ndihmë personal), shkollat private, frekuentimi i të cilave përfshin qëndrimin në lagje më të pasura, udhëtime kulturore, mësimin e violinës dhe praktikën e tjera të dallueshme të rekomanduara për të hyrë përfundimisht në Harvard, Yale, Princeton ose Stanford, ku tarifet e vetme të regjistrimit variojnë midis 40.000 dhe 70.000 dollarë në vit (shumë më shumë se paga vjetore mesatare në SHBA), arrijnë shuma

kolosale. Për një familje që i përket 1% më të pasur, vlerëson profesori i drejtësisë Daniel Markovits, shpenzimet shtesë për arsimin krahasuar me një familje të klasës së mesme barazohen me një trashëgimi prej rreth 10 milion dollarë për fëmijë. “Merita është një mashtrim”, thotë ai. Dhe një civilizim i tërë i reziston këtij përfundimi”.

Këto numra pasqyrojnë vetëm majën e ajzbergut. Për shkak se bartja e kapitalit kulturor fillon që në lindje, në formën e kohës së vëmendjes të prindërve, veçanërisht atë të grave. Intelektualët, shpjegon sociologu Elizabeth Currid-Halkett, kalojnë dy deri në tre herë më shumë kohë se të tjerët, duke luajtur dhe edukuar të porsalindurit e tyre. Ata i ushqejnë me gjë më shpesh dhe më gjatë, të bindur se kjo praktikë rrit kapacitetet njohëse, deri në pikën që po lulëzon edhe profesioni i “konsulentit të laktacionit”.

Në moshën trivjeçare, një pasardhës i një njeriu nga profesionet liberale të mirëpaguara, ka dëgjuar mesatarisht 20 milion fjalë të përmendura nga një njeri më shumë, se një fëmijë i klasës së mesme. Fjalori i tij është 49% më i larmishëm. Duke u angazhuar në marrëdhëniet me pasardhësit e tyre për një qëllim edukativ që e parandalon atë të mësuesve, prindërit zhvillojnë ndjeshmërinë e tyre emocionale, përqendrimin e tyre, disiplinën e tyre. “*Deri në moshën 18 vjeçare, një fëmijë i një të pasuri do të ketë marrë 5000 orë më shumë vëmendje se një fëmijë i klasës së mesme, nga tregimet e lexuara, bisedat, ngjarjet kulturore, trajnimet sportive etj.* saktëson Markovits. (...) Në të njëjtën moshë, një fëmijë i klasës së mesme do të ketë kaluar 5000 orë më shumë para një ekranit se një fëmijë i një të pasuri. Segregacioni i “klasës kreative” përkthehet gjithashtu në planin hapësiror, ku familjet që grumbullojnë të gjitha burimet bashkohen në lagje të caktuara të metropoleve progresive dhe të hapura, që ofrojnë një mënyrë jetese më të shëndetshme, një rrjet më të gjerë shoqëror etj., si dhe shansa më të mira për sukses se 80% e amerikanëve më pak të pasur.

Markovits thotë se « investimet masive të elitës në arsim kanë dhënë frytet e tyre. Hendeku arsimor midis studentëve të pasur dhe të varfër sot tejkalon atë që i ndante të bardhët dhe zezakët më 1954 », vitin kur Gjykata Supreme e vlerësoi kundërkushtetuese segregacionin racor në shkolla. “Pabarazia ekonomike sot prodhon pabarazi arsimore më të madhe se aparteidin amerikan”.

Të strehuar prapa pragut të formave kërkuese arsimore që i vendosin si normë, përmes mediave dhe kulturës, intelektualët më të begatë do t’i gjykojnë më përcjellim prindërit që janë domosdoshmërisht më pak të hapur, më pak progresivë, më pak bujarë dhe që nuk i respektojnë të njëjtat rite kulturore, shoqërore dhe ushqimore. Për ata s’ka diskutim : “S’është faji ynë që nuk kanë mësuar në shkollë”, një qëndrim që e përmbledh aspektin “social” të programeve liberale.

Do të ishte gabim, megjithatë, të lidhej jeta e elitave meritokratike me një lumë të gjatë të qetë. Darwinizmi social i cili përjashton menjëherë shumicën e fëmijëve që burojnë nga familjet e varfra i vendos po ashtu fëmijët e të pasurve në një gjendje të konkurrencës së pandalur. Nga greqishtja e lashtë në moshën tri vjeçare e deri në dymbëdhjetë orët si asistent në një avokaturë, meritokratët zbulojnë në kurriz të tyre, se kapitali, madje edhe ai kulturor, ka nevojë për punë – e tyre! – për të prodhuar përfitim.

Ky tjetërsim ndaj ndërmarrjeve shpesh pa përfitime shoqërore, të cilat vendosin vetëshkatërrimin nga lodhja, si kriter i përsosmërisë profesionale, nxit një fraksion, të vogël por në rritje, të defektit për t’u rikualifikuar në zeje, humanitaren, e më rrallë, edhe si provokim. Një fillim i tillë mbetet përjashtim. Sapo të hyni në një institucion elitare, fati juaj është i përcaktuar.

Në Shtetet e Bashkuara, gjysma e studentëve të 12 universiteteve më prestigjioze burojnë nga 10% e familjeve më të pasura. Në Francë, trashëgimia e borgjezisë së kultivuar nuk e ka arritur këtë shkallë. Së pari, sepse pjesa e të ardhurave që mban borgjezia e kultivuar franceze ka ngecur që nga fillimi i viteve 1970, kur u rrit me 13% përtej Atlantikut. Pastaj, sepse fëmijët e familjeve të pasura shpesh e përtojnë një fazë të pasigurt në fillim të karrierës së tyre, e cila nuk i inkurajon ata të njohin ndonjë “privilegj” të klasës dhe pse ata mbajnë resursin e rrallë i cili, së bashku me pronën, strukturon hierarkinë sociale: kualifikime të mira arsimore.

Në fund, kostoja e ulët e arsimit të lartë francez vjen në kontrast me tarifën e tepër të kërkuara në Amerikë. Sidoqoftë, ekskluzivizmi borgjez i institucioneve elitare nuk është më pak i theksuar: Shkolla Kombëtare e Administratës ka 6% të punëtorëve dhe të punësuarve, ndërsa këto kategori përfaqësojnë më shumë se gjysmën e popullsisë aktive. Sa i përket Politeknikës, 1.1% e studentëve kanë një prind punëtor kundrejt 93% një prind nga profesionet intelektuale e larta. Ky aparteid meritokratik rritet nga vitet 1950. Mund ta masim paradoksin e një institucioni të bazuar në premtimin për ta universalizuar diturinë dhe i cili, ndërsa zgjerohet, është bërë qendra e renditjes përgjegjëse për ndarjen e 10% që do të dominojë të gjithë të tjerët.

“T’i pastrojme paratë tona me virtytet tona”

Të zgjedhurit e lumtur ndoshta do ta njohin veten në këtë përshkrim të shkrintarit amerikan Matthew Stewart, botuar në vitin 2018, në revistën e njohur The Atlantic: “Ne, 9,9% (...), ecim me xhinse dhe maica të trashëguara nga fillimet tona modeste. Ne preferojmë ta sinjalizojmë statusin tonë duke folur për trupat tanë të ushqyer bio, për sukseset e pasardhësve tanë dhe për drejtësinë ekologjike të lagjeve tona. Ne kemi kuptuar se si t’i pastrojme paratë tona me anë të virtyteve tona më të larta. Mbi të gjitha, ne kemi mësuar t’ia bartim të gjitha këto përfitime fëmijëve tanë”.

Dhe Steward rezyronte me një fjali të vërtetën objektive që kuadron dhe profesionet intelektuale përpiqen të mohojnë: « Ne po e lëvizim makinën që i zhvendos resurset nga 90% tek 0,1%. Të lumtur që e morëm copën tonë të tortës ». Nëse në shoqëritë perëndimore, ngjyra e lëkurës së bardhë dhe gjinia mashkullore sigurojnë privilegje që njihen gjithnjë e më shumë, përkatësia e 10% më të arsimuar është një tjetër privilegj, por përfituesit e të cilave e relativizojnë.

Shtrëngimi në rritje i intelektualëve të suksesshëm ka rikonfiguruar thellësisht peisazhin politik perëndimor. Pas Luftës së Dytë Botërore, popullsitë më pak të diplomuara dhe më pak të pasura votonin kryesisht për partitë e majta, ashtu si edhe një pjesë e vogël e profesioneve intelektuale të lidhura me sektorin publik. Ky koalicion është shpërbërë. Socialistët, Demokratët dhe të Gjelbërtit janë tashmë nga vitet ‘90 “parti të të

diplomuarëve”, kryesisht të braktisura nga klasat punëtore, siç e kanë analizuar Thomas Frank dhe, pas tij, Thomas Piketty. Për herë të parë, në nëntor 2016, jo vetëm amerikanët më të arsimuar, por edhe më të pasurit votuan me shumicë për demokratët.

Punëtorët dhe punonjësit po braktisin lojën elektorale ose po i ndajnë votat e tyre për parti të cilat, edhe nëse nuk i përfaqësojnë interesat e tyre ekonomike, përcaktohen kundër elitave liberale. “*Nëse duam ta kuptojmë rritjen e ‘popullizimit’, shkruan Piketty, nuk është e padobishme të fillojmë ta analizojmë rritjen e ‘elitizmit’*.” *Kjo linjë ndarëse duket si një dhuratë nga perëndia për komentuesit e etur për likuidimin e ndarjeve që i konsiderojnë të vjetëruara. “Në shumë vende, shpjegon e përjavshma liberale The Economist (6 qershor 2020), ndarja e vjetër e majtë-e djathtë, e bazuar në ekonomi, është zëvendësuar me ndarjen liberale-konservatore të bazuar në kulturë*.”

Por larg nga të qenit reciprokisht përjashtues, kultura dhe ekonomia janë përplotësuese. Në Francë, ta kesh një diplomë master mbetet e ndërlydhur ngushtë me prejardhjen shoqërore: më 2017, 40% e fëmijëve të prindërve me profesione liberale kishin një diplomë gjimnazi +5 vite studime ose një shkollë inxhinierie, kundrejt më pak se 4% e fëmijëve të punëtorëve të kualifikuar në sektorin e logjistikës.

Qeveria e intelektualëve të pasur është pjesë e një lufte klasore esktrimisht tradicionale.

Vala e “vdekjeve nga dëshpërimi” (vetëvrasje, alkohol, drogë) në Shtetet e Bashkuara shpërfaq një ilustrim tragjik: sipas studiuesve Angus Deaton dhe Anne Case, kjo rritje e vdekjeve që vlerësohet deri në 600.000 midis 1999 dhe 2017 brenda popullsisë së bardhë të moshës 45 -54 ka të bëjë pothuajse ekskluzivisht me të padiplomuarit.

Që nga viti 1990, shkalla e tyre e vdekshmërisë është rritur 25%, ndërsa ajo e titullarëve të një diplome bachelor ka rënë 40%. “Për ata pa diplomë, rritet niveli i vuajtjeve, shëndetit të keq dhe çrregullimeve mendore, ndërsa bjen aftësia për të punuar dhe shoqëruar. Hendeku po zgjerohet gjithashtu kur bëhet fjalë për të ardhurat dhe stabilitetin e familjes. Një i diplomuar bachelor është bërë shënduesi kryesor i statusit shoqëror”.

Në distopinë e tij të shkruar shtatëdhjetë vjet më parë, Michael Young nuk thoshte asgjë tjetër. Por libri i tij përfundon me një shënim optimist. Në maj 2033 shpërtheu një lëvizje e fuqishme “populliste” e organizuar nga gratë, të përjashtuara nga rishpërndarja e pushteteve meritokratike për përfitimin e burrave. “*Për herë të parë, një pakicë disidente e elitës i është bashkuar klasave më të ulëta, deri atëherë shumë të izoluar dhe të dëgjueshme*”, shkruan narratori pretendues i Young, pa saktësuar nëse protestuesit kishin veshur jelekë të verdhë. Shpërthejnë trazirat. Punonjësit e një dyqani luksoz shkatërrojnë objektin e tyre. Zbulohet Ministri i arsimit i goditur në bark. Një grevë e përgjithshme organizohet për 1 maj 2034, e para për më shumë se 40 vjet.

I çorientuar, narratori pret që protesta të mbarojë sa më shpejt. Rrëfimi i tij ndalet papritur. Në dorëshkrim, një shënim lakonik nga redaktori tregon se ai nuk i mbijetoi kryengritjes.

KUR VULLNETI PËR DEMOKRATIZIMIN E SHKENCËS CILËSOHEJ SI “QEVERISJE NGA TURMA”

Popullistët amerikanë kundër lobit të mjekëve

Pakujdesia e presidentëve Donald Trump dhe Jair Bolsonaro përballë krizës shëndetësore ka përforcuar idenë se "popullistët" janë armiqësor ndaj shkencës, veçanërisht ndaj mjekësisë. Historia e Shteteve të Bashkuara dhe e Kanadasë na kujton të kundërtën: popullistët kanë luftuar për demokratizimin e dijes dhe shëndetit, kurse korporata e mjekëve ka vepruar në mënyrë që ato të rezervohen për të pasurit.

NGA THOMAS FRANK*

Në këtë vit të pandemisë, kriza politike në prapavijë është shkaktuar, thuhet, nga kokëfortësia e popullit amerikan për ta refuzuar autoritetin e diskursit shkencor. Shikoni këta njerëz që bëjnë qejf në pishinën e një restoranti, afër Liqenit të Ozarks (Misuri), derisa një epidemi e tmerrshme po bën kërdi... Shihni gjithë këta njerëz që propagandojnë teori të konspiracionit nga më absurdet, ndajnë udhëzime sanitare të çuditshme në rrjete sociale, dalin pa maska për të blerë gjësende, hedhin fishekzjarre në mes të rrugës... Dhe çfarë të themi për Presidentin e tyre kokëkrisur i cili injoron rekomandimet e ekspertëve të tij dhe vazhdimisht tregon me gisht grupe të personave përgjegjës për situatën, pa u përfshirë asnjëherë në ato grupe. Madje shkon aq larg sa që këshillon administrimin e dezinfektuesve, të cilët japin rezultate shumë të mira në sipërfaqet e kuzhinës dhe ulëset e WC-së?

Kjo betejë e pamëshirshme midis “in-jorantëve” dhe “iluministëve” ka qenë në qendër të jetës politike amerikane për shumë vite. Në mendjen e shumë njerëzve, demokratët, “progresistët”, janë bindshëm në fazë me realitetin objektiv. Ata dëgjojnë me devotshmëri opinionet e Nobelistëve dhe laureatëve të tjerë të çmimeve shkencore të ekselencës. Republikanët, përkundrazi, sikur jetojnë në një botë tjetër – një botë përrallash dhe legjendash, ku e vërteta nuk dëgjohet.

Zakonisht, klubi ynë i opinionistëve të vetëshpallur, udhëheqës të mendimit tonë, përfiton nga këto mosmarrëveshje për të shpërndarë pika në mes dy kampeve. Më të zgjuarit jemi ne! Budallenjtë, janë ata! Por ja që, nën ndikimin e pandemisë, papritmas konfrontimi bëhet më i mprehtë se kurrë më parë. Amerikanët e respektueshëm shpallin, me dridhje në zë, besimin e tyre të pandryshueshëm, të palëkundur për shkencën, ndërsa zyrtarët demokratë i kërkojnë një kombi të gjunjëzuar t'i dëgjojë këshillat e ekspertëve si fjalë hyjnore.

Udhëheqësit e opinionit tonë shtjellojnë gjithashtu një teori për të shpjeguar sjelljet e papërgjegjshme që shohim te disa persona që promovojnë përhapjen e virusit. Thojnë se këta njerëz të humbur nuk janë vetëm idiotë; ata veprojnë nën ndikimin e një doktrine të mirëfilltë anti-ekspertizë: “popullizmi”. Përkrahësit e këtij besimi – “popullistët”, pra – janë egërsira të paarsimuar që i kanë mëri homologët e tyre të arsimuar dhe i përçmojnë në mënyrën më të thellë. Ata preferojnë t'i besojnë intuitës sesa njohurive në libra, t'i përçmojnë rekomandimet e profesionistëve mjekësorë, të zgjojnë mençurinë e turmave dhe natyrisht, ata janë racistë. Popullizmi është armiku i shkencës; ai është në luftë me mendimin racional. Ai bashkëpunon

në përhapjen e së keqes, për të mos thënë bashkëpunon me të keqen.

Lufta kundër privilegjeve të dijes

Këtu është një silogjizëm i bukur me të cilin na ngopë klasa amerikane opinioniste dhe si mund të befasonemi prej tij kur është aq tërheqës dhe u përshatet dëshirave tona? Shkenca mjekësore ka të drejtë, popullizmi është i gabuar: ky fakt është aq evident sa që lavdërimi i së parës dhe dënimi i së dytës është bërë një motiv letrar i harxhuar, që nxit editoriale dhe artikuj deri në pafundësi.

Por gabohemi shumë. Nëse Shtetet e Bashkuara po tregohen tragjikisht të paafta për t'u përballur me kërcënimin e koronavirusit të ri, së pari nuk duhet fajësuar kryesisht marrëzia e jashtëzakonshme e Donald Trump – megjithëse pjesërisht, po. Sistemi ka faj: sistemi amerikan i kujdesit shëndetësor. Ky sistem i cili shkel mbi idenë e shëndetit publik dhe e shndërron qasjen në shërbimet shëndetësore në një luks të rezervuar për një pakicë. Një sistem i cili ju rjepë financiarisht vetëm për një këmbë të thyer dhe nuk pranon të kujdeset për ju nëse nuk keni sigurim. Ky sistem pamundëson sigurimin sapo mbeteni pa punë dhe pandemia është duke lënë miliona njerëz pa punë. Dhe në fund, ky sistem, ditën kur të ketë një kurë për Covid-19, nëse kjo ndodh, padyshim që do t'ua faturojë me një çmim të lartë.

Ky sistem është ai që është sepse “mjekësia e organizuar”, duke u mbështetur në prestigjin që ka ekspertiza profesionale, është përpjekur për gati një shekull të sigurohet që të mos ndryshojë. Në të kundërt, gjatë gjithë kësaj periudhe, fryma e reformës erdhi nga radhët populiste, që u përpoqën – pa pasur sukses – të ndryshonin sistemin në mënyrë që ai të ishte në shërbim të numrit më të madh. Me fjalë të tjera, specialistët, studiuesit dhe think tankers tanë super-seriozë dhe jashtëzakonisht inteligjentë, gabojnë tërësisht. Pikërisht shëndeti publik është shndërruar në një ëndërr të paarrtshme nga fakti që u jemi përkulur shumë opinionëve shkencore. Dhe ilaçi kundër të keqes që po na godet nuk gjendet askund tjetër përveçse brenda këtij populizmi kaq të urreyer nga ekspertët dhe që po i frikëson ekspertët.

Për të kuptuar se çfarë po ndodh, duhet të fillojmë duke përkufizuar termin. Emërtimi “popullist” u adoptua në vitin 1891 në Shtetet e Bashkuara, në Kansas, nga anëtarët e një partie agrare shumë të re. Me kërkesa që varionin nga braktisja e etalonit të arit e deri te lufta kundër monopoleve, duke përfshirë nacionalizimin e hekurudhave, kjo lëvizje shpejt u përhap vullshëm, deri në atë pikë sa suksesi i saj, për një kohë, dukej i sigurt. Por ndryshe rodhën gjërat: në më pak se dhjetë vjet, Partia populiste u zhduk.



©Nina Korhonen

Nga ana tjetër, ndikimi i saj ka kaluar shekujt dhe disa nga idetë e saj mund të gjenden në Partinë socialiste amerikane, në New Deal të viteve 1930 dhe 1940, si dhe në fushatat presidenciale të vitit 2016 dhe 2020 të z.Bernie Sanders.

Rritja dhe rënia e popullistëve amerikanë – unë ende u referohem atyre që kanë shpikur termin – është prej kohësh një temë e preferuar për historianët të zjarrtë romaneskë dhe për ta janë shkruar libra të panumërt. Të gjitha këto vepra theksojnë një fakt të çuditshëm: përfaqësuesit e kësaj rryme nuk kishin asgjë kundër shkencës apo arsimit. Përkundrazi, avokimi i tyre në favor të teknologjisë, dijes dhe arsimit ishin aq të sinqerta dhe të lulëzuara sa që gati turpërohemi kur i lexojmë sot. Pse tekste të tilla? Sepse popullistët ishin të bindur se përputheshin në mënyrë të përkryer me progresin shkencor të fundit të shekullit, duke i mbrojtur parimet e shtetit të mirëqenies apo të ndërhyrjes së pushtetit publik.

Në të njëjtën kohë, popullistët ishin në luftë të vazhdueshme kundër elitave ekonomike dhe intelektuale të kohës së tyre, ekspert që pretendonin të shihnin dorën e Zotit në rendin e vendosur. Për popullistët, të gjitha format e privilegjit ishin të dyshimta, përfshirë edhe

prestigjin mbi të cilin profesionet e larta bazonin autoritetin e tyre. Një ilustrim i padiskutueshëm i kësaj ideje mund të gjendet në Kopshtin e famshëm të Edenit në qytetin Lucas, në Kansas, një park skulpturash i ndërtuar në vitet 1910 dhe që është një nga përpjekjet e para për të popullarizuar teoritë populiste dhe socialiste. Ndër atraksionet kryesore të saj është një skenë e quajtur “Fuqia Punëtore e Kryqëzuar”, në të cilën një punëtor torturohet deri në vdekje nga anëtarët më të shquar të komunitetit: një bankier, një avokat, një mjek dhe një prift.

Shkurt, botëkuptimi i popullistëve të parë ishte rrënjësisht demokratik: populli kishte përparësi mbi gjithçka dhe roli i ekspertëve në një demokraci duhej të kufizohej në shërbimin dhe informimin e qytetarëve.

Popullistët e fundit të shekullit të 19-të heshtën ndaj politikës shëndetësore. Duhet theksuar se mjekësia amerikane nuk ishte ende në kohën e këtij labirinti burokratik tmerrsisht të shtrenjtë që njohim sot. Por, sapo çmimet e ilaçeve filluan të rriten, gjatë dekadave në vijim, u shfaqën lloje të shumta të sistemeve alternative më demokratike, të imagjinuara së bashku nga fermerët, organizatat sindikale dhe organizatat bamirëse me

një qëllim të vetëm: t'i bëjnë shërbimet shëndetësore të përballeshme për klasën punëtore.

Ndër arritjet që duhet t'ua atribuojmë këtyre “neo-populistëve”, njërien e kam për qejf. Ajo lindi në 1929 në Elk City, në Oklahoma, një shtet ku tezat populiste kishin fituar jehonë të madhe qysh në fund të shekullit paraprak. Qëllimi ishte krijimi i një sistemi shëndetësor bashkëpunues, në të cilin fshatarëve dhe familjeve të tyre, në këmbim të një pageseje të vogël vjetore, do t'u garantohet qasje në shërbimet e mjekëve dhe dentistëve, si dhe qasje në një spital në lokacion të afërt me pajisje moderne. Anëtarët e kooperativës – d.m.th. popullsia e gjerë, kryesisht punëtorë të tokës – ishin përgjegjës për zgjedhjen e bordit drejtues të tij dhe për menaxhimin e çështjeve ekonomike.

Ky sistem u shpik nga njëfarë doktori Michael Shadid, i cili u përpoq ta implementoj atë me ndihmën e degës lokale të Farmers Union, një organizatë sindikale fshatare. Prania e kësaj organizate konfirmoi dimensionin popullist të projektit, pasi ajo ishte pak a shumë pasardhëse e drejtpërdrejtë e partisë së shuar të viteve 1890. Por historia personale e Dr. Shadid na mëson edhe më shumë gjëra.

I lindur në Liban, Michael Shadid emigroi në Shtetet e Bashkuara në 1988. Që nga fillimi i karrierës së tij, ai ofroi shërbime mjekësore pa pagesë për fermerët amerikanë. Ai gjithashtu ishte anëtarësuar për pak kohë në Partinë Socialiste. Megjithë bindjet e pazakon-ta politike, ai nuk ishte një sharlatan – përkundrazi, kërkesat e tij për cilësinë e shërbimeve shëndetësore ishin veçanërisht të larta. Shadid dallonte nga kolegët e tij nga denoncimi që u bënte praktikës së mjekësisë që ai e konsideronte grabitqare, veçanërisht në qytetet e vogla në Oklahomë.

Me synim distancimin nga ky model, Shadid e konsideronte veten si një “mjek i popullit[i]” i aftë për të zgjidhur enigmën e përjetshme amerikane, e cila mbetet e pazgjidhur edhe sot e kësaj dite : çmime marramendëse të shërbimeve dhe popullsi me shëndet të dobët . “Në kohë lufte si dhe në kohë paqeje, në kohë krizash si në kohë bollëku, stuhie apo qetësie, ka fakte që nuk ndryshojnë, shkruante ai: të varfërit sëmuren më shpejt, qëndrojnë më gjatë të sëmurë dhe janë ata që marrin më pak kujdes mjekësor edhe pse kanë nevojë për më shumë. Disa janë të varfër sepse janë të sëmurë. Të tjerët janë të sëmurë sepse janë të varfër. »

Kërcënimet e hakmarrjes

Në një shkrim tjetër të tij, Shadid deklaronte se vepronte në emër të “popullit amerikan” duke luftuar “për t’i shpëtuar nga sundimi i privilegjeve, i cili po e çon vendin në rrugën e diktaturës dhe kaosit”. Duke cituar këto fjalë në një libër të botuar në vitin 1939, gazetari James Rorty komentoi: “Këto janë parulla të thjeshta, më populliste se sa socialiste, që godasin në shenjë te fermerët e Oklahomës, sepse ata u tregojnë saktësisht se çfarë po përjetojnë. »

Natyrisht, kur fliste për “privilegjet”, Shadid e kishte fjalën për Shoqatën Mjekësore Amerikane (American Medical Association, AMA), organizatën profesionale të mjekëve. Anëtarët e saj kishin shpallur luftë sepse ai kishte guxuar të hapte një spital bashkëpunues. Po ushtronin skemat më djallëzore kundër tij. Për ta, plani i reformatorit neo-popullist ishte “imoral”, sepse ai planifikonte t’i besonte vendime të rendit ekonomik personave pa përgaditje. Pasi u përpoq t’ia konfiskonte licencën, AMA dëboi Shadid nga dega lokale dhe kështu ai humbi të drejtën për sigurimin e përgjegjësive civile. AMA gjithashtu arriti të dekurajojë nga përfshirja në ndërmarrjen e tij shumicën e mjekëve që ai dëshironte t’i rekrutoj.

Padyshim, opinionistët e sotëm do ta përshkruanin këtë episod me rreptësi dhe shtirje mosmiratimi, si një luftë e popullistit Shadid kundër shkencës. Megjithatë do të ishte shumë më e saktë të flitet për një “luftë të shkencës kundër popullizmit”.

Kjo luftë bëri kërqi për shumë vite, gjatë të cilave AMA i luftoi dhe i varrosi njërin pas tjetrit propozimet për demokratizimin e qasjes në kujdesin shëndetësor. Anëtarët e saj, për shembull, organizuan bojkotin e një kooperative qumështore që nxiste një fondacion bamirësie që ishte pak e lidhur me Shadid, t’i ipte fund hulumtimeve të tij në fushën e “ekonomisë së mjekësisë” siç quhej atëherë.

Historiani Paul Starr na tregon gjithashtu se, në Washington, ku sapo ishte themeluar një kooperativë shëndetësore e ngjashme me atë të Elk Cityt, AMA” i kërcënoi të gjithë mjekët e përfshirë në iniciativën që do t’u hakmerrej,

bëri çmos për t’ua pamundësuar konsultat ose pacientët e referuar nga kolegët, dhe arriti t’i bindte të gjitha spitalet në Rrethin e Columbia-së t’ua mohonte atyre privilegjin e pranimit [d.m.th. e drejta që i jepet një mjeku, për shkak të statusit të tij si profesionist mjekësor të një institucioni shëndetësor, të referojë një pacient në një spital ose një qendër mjekësore për të dhënë një diagnozë ose një shërbim] ».

Ky sulm i kushtoi AMA një padi në sajë të ligjit antitrust, por nevojitej më shumë për ta ndalur atë. Mbi të gjitha, AMA mbledhi rreth saj specialistët më të mirë të kohës, të cilët thjesht kërkonin të trajtoheshin me respektin që u takon. Kryetari i saj shkoi aq larg sa që protestoi në vitin 1938 kundër hapjes së një hetimi federal për reformën e sistemit të kujdesit shëndetësor. Ai pretendoi se e gjithë hierarkia shoqërore ishte e shthurur kur pranoi që injorantë të kërkonin me vull ilaçe të sharlatanëve të përshkruara nga profesionistët. “Kjo është një praktikë e mjekësisë që nuk është as shkencore, as ekonomikisht racionale,” tha ai me përbuzje.

Është vërtetë e çuditshme të kuptosh sa shumë gjëra mund të ndalohen nga etika profesionale kur profesionistët shëndetësor ndihen të kërcënuar në statusin e tyre social. Harry Truman, Presidenti i rizgjedhur në vitin 1948 pas një fushate shumë më populliste sesa ajo e Donald Trump në vitin 2016, vendosi të përqendrohet në mandatin e tij të dytë në sigurimin shëndetësor gjithëpërfshirës. Disa muaj pas marrjes së detyrës, ai paraqiti një program për këtë qëllim, duke lavdëruar arritjet e mjekësisë moderne, por duke theksuar se ishin shpërblyer me shpërthimin e çmimeve të ilaçeve. “Tanimë, shërbimet mjekësore nuk janë më të papërbalueshme vetëm për të varfërit, por për të gjitha shtresat, përveç atyre më të larta », tha ai në 1949 në një fjalim në Kongres.

Kundërsulmi i Shoqatës Mjekësore Amerikane ishte i menjëhershëm. Duke e denoncuar një “sistem të keqpërdorur, tipik të kombeve dekadente”, ajo argumentoi se plani i Truman-it do t’i vendoste mjekët, përfaqësuesit me arsime shumë të lartë të një profesioni shumë të respektuar, nën “një burokraci të madhe të shërbyesve publik, punonjësve, kontabilistëve dhe komisioneve srfshirprofane”. E vendosur që ta ndal këtë president injorant, AMA shfrytëzoi anëtarët e saj (shumica prej tyre të pasur) duke tërhequr një kontribut të jashtëzakonshëm dhe kështu arriti të mbledh një thesar të shkëlqyer lufte. Këto fonde i mundësuan asaj të siguron-te shërbimet e një agjencie kaliforniane të quajtur Campaigns Inc., pionere në komunikimin politik, të cilës ajo i besoi misionin e udhëheqjes së forcave të saj në terren. Së shpejti vendi u gjend i mbytur në një ortek pamfletash, letrash dhe karikatyrash të pista që sugjerorin që ardhja e “mjekësisë së socializuar” do të nënkuptonte fundin e pariparueshëm të lirisë individuale. Falë këtyre metodave, të cilat për fat të keq u bënë klasike, projekti i Trumanit dështoi, sikurse të gjitha përpjekjet e mëvonshme për të krijuar një sistem shëndetësor vërtet universal në Shtetet e Bashkuara. Por ishte në Kanada që lufta e shkencës kundër populizmit përjetoi zhvillimet e saj më shpërthyes, siç kujton historiani Robert McMath.

Në disa provinca të Prairies canadiennes, jehona e revoltës populliste amerikane të viteve 1890 jetoi për dekada. Gjatë Depresionit të Madh, mishërimi politik par ekselencë i kësaj tradite ishte një parti radikale agrare e njohur si Federata Bashkëpunuese e Commonwealthit (Co-operative

Commonwealth Federation, CCF). Më 1944, ajo arriti një fitore dërmuese në zgjedhjet krahinore të Saskatchewan, duke formuar atë që historia e ka quajtur “qeverinë e parë socialiste në Amerikën e Veriut”.

E ripërtëritur disa herë gjatë viteve, CCF bëri fushatë në vitin 1960 rreth një projekti të sigurimit shëndetësor gjithëpërfshirës në nivel krahinor dhe përsëri u shfaq fitimtare në një zgjedhje ku mbizotëroi kryesisht kjo çështje. Dy vjet më vonë, në korrik 1962, qeveria Regina ishte e gatshme të lancoj Medicare, sistemin shëndetësor me pagues të vetëm, domethënë, kostot e të cilit mbulohehin vetëm nga një sistem publik – ishte hera e parë që një gjë e tillë ndodhte në shtetin kanadez.

Atëherë, “shkenca e organizuar” shfrytëzoi armën e saj të shkatërrimit në masë. Të njëjtën ditë, me hyrjen në fuqi të sistemit të ri, të gjithë mjekët e Saskatchewan hynë në grevë. Padyshim që nuk ishin më shumë se një mijë, por sidoqoftë ishte, në gjithë shkëlqimin e tij, një “moment Ayn Rand”, sipas emrit të filozofes dhe novelistes së shekullit XX, apostull e individualizmit, shumë e popullarizuar në Shtetet e Bashkuara. Përmes këtij aksioni, 1% e të arsimuarve dhe të pasurve urdhëroi popullin të qendroj në vendin e vet dhe të tregoj respektin e tij.

Ky version kanadez i përplasjes midis shkencës dhe populizmit – midis një grupi të vogël por prestigjioz profesionistësh dhe punëtorëve të Saskatchewan – paraqiti shumë manovra që dinte t’i bënte AMA. Si kjo e fundit, grupacioni i mjekëve të krahinës grumbulloi një thesar të madh falë kontributit të anëtarëve të saj dhe e përdori atë për të financuar përpjekjet e saj të propagandës. Jo vetëm që lëvizja mori mbështetjen nga Dhoma e Tregtisë e Saskatchewan dhe shoqatat e tjera profesionale, por shtypi vendas i përcjelli si një, duke i dhënë zë vullshëm ndërsa parashikonte valë të komunizmit dhe sëmurdjes. Aktivistë të së djathtës ekstreme ishin gjithashtu pjesë e kësaj përmes një kolektivi që u shfaq nga askund, “Na lini mjekët tanë” (Keep Our Doctors, KOD), i cili kishte për qëllim të luftonte sistemin me një pagues të vetëm përmes shumë tubimeve publike, me gjueti shtrigash dhe insinuatat raciste – qeveria neo-populliste kishte njoftuar qëllimin e saj për të sjellë mjekët nga jashtë për t’i zëvendësuar grevistët.

Pyetja kryesore, natyrisht, ishte ajo e vendit që duhet të kënd ekspertët në një demokraci. Mjekët ishin atëherë në një situatë monopoli: vet vendosnin për mënyrën e trajtimeve dhe për çmimin e tyre dhe iu raportonin vetëm kolegëve të tyre. Projekti i CCF – sikurse ato të Dr. Shadid ose të Presidentit Truman – dobësonte autoritetin e tyre duke i dhënë një pjesë të tij qytetarëve të zakonshëm. Në atë kohë, një reporter i Washington Post theksoi: « Mjekët janë ‘priftërinjtë e mëdhenj’ të kohës sonë dhe si të tillë ata nuk e kanë zakon t’i binden shtetit ».

Revolta e të çmendurëve

I thirrur për të ndërmjetësuar polemikën, baroni Taylor, një mjek dhe politikan britanik, përmbledhi faktet me terminologji pothuajse klinike. Në vitin 1974 ai shkroi se AMA ishte “në kundërshtim historik ndaj çdo forme të sigurimit shëndetësor publik dhe po punonte, jo pa sukses, për t’ia komunikuar këtë histori mjekëve, si dhe opinionit publik në Saskatchewan ».

Së paku diagnoza ishte e saktë: një shoqatë profesionale kishte përhapur

histerinë në të gjithë krahinën e Prairies Canadiennes. Rezultati ishte përshtatje e “frikës demokratike”, siç e quaj atë që ndodh kur shtresat e larta të një shoqërie bindin veten se njerëzit e shfrenuar po rrezikojnë privilegjet e tyre. Këto kriza periodike të histerisë kanë një numër konstantesh: demokracia përshkruhet si tirani; shtresat e ulta veçohen për guximin e përfshirjes në çështje që nuk i kuptojnë (pavarësisht nëse është ekonomi, politikë e jashtme ose, në këtë rast, mjekësi); dhe, natyrisht, media bashkohen.

Të gjithë këto elemente ishin të pranishme në frikën e madhe demokratike të vitit 1896. Atë vit, klasa udhëheqëse amerikane, e mbështetur nga pothuajse të gjitha organet e shtypit, besonte se ishte e kërcënuar nga një proletariet i etur për gjak që marshonte nën flamurin e William Jennings Bryan , kandidati demokrat në garat presidenciale, një njeri i përceptuar si radikal dhe të cilit i ishin bashkangjitur populistët. Nga maja e kullës së tyre të fildishtë, burra të arsimuar të këtij fundshekulli vërshuan në gazetatat e Bregut Lindor për të pretenduar se lëvizja populliste nuk ishte gjë tjetër veçse një revoltë e të çmendurëve.

Ndonjëherë ndodh që frika demokratike arrin qëllimet e saj. Ky nuk ishte rasti me grevën e madhe të 1%, e cila ndezi Saskatchewan në vitin 1962 – dështimi i saj madje ishte shumë i rëndë. Ndërsa frika pati efektin e saj në fillim, simpatia për kauzën e mjekëve u mposht shpejt, e ndihmuar nga fjalimet e egra të kampit të ekspertëve – një pastor ungjillor, i cili po fliste në valët e radiove, duke bërë thirrje për gjakderdhje. Grevja përfundoi pas një muaji. Pesë vjet më vonë, të gjitha krahinat e vendit kishin një sistem shëndetësor të modeluar sipas atij të Saskatchewan, dhe Medicare është edhe sot e kësaj dite një nga arritjet shoqërore për të cilat Kanada është më krenare.

Asnjë nga lëvizjet reformuese që i përshkrova më lartë nuk ka kontestuar rëndësinë e kërkimit shkencor apo ndonjë prej gjetjeve të tij. Të gjithë këta mendimtarë neopopullistë admiran mjekësinë moderne; ata thjesht donin ta bënin atë të arritshëm për personat më të varfër. Me fjalë të tjera, kishte dy vizione konkurruese të shoqërisë: privilegjet versus barazia.

“Çështja themelore në zemër të konfliktit midis qeverisë dhe mjekëve të Saskatchewan nuk është sigurimi shëndetësor publik, por demokracia”, shkruan Globe and Mail e Toronto-s disa javë pas fillimit të grevës. Herët a vonë, pavarësisht nga specialiteti i tij, profesionisti duhet t’i nënshtrohet gjithmonë laikut, përndryshe demokracia nuk mund të funksionojë. “

Pikërisht! Thoshin disa, ky është i gjithë problemi me demokracinë: u jep këtyre profanëve injorantë pushtet mbi ata që u janë superior. George Sokolsky, një redaktor amerikan me një audiencë kombëtare, mbrojti kështu zëshëm grevistët e Saskatchewan me arsyetimin se ata mishëronin “luftën e ekspertëve në një epokë ku paraprindë qeverisja nga turma“. Antikomunist i bindur, Sokolsky kështu i përshkruante mjekët që përpiqeshin t’i mbanin kokat e tyre mbi ujë, kur i gjithë planeti ishte përfshirë në valën barazitare. “Ka qenë një kohë kur njerëzit e respektonin njëri-tjetrin për atë që vlenin”, shkroi ai. Tani duket se motoja është: “Unë vlej po aq sa ju“. Kjo filozofi, të cilën ai e konsideronte aq të rreme sa të dëmshme, e zemëronte. Kur në një vend si Shtetet e Bashkuara të gjithë janë të lirë të shprehin mendimet e tyre, për të ishte e natyrishtme që, derisa bota ishte duke u

komplikuar, “vetëm specialistët mund të kishin një opinion për një gamë në rritje të temave”.

Sokolsky ka qenë një McCarthy-st i zjarrtë që anonte në të djathtën e së djathtës. CCF ‘Saskatchewan’-eze, nga ana tjetër, ishte një parti agrare dhe punëto-re e krahit të majtë. Tani, goditje e papritur: gjithçka ka marrë kahje të kundërt. Partia Demokratike që kishte investuar Harry Truman tani u shërben interesave të drejtuesve të pasur dhe të diplomuar : i mbështet gjenitë e vegjël të Wall Street, me përpikmëri u bindet urdhërave të ekonomistëve që lavdërojnë tregtinë e lirë, dhe kur përfaqësuesit e saj propozojnë një reformë shëndetësore, ata nuk e bëjnë këtë duke konsultuar bazën, por mbledhin specialistë nga të gjithë sektorët e përfshirë në çështje dhe u kërkohen atyre që të rriorganizojnë sistemin midis tyre. Pastaj, befasohen kur opinioni publik shfaq zemërimin e tij.

« Ne, populli »

Edhe forcat e pranishme në zinxhirin e kujdesit shëndetësor kanë evoluar. AMA nuk është më ajo fuqi e fortë e profesionistëve shëndetësorë që ishte dikur. Në luftën për ta parandaluar shfaqjen e sigurimit gjithëpërfshirës, AMA është tejkaluar nga akterët e rinj – grupe spitale, kompani farmaceutike dhe kompani sigurimesh – në aspektin e fuqisë dhe të ndikimit, me, megjithatë, një motivim të pandryshuar: nderimin e asaj që tani quhet “inovacion” dhe të profesionistëve që qëndrojnë pas tij.

Por, transformimi më i thellë ka të bëjë me të menduarit e krahit të majtë. Mënyra se si progresistët e vetëshpallur keqpërdorin dhe abuzojnë me fjalën “popullizëm” tregon se ata janë kthyer me vendosmëri kundër trashëgimisë së tyre demokratike. Tani i dëgjojmë ata duke na kujtuar virtutet e censurës dhe duke evokuar me nostalgji ditët e lumtura kur pronarët i zgjedhin udhëheqësit tanë për ne. Demokracia shfaq një problem, thonë ata, sepse i mundëson popullit injorimin e autoritetit të ekspertëve. Kësaj demokracie rebele i kemi borxh zgjedhjen e zotit Trump sikurse pafuqinë tonë përballë ngrohjes globale ose pandemisë Covid-19. Ky është i gjithë faji ynë. “Ne, Populli” (që janë fjalët hyrëse të preambulës së Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara).

Prandaj peizazhi politik është kokëulur, por lufta mbetet e njëjtë. Tani të shoqëruar me pastërtinë morale të akullit të së majtës në vend të antikomonizmit të mashtuesve të krahit të djathtë, ekspertët vazhdojnë të ankohen kundër të pafytyrëve që guxojnë të sfidojnë fuqinë e tyre. Tema e vërtetë e debatit janë privilegjet e tyre dhe të gjithë jemi të inkurajuar që të përulemi para tyre, apo edhe të marshojmë në radhë të ngushta për të avokuar për kauzën e tyre.

Megjithatë, duke lënë mënjane fantazitë egoiste të këtij Politburo modern, ekuacioni i vjetër politik ende dallohet prapa mbulesës së mjaftueshmërisë së krahit të majtë. Aktualisht, senatori hapta popullist Bernie Sanders është mbrojtësi më i zjarrtë i një sistemi universal të kujdesit shëndetësor, ndërsa ushtarët e “shkencës së organizuar” dhe pushtetit privat po përpiqen sistematikisht ta sabotojnë këtë ide. Populizmi nuk është gjetja e fundit shkëlqyese për ta emëruar të keqen prej të cilës po vuajmë, është ilaçi që mund të na çlirojë prej saj.

*Gazetar dhe historian. Autor i *The People, No: A Brief History of Anti-Populism, Metropolitan Books, New York, 2020.*

MES PROPAGANDËS KOLONIALE DHE NDJENJËS KOMBËTARE

Në origjinën e shtypit arab

Në fillim të shekullit XIX u shfaqën gazetetat e para në arabisht, të cilat për një kohë të gjatë kishin qëllim administrativ. Më pas, fuqitë koloniale e panë atë si mjet për t'iu adresuar drejtpërdrejt popullsisë indigjene dhe për ta përhapur propagandën e tyre në të gjithë botën arabishtfolëse. Gazetat e pavarura kanë përfutuar nga njohuritë e maronitëve siro-libanezë.

NGA ARTHUR ASSERAF *

Nga Rabati deri në Bagdad, të gjithë mund të lexojnë të njëjtën gazetë pasi vendet arabe ndajnë përdorimin e një gjuhe të shkruar (arabishtja standarte ose Foussha) që nuk përkon me territorin politik. Audiencia e mediave që flasin arabisht nuk korrespondon me kufijtë e një shteti-komb, qoftë nga gazetatat, radio apo kanale televizive. Nisur nga përvoja evropiane, zhvillimi i shtypit në këtë rajon të botës duket se është një anomali. Në të vërtetë, nga sociologu francez Gabriel Tarde deri tek historiani irlandez Benedict Anderson, shumë intelektualë kanë argumentuar se shtypi është burimi i ndjenjës kombëtare. Sipas tyre, gazeta krijon një audiencë të bashkuar nga gjuha dhe temporaliteti i përditshëm, të cilët mund të imagjinohen duke lexuar të njëjtët artikuj në të njëjtën kohë ndërsa pijnë kafe në mëngjes. Gazeta krijon "komunitetin imagjinar" të kombit.

Por si mundet që një shtyp i cili shtrihet nga Atlantiku deri në Gjirin Persik të themelojë një komb? Mbështetësit dhe kundërshtarët e një bote arabe të unifikuar politikisht, shpesh kanë menduar që shtypi mund të veprojë si një mjet për fabrikimin e ndjenjës kombëtare. Nga njëra anë, ata që menduan se arabët duhet të bashkoheshin në të njëjtën shtet, sepse ndajnë të njëjtën gjuhë, ishin në favor të një shtypi të përbashkët. Nga ana tjetër, disa mbrojtësit ndalimin e botimit në foussha dhe favorizuan dialektet për të krijuar një audiencë vërtet kombëtare me një shtyp në dialektin egjiptian, maroken ose sirian. Këto kritika në fakt fillojnë nga i njëjti supozim: situata e shtypit arab është anormale, duhet të ekzistojë një përshatshmëri midis gjuhës, mediave, shtetit dhe kombit.

Kush vëzhgon historinë e shtypit arab e ka të vështirë të bëjë dallimin midis asaj që është "kombëtare" dhe "ndërkombëtare". Historianët shpesh thonë se gazeta e parë arabe, Al waqai 'al misriyya (Ngjarjet e Egjiptit), u themelua në Kajro në 1828. Por "gazetë" është një term paksa i nxituar, pasi ajo ishte më shumë një dokument administrativ me disa qindra kopje të destinuara për zyrtarët egjiptianë. Një ditar zyrtar ku shtonin herë pas here, lajme të përgjithshme. Pas pak kohe, autoritetet otomane filluan të njëjtin lloj botimi në Kostandinopojë, Takvim-i vekayi (Kalendari i Ngjarjeve), së pari në turqishten osmane dhe më pas në disa botime përfshirë arabishten. Në Kajro si në Stamboll, pushtetarët që po përpjekeshin të reformojnë vendin e tyre, synonin të centralizojnë informacionin. Në fillimin e shekullit XIX, shtypi shërbeu për të shtrirë dhe forcuar kontrollin e shtetit nga një këndvështrim që ishte edhe modernizues dhe autoritar në të njëjtën kohë. Autoritetet nuk kërkonin të demokratizojnë informacionin ose të krijonin opinionin publik, ata synonin shpërndarjen në mënyrë të njëanshme aktivitetet dhe idetë e tyre.

Nga Levanti në Magreb

Diku tjetër, shtypi fillestar nuk ka asnjë lidhje me shprehjen e ndjenjave nacionaliste apo pan-arabe. Gazetat e para shpesh themeloheshin nga qeveritë koloniale, të cilat, duke riprodhuar të njëjtat përvoja si homologët e tyre egjiptianë ose osmanë, e bënë shtypin një mjet komunikimi me popullsinë. Pavarësisht nëse bëhet fjalë për Muhamed Aliun në Kajro, Mahmud II në Kostandinopojë ose Louis-Philippe në Paris, asnjëri nga këta monarkë nuk shkruan vetë në arabisht. Prandaj i shërben atyre të flasin drejtpërdrejt me lexuesit arabishtfolës. Pas marrjes së Algjerit në korrik 1830, qeveria franceze u përpoq në disa raste të shpërndajë një botim kushtuar publikut arab. Pas një përpjekjeje të shkurtër në 1832, me Moniteur algérien, i cili botonte ndonjëherë në arabisht, në shtator 1847 në Algjeri u shfaqën Al-Mubachir (Shpallësi) ose Le Mobacher në frëngjisht. Dërguar në mënyrë të veçantë për të gjithë zyrtarët muslimanë, ky botim i përmuashëm është redaktuar nga Ismaël "Thomas" Urbain, i rritur me idealitetet e Shën-Simonit dhe i cili u konvertua në Islam në 1835 pas disa qëndrimeve në Kajro. Në botimin e tij të parë, Le Mobacher njofton qëllimin për t'i afruar algjerianët më afër mbretit Louis-Philippe: "Ju e dini që mbretërit e kombeve të krishtera flasin çdo ditë me popujt e tyre përmes shkrimeve ku i informojnë ata për vendimet e qeverisë dhe lajme të çdo lloji. Sulltani i Kostandinopojës, Pashai i Egjiptit e ndoqën këtë shembull dhe ndjekësit e tyre po shkojnë mirë." Historiani Charles-Robert Ageron vëren se ky botim do të ofronte shumë shpejt artikuj të kulturës së përgjithshme të shkruara gjatë nga zyrtarët francezë dhe të përkthyer në arabisht. "

Më vonë dhe deri në mbylljen e saj në 1928, do të punësonte gjithashtu gazetarë muslimanë, duke e bërë kështu Le Mobacher-in "shkollën e parë të gazetarisë të Algjerisë muslimane."

Që në fillim, këto gazeta qarkulluan përtej kufijve. Gazeta e parë e botuar në Tunizi në 1860 është Al-Ra'id al-Tunsi (Pionieri Tunizian). Edhe nëse një nga objektivat e tij të parë ishte të kontribuojë në zbatimin e duhur, nga gjykatat tuniziane, të kodit të ri të ligjit penal dhe të drejtës zakonore, ai tregon kështu në faqen e parë të tij që mund ta gjejmë jo vetëm në qytetet kryesore të vendit (Tunis, Kairouan, Sfax, Sousse, Bizerte), por edhe në Algiers, Tripoli, Alexandria, Beirut. Lexueshmëria e saj ishte pra në shkallën e Mesdheut që flet arabisht, nga Levanti deri në Magreb. Në Algiers, shtypi egjiptian u ble në një librari, rue de la Lyre në Casbah të Poshtëm nga vitet 1870.

Nuk ka asgjë kombëtare në lidhje me përmbajtjen e gazetave. Telegrafi elektrik dhe agjensitë e lajmeve, që sapo kishin lindur, kontribuojnë në lindjen e një informacioni kryesisht të



njëtrajtshëm, qoftë për atë që jeton në Beirut, Romë apo Buenos Aires. Me zhvillimin e kabllove të paranëndetëse në Mesdhe në vitet 1860 dhe zyrat e para të agjencive Havas ose Reuters në Aleksandri ose Tunis, roli i redaktuesve kryesisht konsistonte në përkthimin e dispeçeve telegrafike evropiane në arabisht. Artikujt kopjoheshin nga një gazetë në tjetër, në një kohë kur të drejtat e autorit ishin shumë të mjeçullta.

Këto gazeta në rritje kishin nevojë për redaktorë, një forcë pune që nuk respekton kufijtë kombëtar. Prandaj thirrshin maronitët libanezë, të trajnuar në seminare fetare në arabishten standarte, gjuhë evropiane dhe në përdorimin e shtypshkronjës. Farès Chidiac, shkrimtar dhe gazetar i lindur në 1804 në Mont-Liban, redaktoi revistën zyrtare egjiptiane në vitet 1830, pastaj udhëtoi në Evropë – ai u bë një socialist në Francë – para se të themelonte të njëjtin lloj botimi në Tunizi në 1860. I ftuar nga Sulltan Abdülmejid I, ai u transferua në Kostandinopojë në 1861 për të botuar al-Jawab (Les circulantes), një gazetë javore kulturore dhe letrare e subvencionuar nga qeveria osmane dhe me model të frymëzuar nga gazetatat kryesore evropiane të asaj kohe.

Vëllezërit libanezë ose sirianë që kishin emigruar krijuan disa nga gazetatat më të rëndësishme në botën arabe që nga vitet 1860. Vendi i botimit i tyre ndryshoi sipas kufizimeve politike. Në 1875, vëllezërit Takla themeluan Al-Ahram (Piramidat) në Egjipt, i cili botoi artikujt e disa mendimtarëve të Nahda (Rilindjes), duke përfshirë Djama Eddine Al-Afganas dhe Mohamed Abdouh. Kjo e përditshme mbetet edhe sot e kësaj dite një referencë në të gjithë botën arabe. Edhe në Marok, e vendosur akoma larg Libanit, gazeta e parë private në gjuhën arabe, Lissan al-Maghrib (Gjuha e Marokut), u publikua në vitin 1907 në Tangier nga Farajallah dhe Arthur Nemmour, dy vëllezër libanezë. Ai do të ishte zëdhënësi zyrtar i monarkisë marokene para se të bëhej zëdhënësi i elitës nacionaliste të një mbretërie të ekspozuar ndaj qëllimeve koloniale franceze dhe spanjolle. Emigrimi në Amerikë bëri që në atë kohë disa nga qendrat kryesore të shtypit arabisht-folës të vendoseshin gjithashtu në São Paulo dhe Philadelphia. Në 1914,

kishte katërmëdhjetë gazeta në gjuhën arabe në Brazil, dhe New York-u kishte një të përditshme, Kawkab Amirka (Ylli i Amerikës) nga 1898, domethënë shumë kohë para Mekës, qytetit të shenjtë të Islamit, ose Fez, një qendër kryesore universitare marokene që nga shekulli X.

Sidoqoftë, jo gjithçka rrodhi lirshëm. Në shumicën e vendeve arabe, një gazetë "e huaj" paraqiste një problem të sovranitetit shtetëror, sepse ajo ishte botuar në një vend që nuk e kontrollon dhe nga e cila mund të burojnë idetë kundërshtuese. Prandaj, shtetet në rajon shpesh tundoheshin të ndalonin gazetatat arabe të shtypura jashtë vendit. Në vitin 1897, qeveria franceze në Algjeri, për shembull, ndaloi gazetën egjiptiane Al Mu'ayyad (Partizani) i cili drejtohej një fushatë kundër kolonializmit perëndimor në Egjipt dhe në pjesën tjetër të botës arabe. Por ishte e vështirë për autoritetet koloniale të vendosin kontroll efektiv. Për shembull, gazetatat ndonjëherë paketoheshin në kuti që përmbanin produkte të tjera në mënyrë që të kalonin më lehtë doganat. Një trafik i vërtetë gazete zhvillohej në kufirin midis Algjerisë dhe Tunizisë nën protektoratin ku ky i fundit përfutonte nga një regjim censurimi më liberal.

Kështu, shumë qeveri po përpjekeshin të subvenciononin gazetatat me ndikim përtej kufijve të tyre. Në vitet e fundit të shekullit të XIX-të, konsujt britanikë dhe francezë në Egjipt zhvilluan një luftë shurdhe përmes gazetave Al-Ahram, pro-frëngjisht dhe Al-Muqattam (të emëruar kështu pas kodrave në jug-lindje të Kajros), pro-britanike. Edhe shtypi në dukje i pavarur shpesh mbështetej nga qeveritë lokale ose të huaja.

Trazira intelektuale

Gazetat propaganduese u krijuan gjithashtu me qëllimin e vetëm për të çuar më tej pikëpamjen e një kryeqyteti të huaj. Quai d'Orsay financonte shumë gazeta në gjuhën arabe, por megjithatë ankohej për ndikimin e botimeve të mbështetura nga fuqitë e huaja. Ndër pionierët e gazetarisë arabe figuronte një gazetë e botuar në 1880 në Cagliari, Sardenjë. Qeveria italiane dhe bashkësia e biznesit në Sardenjë ishin duke

targetuar Tunizinë fqinje, ku ata do të donin të ndërtonin një koloni, duke shkakuar tensione me qeverinë franceze, e cila kishte frikë për sigurinë e Algjerisë. Për të ndikuar në publikun tunizian dhe arab dhe për të parandaluar Francën që të marrë kontrollin e Tunizisë, redaktori i Avvenire di Sardegna (E ardhmja e Sardenjës) Giovanni De Francesco, punëson Yousouf Bakhus, poet libanez, të krijojë një gazetë në gjuhën arabe, Al-Mustaqill (The Independent). Këto përpjekje propagandistike nuk do të kurorëzoheshin me sukses pasi Franca vendoset në Tunizi në maj 1881. Roli subversiv i kësaj gazete pro-italiane denoncohet në shtypin francez. Bakhus më pas shkoi në Paris për të punuar në Al-Bassir (Insight), një e përjavëshme që synonte të ndikojë në audiencën e mirëfilltë arabe në një mënyrë të favorshme për Francën. Një ndryshim krahu ky që u përhëndet nga Le Figaro në atë kohë, se Al-Bassir "thotë të kundërtën e asaj që thoshte Mustaqilli i uryer".

Si reagoi publiku arab? Publikimet që janë shumë të destinuara për propagandë shpesh shmangen nga lexuesit. Ekzistenca e tyre është e shkurtër, sepse vështirë se i gjejnë shumë lexues: të mërzhitshme, ndonjëherë të përkthyer keq nga gjuhët evropiane, stili i tyre i fryrë nuk i përshtatet një publiku të lexuar dhe të rafinuar në kërkim të argëtimit. Lexuesit arabë kërkonin soap-opera dhe ilustrime. Për t'iu tërhequr ato, duhet të prodhohin përmbajtje tërheqëse dhe origjinale. Në kontekst të trazirave intelektuale në disa pjesë të botës arabe (Egjipti, Libani dhe Tunizia), lexuesi po kërkonte gjithashtu një fjalim të lirë, të pavarur, të cilin publikimet qeveritare shpesh e kishin të vështirë ta prodhohin.

Ky ishte kufiri i këtyre përpjekjeve të shtetit. Në arkipelagun e gjerë të kafeneve që shtrihen nga Fez në Basra analizohen lajmet më të fundit, vlerësohen botimet zyrtare dhe hamendësohet se kush qëndron prapa tyre. Publiku refuzon të gëlltisë informacionin e ofruar dhe janë të prirur të shkojnë dhe ta kërkojnë diku tjetër.

*Historian dhe pedagog në Universitetin e Kembrixhit. Autor i 'Electric News in Colonial Algeria' (2019, Oxford University Press).

BURGU I PËRJETSHËM I GEORGES IBRAHIM ABDALLAH PËR T'I KËNAQUR AMERIKANËT

“Terrorist” një herë, terrorist gjithmonë?

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut ndalon mbajtjen e një të dënuari në burg "pa shpresë për lirim". Sidoqoftë, kjo duket se korrespondon me fatin e aktivistit komunist libanez Georges Ibrahim Abdallah i burgosur në Francë për më shumë se një e treta e një shekulli.

NGA PIERRE CARLES*

Në fund të marsit 2020, për t'i zhbllokuar burgjet franceze në një kohë kur pandemia e koronavirusit ka të ngjarë të bëjë kërdi atje, Ministri i Drejtësisë Nicole Belloubet urdhëroi lirinë e 13.500 të arrestuarve brenda dy muajve në vazhdim. Këta janë kryesisht njerëz që kanë vuajtur pjesën më të madhe të dënimit. Në kohën kur ministri mori këtë vendim, qendra e paraburgimit të Lannemezan (Hautes-Pyrénées) strehoi z.Georges Ibrahim Abdallah, një aktivist komunist libanez, i cili e luftoi pushtimin e vendit të tij nga Izraeli në 1978. Ai përfundoi dënimin e tij nga 27 tetori 1999. Prandaj ai është i lirë që nga ... shekulli i kaluar.

Në vitin 2020, ai fillon vitin e tij të 36-të të burgimit. Një “rekord francez” për një aktivist politik. Me përjashtim të Italisë, burgosja për kaç gjatë është e jashtëzakonshme në vendet e Bashkimit Evropian.

Georges Ibrahim Abdallah u gjykua dhe u dënua për bashkëpunim në vrasje me dashje. Në sytë e drejtësisë, ai nuk është një vrasës. Gjatë gjyqit i akuzuari mohoi të kishte marrë pjesë në veprimet për të cilat u arrestua dhe u dënua. Por ai e deklaroi se solidarizohet me disa luftëra radikale militante, si dhe shprehu mbështetjen e tij për Fraksionin Revolucionar të Armatosur të Libanit (FARL-Fraction armée révolutionnaire libanaise), një grup luftëtarësh të rezistencës komuniste që morën armët dhe vranë, në vitin 1982, atashëun ushtarak të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara, Charles Ray, si dhe një zyrtar izraelit dhe anëtar të Mossadit (shërbimi sekret izraelit), Yacov Barsimontov, të dy të vendosur në Paris.

Atë vit, Izraeli sulmoi Libanin, me bekimin e administratës Reagan, në një përpjekje për ta asgjësuar Organizatën për Çlirimin e Palestinës (OÇP), të vraste ose të kapte Yasser Arafatin, udhëheqësin e rezistencës palestineze. Në sytë e FARL, të dy atentatet përbënin një akt rezistence të armatosur ndaj agresionit ushtarak. Dhe gjatë gjykimit të tij në gjykatë, në shkurt 1987, Abdallah u shpreh: “Nëse populli nuk më ka besuar nderin e pjesëmarrjes në këto veprime antiperimale që m'i atribuoni, të paktën kam nderin të akuzohem nga gjykata juaj dhe kështu mund ta mbroj legjitimitetin e tyre përballë legjitimitetit kriminal të ekzekutuesve”.

“Të gjithë burrat me mjekër ngajnë njësoj”

Cila arsye tjetër mund të justifikojë moslirinë, në vitin 2020, të një bashkëpunëtor në vrasje, i cili ka vuajtur 36 vjet burg? Sjellja e tij në burg frymëzon respekt mes rojeve dhe drejtorit i qendrës së burgut diskuton me të për situatën në Lindjen e Mesme. Sado e çuditshme të duket, ka edhe gardianë të qendrës së burgjeve, të cilët, duke mos kuptuar pse

kollegët e tyre në Tarbes nuk u mobilizuan për ta kërkuar lirinë e tij, paralajmëruan militantët e qelisë komuniste të Tarbes për praninë e këtij marksisti libanez në burg prej kaç shumë vitesh.

Por moslirinë e tij gjen një shpjegim në fjalimin e Ministres së drejtësisë para Asamblesë Kombëtare më 8 Prill, në mes të një pandemie. Atë ditë, znj.Belloubet saktëson se ajo përjashton nga lirinë i parakohshëm “kriminelët, njerëzit e dënuar për dhunë në familje dhe të arrestuarit terroristë”. Sidoqoftë, megjithëse grupi i armatosur të cilin Abdallah supozohet se i përkiste, nuk ka kryer akte terroriste në kuptimin në të cilin zakonisht përdoret (sulme pa dallime, bomba në rrugë, vrasje të civilëve që synojnë të terrorizojnë popullatë), drejtësia franceze e cilëson atë si “terrorist”. Pse? Për shkak të akteve sigurisht kriminale, por për të cilat FARL nuk janë autorë ...

Sepse, disa muaj para shfaqjes së z.Abdallah para gjykatës në Paris, në fund të shkurtit 1987, atentatet sollën zi në kryeqytet (RER, zyra postare, dyqani Tati). Bilanci: 14 të vdekur dhe më shumë se 200 të plagosur. Shumica e mediave kryesore (Le Monde, Liberation, Le Figaro, RTL, France Inter, Europe 1, kanalet kryesore televizive) pastaj transmetuan fjalët e Ministrisë të Brendshme Charles Pasqua dhe të ndihmësit i tij Robert Pandraud. Të dy ia ngarkuan përgjegjësinë për këto veprime terroriste : FARL dhe vëllezërve të Georges Ibrahim Abdallah. Sidoqoftë, siç Pandraud dhe Pasqua do të praninin disa vjet më vonë, ata hodhën emrin e Abdallahut në shtyp për ta fshehur faktin se nuk e dinin në atë kohë kush janë atentatorët: “Në fillim, ne kishim si pistë FARL-in mbi bazën e dëshimve të para ku u tha se i kishin spikatur vëllezërit Abdallah në skenën e sulmeve, edhe pse e dinim se për francezët, të gjithë burrat nga Lindja e Mesme, me mjekër, duken njësoj, pranon Robert Pandraud. Unë i thashë vetes se pista që Abdallah të ishte përgjegjës nuk do të dëmtonte.

Gazetarët me ndikim (Edwy Plenel dhe Georges Marion, pastaj gazetarët hulumtues në Le Monde, Charles Ville-neuve të TF1, etj.) pranuan “pistën e Abdallahut”. Ata pretendojnë se vëllezërit e Abdallah donin të bënin presion ndaj qeverisë franceze për ta siguruar lirinë e shokut të tyre të burgosur duke vendosur bomba. Por, në realitet, sulmet terroriste të vitit 1986 u kryen nga anëtarët e Hezbollahit libanez të instrumentalizuar nga Teherani. Në atë kohë, Irani e kundërshtoi Francën për përkrahjen ushtarake të Irakut të Saddam Husseinit në luftën e gjatë dhe vrastare kundër Republikës Islamike (1980-1988: 1 milion të vdekur).

FARL nuk kreu akte terroriste kundër civilëve, por atentate në shënjestër të ushtarëve. Sidoqoftë, e ndikuar nga informacioni i rremë i dhënë nga mediat, drejtësia franceze nuk dyshoi në natyrën



“terroriste” të veprimeve të Abdallah dhe FARL. Që atëherë, ka qenë e pamundur të hiqet ky etiketim.

Më 25 shkurt, në Bejrut, Bruno Foucher, Ambasadori Francez në Liban, priti disa gazetarë për drekë. Midis ëmbël-sirës dhe kafesë, ai u mor në pyetje nga një korrespondent francez për rastin e Georges Ibrahim Abdallah.

Diplomati nuk mund të pretendojë ta injorojë këtë dosje. Çdo 14 korrik, në Bejrut, qindra demonstrues qëndrojnë përpara ambasadës së saj për ta kërkuar lirinë e bashkatdhetarit të tyre. Që nga viti 2004, data e kërkesës së parë për lirinë me kusht të refuzuar në apel, aktivistit libanez i është refuzuar lirinë shtatë herë. Siç mund të pritej, Foucher u përgjigj se dosja ishte çështje drejtësie dhe jo e diplomacisë apo fuqisë politike. Sidoqoftë, do të shohim se nën presidencën e François Hollande, Manuel Valls, Ministri i Brendshëm, ndërhyri drejtpërdrejt për ta bllokuar lirinë e Abdallahut.

Sekretari i Partisë Komuniste Franceze (PCF), z.Fabien Roussel i dërgoi një letër më 14 Prill, 2020, Ministres së Drejtësisë, znj.Belloubet. Ai bëri thirrje për lirinë e z.Abdallah, duke besuar se “askush nuk mund të thotë që sot ai do të përfaqësojë ndonjë rrezik për vendin tonë”. Z. Roussel parapriu kështu pohimet e qeverisë amerikane për të cilët “burgosja e përjetshme [është] e përshtatshme për krimet e rënda të kryera nga z.Abdallah dhe është e ligjshme të shqetësohet për rrezikun që do të përfaqësojë për bashkësinë ndërkombëtare nëse ai do të ishte i lirë”. Zëdhënësi nga Veriu, drejtuesi i PCF e di se në tokat komuniste të ish pellgut të minierave, Georges Ibrahim Abdallah është paraqitur si “Nelson Mandela i Lindjes së Mesme”. Komunat e Grenay dhe Calonne-Ricouard (Pas-de-Calais) e kanë shpallur qytetar nderi.

Zonja Belloubet iu përgjigj z.Roussel më 6 maj: “Nuk është kompetencë e Ministrisë të Drejtësisë që të japë udhëzim për prokurorët në raste dosjesh individuale dhe as të ndërhyjë në procedurat ligjore. (...) Dhënia e një modifikimi të dënimit është vetëm kompetencë e juridiksioneve të zbatimit të dënimeve që vlerësojnë sovranisht dhe në mënyrë të pavarur mundësinë e dhënies së një mase të tillë”. Por gjashtë javë më parë, qeveria franceze liroi Jalal Rohollahnejad, një inxhinier iranian i arrestuar në aeroportin

e Nice me kërkesë të Amerikës. Drejtësia kishte dhënë një vendim të favorshëm për ekstradimin e tij në Shtetet e Bashkuara; ai ishte gati të dorëzohej pranë autoriteteve amerikane. Por Irani atëherë ofroi ta shkëmbente atë për Francën për të liru studioesin francez Roland Marsal. Dhe, më 20 Mars 2020, z.Rohollahnejad hipi në një avion për në Teheran ndërsa Roland Marsal mori rrugën e kundërt. Kur është fjala për z.Abdallah, nga ana tjetër, autoritetet politike franceze e mbajnë atë në burgim për të kënaqur Washingtonin.

Ndërhyrja amerikane nuk ka ndaluar kurrë në këtë çështje. Më 21 nëntor 2012, ndërsa Gjykata (le tribunal de l'application des peines-TAP) vendosi në favor të lirim të z.Abdallah, Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Francë, Charles Rivkin në një njoftim për shtyp tha se ai “nuk e pëlqeu vendimin e TAP për dhënien e lirisë me kusht për terroristin e dënuar Georges Ibrahim Abdallah. Ai shtoi: “Shpresoj që autoritetet franceze do të apelojnë vendimin e marrë sot dhe se ai do të anulohet”. Prokuroria apelo kundër vendimit. Dhe këtë herë, më 10 janar 2013, Gjykata e Apelit konfirmoi që z.Abdallah duhet të lirohet. Duke mos pasur shtetësi franceze ose leje qëndrimi, gjithçka që duhet të bënte ishte të linte territorin francez. Avokati i tij Jacques Verges tashmë ishte i kënaqur: “Unë e prita me shumë satisfaksion këtë vendim, sepse u kisha kërkuar gjykatave franceze që të mos sillëshin më si një prostitutë përballë tutorit amerikan. Lirinë e klientit të tij priste nënshkrimin e një urdhri dëbimi – një formalitet.

Por një ditë pas vendimit të gjykatës së apelit, zëdhënësjja e Departamentit të Shtetit të SHBA, znj.Victoria Nuland, u shpreh: “Ne jemi të zhgënjyer nga vendimi i gjykatës franceze [të apelit] (...) Ne nuk mendojmë se ai duhet të lirohet dhe po vazhdojmë bisedimet me qeverinë franceze për këtë çështje”. Pastaj Sekretarja e Shtetit me President Barack Obama-n, Hillary Clinton priti që anëtarë të caktuar të qeverisë franceze, përfshirë Ministrin e Jashtëm Laurent Fabius, të pranajnë kërkesat e administratës amerikane. Pas vendimit të gjykatës së apelit, në kohën që ajo përgatitej të largohej nga Departamenti i Shtetit, ajo i dërgon këtë mesazh: “Megjithëse qeveria franceze nuk është e autorizuar me ligj të rrezojë vendimin e Gjykata e Apelit e 10 janarit, shpresojmë se autoritetet franceze mund

të gjejnë një bazë tjetër për ta kundërshtuar ligjshmërinë e vendimit” Por, që kësaj kërkesë t'i përgjigjeshin pozitivisht kërkohej ndihma e Ministres franceze të Drejtësisë, znj.Christiane Taubira. Disa muaj më parë ishte lëshuar një qarkore që i ndalonte asaj, si dhe çdo anëtar tjetër të ekzekutivit, t'i adresonte udhëzime prokurorëve.

Emmanuel Macron « ndalohet » në Tunis

Kush mund t'i mbështeste Shtetet e Bashkuara dhe Laurent Fabius të shmangin, pavarësisht kësaj, lirinë e Abdallahut? Përgjigja erdhi tre ditë më vonë. Më 14 janar 2013, Ministri i Brendshëm Manuel Valls refuzoi ta nënshkruajë urdhrin e dëbimit të z.Abdallah. E befasuar nga kjo ndërhyrje e një anëtar të ekzekutivit në një çështje ligjore – e cila kundërshtonte qarkullimin e Shtatorit 2012 – Ministria e Drejtësisë z.Christiane Taubira bëri thirrje për mbikqyrje nga Presidenti i Republikës. Z. Hollande nuk ndërhyri. Ai le të veprojë Ministrin e brendshëm. Në këtë mënyrë, aktivisti komunist libanez mbetet në burg. Në Liban, familja e tij kishte marrë tashmë rrugën për në aeroportin e Bejrutit për ta mirëpritur.

Z. Emmanuel Macron u ndalua për çështjen Abdallah gjatë vizitës së tij të parë zyrtare në Tunizi, më 1 shkurt 2018. Ndërsa ai shëtit nëpër medinën e kryeqytetit, aktivistët tunizian filluan të brohorisin “Lironi Abdallahun!” Në imazhet e celularëve që kanë regjistruar skenën, shihet sesi Presidenti i Republikës kthehet i habitur drejt këshilltarëve të tij. Ai duket se nuk e kupton se çfarë po ndodh, derisa një zyrtar tunizian që e shoqëron delegacionin i shpjegon atij se kush është Abdallahu. Në Francë, asgjë nuk ndodhi. Më pak se tre muaj pasi u “ndalua” në Tunis, z.Macron fali një të burgosur të dënuar me burgim të përjetshëm për vrasje.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut ndalon dënimin e një të burgosuri “pa shpresë për lirim”. Sidoqoftë, kjo duket se korrespondon me fatin e aktivistit komunist libanez Georges Ibrahim Abdallah.

* Regjisor i filmit: “Kush e dëshiron Georges Ibrahim Abdallah në burg?”

NJË KOMUNITET HULUMTUESISH DHE INXHINIERËSH TË CILËT NDËRMARRËSIT E START-UP TË SOTËM VUAJNË TË BARARAZOJNË

Izolimi në qytetet sekrete të atomit sovjetik

Nga bomba H deri në pushtimin e hapësirës, shumica e programeve kryesore teknologjike sovjetike u krijuan brenda mureve të qyteteve sekrete. Shkencëtarët, inxhinierët dhe punëtorët jetuan në izolim, në një univers relativisht të paprekur. Që nga rënia e BRSS, këto qytete kanë luftuar për të krijuar një erë të re. Siç është rasti i Sarov, një nga qendrat ushtarake të kërkimit bërthamor.

NJË REPORTAZH NGA CHRISTOPHE TRONTIN*

Vit pas viti, 50.000 pelegrinë vijnë në Divejevo për të ecur në gjurmët e Shën Sérafim (1754-1833). Aty ndodhet një shkëmb, në mes të pyllit, në të cilin asketi rus lutet për ditë me rradhë. Pak më tej, burimi me ujë të ftohtë ku mbushen shishet dhe enët e tjera. Më entuziastët zhyten në liqenin e vogël ngjitur. Në fund, sheshi i katedrales përballë së cilës të gjithë shkruajnë emrat e tyre. Sidoqoftë, Sarovi dhe Monastère de l'Assomption, lidhje të vërteta historike të shenjtorit të vendosur dymbëdhjetë kilometra më larg, janë të ndaluar të vizitohen. Qyteti, që ende sot njihet me emrin kodik Divejevo-16, është i mbyllur për publikun.

Divejevo, një aglomerat i rrethuar nga tela me gjemba e i ruajtur nga patrullat ushtarake, u fshi nga hartat e vendit gjatë periudhës sovjetike, banorët e e të cilit u ngarkuan me detyrë, në fshetësinë më të madhe, në "krijimin e mburojës atomike të vendit", fill pas Luftës së Dytë Botërore. Tani sekretit është zbuluar dhe qyteti ka rimanë emrin e tij original, por hyrja mbetet strikte. Vetëm banorët e saj, afro 100.000 dhe vizitorët e autorizuar më parë mund të kalojnë nëpër pikën e kontrollit në hyrje të qytetit. Para se të fillojnë aktivitetet e tyre, Sarovast skanojnë baxhën mbi një skaner, shkruajnë një kod gjashtë shifror, përpara se të kalojnë për kontroll identiteti. Vizitorëve të autorizuar së pari u kërkohet t'i braktisin laptopët, kamerat dhe mjetet e tjera të komunikimit; Ata shoqërohen më pas te shefi i protokollit të kompanisë, i cili do të jetë përgjegjës për lëvizjet deri në dalje, përmes të njëjtës pikë kontrolli, ku do t'u kthehen edhe sendet.

Çuditërisht, Kisha Ortodokse i është përshtatur pa problem këtyre kufizimeve në hyrjen e vendit të pelegrinazhit. Në vitin 2007, gjatë festimit të gjashtëdhjetëvjetorit të krijimit të drejtorisë së 12-të të Ministrisë së Mbrojtjes Sovjetike, përgjegjëse për energjinë bërthamore ushtarake në Kishën e Krishtit Shpëtimtar në Moskë, Presidenti Vladimir Putin foli për pajtimin që u bë, në 1990, midis inxhinierëve ushtarakë dhe autoriteteve spirituale. Atomistët e Sarovit i kthen Kishës ndërtesat e ruajtura të manastirit dhe, në kthim, Patriarku e bëri Serafim-in shenjtorin mbrojtës të atomistëve!

Historia e Sarovit fillon, megjithatë, nën kujdesin e një regjimi që vlerëson më shumë njohuri shkencore sesa ato të mistereve të krijimit. Në konferencën e Yalta-s në shkurt 1945, Stalini i shprehu kryeministrit britanik Winston Churchill dhe Presidentit të SHBA-se Franklin Roosevelt frikën se Washingtoni dhe Londra do

të përfundonin duke shkaktuar konflikt me Moskën. Ai nuk mendoi se do kishte të drejtë kaq shpejt: sapo u pushtua Berlina, këta aleatë po diskutonin nëse do të përfitonin nga epërsia e tyre strategjike për ta mundur BRSS e dobësuar nga lufta. Më 16 korrik, kërcënimi u bë më i qartë: Projekti i Manhattan pati sukses dhe shpërthimi i parë bërthamor në histori tronditi shkretëtirën e New Mexico-s. Më pas pason asgjësimi i Hiroshima-s dhe Nagasaki-t në gusht, i cili largon çdo dyshim të mbetur në lidhje me vendosmërinë e Amerikës për të përdorur këtë lloj të ri arme.

Qeveria e sheh këtë lajm si një paralajmërim të drejtpërdrejtë: pasi vendi është dobësuar nga sakrifkimi i afro 26 milion sovjetikëve dhe shkatërrimi i industrisë së saj, kërcënimi i paraqitur nga aleatët e djeshëm nuk duket më i vogël për ta sesa ai që lindi, katër vjet më parë, nga nazistët. Këshilli i Ministrave, i cili u mbledh në 20 gusht 1945 mori dy qëllime historike: të vazhdojë kërkimin për ta rivendosur barazinë strategjike me Perëndimin; të ecë përpara në fshetësinë më të madhe, në mënyrë që të mos tundonte armikun që ta sulmojë.

Nga fundi i vitit 1945, fillon gjuetia e kantierit ideal për përqendrimin e kërkimeve të fshetë. Pas një studimi mjaft të gjatë, grupi i punës nën udhëheqjen e Lavrenti Beria-s për kryerjen e projektit zgjodhi fshatin Sarov, i vendosur 350 km në lindje të Moskës. Vetë fshati, së bashku me disa fshatra të tjerë – rreth 9500 banorë në atë kohë – u tërhoqën nga administrata territoriale e Mordovia-s dhe u fshinë nga të gjitha hartat dhe dokumentat zyrtare. Banorët e fshatit u përzgjedhën. Ata që ishin të punësuar në uzinën Nr. 550, e cila është e specializuar në prodhimin e raketave, mbetën aty, autoritetet zhvendosën të tjerët jashtë zonës së ndaluar.

Me fluksin e punëtorëve dhe specialistëve, fshati gradualisht mori formën e një qyteti të vogël: filluan me ndërtimin e godinave të apartamenteve, më pas nevojitej një spital, një stadium, një shtëpi kulture, një bibliotekë, një teatër dhe një park. Ndërtimi po zhvillohej në mënyrë të shkujdesur, pa plan paraprak. Për të kursyer kohë, një pjesë e laboratorëve ishin instaluar në ndërtesat e manastirit. Midis personave të punësuar kishte përfaqësues të "kontigjentit special" (kështu quheshin të burgosurit në dokumente zyrtare).

Para çdo rekrutimi, organet e sigurisë kontrollonin background-in e kandidatit "deri në gjeneratën e tretë" nëse ishte inxhinier në zyrën e projektimit "KB-11", ose një punëtor i

vendosur në një prej shumë kartierëve të specializuar. Punonjësit e kantierit mund të largoheshin vetëm me leje nga shërbimi i sigurisë. Largimet për arsye personale lëshoheshin me vështirësi. Pushimet jashtë zonës ishin të ndaluara, një kufizim që shkaktonte kompensim në paga. Një privilegj i rëndësishëm në këtë kohë, dyqanet e Sarov, ishin të pajisura më mirë sesa ato në pjesën tjetër të vendit.

Qyteti mori emrin e kodit të Arzamas-16. Që nga ajo kohë, thirrja e saj me emrin tradicional konsiderohej një zbulim i informacionit sekret. Korrespondenca private kryhej përmes një kutie të posaçme poste të quajtur "Moscow Center-300". Për më tepër, emrat e rrugëve në qytet përfutsheshin me ata në Moskë, kështu që punonjësit e KB-11 që ishin në lëvizje mund të kalonin një kontroll identiteti e kjo nuk lejonte që polici të dyshonte për vendbanimin e vërtetë.

Nevoja për fshetësi dhe izolim kishte efekte psikologjike të ndryshme në varësi të personit: fizikani Andrei Sakharov, foli për një "privim lirie që i peshonte". Një tjetër, përkundraz, vlerësonte fleksibilitetin e zyrtarëve përgjegjës për sigurinë në kufi... Ligji i izolimit ishte i ashpër dhe Sarov, për këta inxhinierë, ishte bërë edhe një herë një manastir i mbyllur për pjesën tjetër të botës. "Besimi i vërtetë nuk mund të mbetet i papunë," kishte deklaruar Sérafim; ai që beson vërtet ka gjithmonë diçka për të bërë". Kjo i përshtatej shkencëtarëve të Sarovit, të cilët i kalonin orët e rralla të kohës së lirë duke folur për përqendrujesin e neutroneve.

Ekspertë të kërkimit shkencor

Më 12 mars 1947, sikur të jepte një goditje shtesë për ekipet e studiuesve që, të rraskapitur, po vriteshin në punë, Presidenti Truman përcaktoi doktrinën e tij të famshme, duke inauguruar Luftën e Ftohtë. Në Washington, stafi i tij përgatiti planin Dropshot, i cili do të zyrtarizohej në fillim të vitit 1950, atë të një sulmi të befasishëm ndaj BRSS, "duke hedhur 200 deri në 300 bomba atomike në qendrat kryesore industriale, ushtarake dhe shkencore të BRSS".

Rezultati i punës së koordinuar të shkencëtarëve, inxhinierëve dhe ndërtuesve më të shquar të vendit, si dhe shërbimeve të inteligjencës dhe "spionëve atomikë" ishte krijimi, në vetëm katër vjet, i bombës së parë atomike sovjetike, i cili mbante emrin kodik RDS-1. Disa dekada më vonë, një nga drejtuesit e programit, Youli Khariton, shkroi për këtë periudhë: "Unë jam i mahnitur dhe përulem me respekt për atë që bëri populli ynë

nga 1946 deri në 1949. (...) (Kjo) periudhë intensiteti, heroizmi, kreativiteti dhe lodhjeje është e pamundur të përshkruhet. Katër vjet pas përfundimit të një lufte deri në vdekje kundër fashizmit, vendi im ka arritur ti japë fund monopolit amerikan në bombën atomike".

Duke u bazuar në këtë arritje, skuadrat e Sarovit luftuan Shtetet e Bashkuara në katër vite duke zhvilluar bombën e parë H. Duhet theksuar se kjo ndodhi pikërisht pasi vendi ishte i shkatërruar nga lufta, e ishte duke kryer paralelisht rindërtimin, ndërta Shtetet e Bashkuara, të pasuruara, kishin mjete financiare kolosale dhe një aparat ushtarako-industrial të pakrahasueshëm. Në vitin 1950, ekonomia amerikane përfaqësonte 27% të produktit kombëtar bruto në botë, kundrejt 9.6% për BRSS.

Ky model i një qyteti të izoluar të ndërtuar rreth një "ndërmarrje-qyteti" është rimarrë për lidhjet e shumta të atomit sovjetik. Ndërsa Sarov ishte qendra e projektit atomik, i mbushur me figura udhëheqëse në kërkimet shkencore, dhjetëra kantiere të tjerë të ngjashëm kontribuan në përpjekjen kombëtare. Kështu, qysh në vitin 1945, disa qytete të vogla në Urals dhe Siberia u zgjedhën të siguronin lëndën e parë për këto eksperimente. Më 1946, një reaktor i krijuar nga Instituti Shkencor-Teknik Maïak po prodhonte plutonium të gradës ushtarake në qytetin e izoluar Ozersk, afër Chelyabinsk (emri kodik Chelyabinsk-65). Dhe, në vitin 1949, një qytet tjetër i izoluar i quajtur Tomsk-7 ishte angazhuar në prodhimin, gjithashtu në fshetësinë më të madhe, të uranimit 235. Këtu, studimi ishte më pak i mprehtë dhe më i drejtuar drejt zgjidhjes së detyrave praktike të diktuar nga koha e Arzamas-16 (Sarov). Të burgosurit politik ose të zakonshëm nga Gulag u mobilizuan për punët më të rrezikshme, siç është nxjerrja e xeherit të uranimit ose trajtimi i materialeve të copëtuara, sipas parimit të shprehur në mënyrë cinike nga Stalini: "Armiqtë e popullit të vet kanë një rol për të luajtur në ndërtimin e socializmit". Në vitin 1945, raporton historiani Yuri Fyodorov, trembëdhjetë kampe pune të drejtuara nga NKVD (Ministria e Brendshme) me 103.000 të burgosur u vunë në dispozicion të projektit atomik. Më vonë, ishin 190.000 të burgosur të caktuar për nxjerrjen e mineraleve të ndryshme. Sa prej tyre i panë shtëpitë e tyre sërish?

Ndërsa kërkimet teorike ishin duke u zhvilluar mirë dhe furnizimi i lëndëve të para u sigurua, vendi i provës duhej të ishte i vendosur në një zonë në shkretëtirë me kushte të përshtatshme gjeologjike. U zgjodh

steпа kazake, afër qytetit të Semi-palatinsk. Aty përsëri u vendos një kantier ndërtimi kolosal: në të gjithë epiqendrën e planifikuar, ndërtesat, bunkerët, stacionet e metrosë ishin mbyllur për vlerësimin e fuqisë shkatërruese të bombës. Punëtorët e ndërtimit, por edhe biologët, fizikanët dhe specialistët e tjerë të mobilizuar për të studiuar efektet shkatërruese të valës së tronditjes dhe rrezatimit, u vendosën në njëqind kilometra nga pika e provës, duke bërë edhe këtu, lindjen e një qyteti që i nënshtrohet të njëjtit regjim fshetësie absolute: Moskë-400.

Të shpëtohet atdheu

Mund të shkohet pa leje në këtë qytet, popullsia e të cilit mezi tejkalon një mijë. I rrimëruar Kourtchakov, për nder të drejtorit shkencor të programit bërthamor Sovjetik, vendi ka humbur shkëlqimin e tij, në rrugët e bëra me pllaka betoni e me pemët e mbjella rrjesht, ndërtesat e vjetëruara të stilit stalinist dhe hotelet e pakta. Qyteti është ende shtëpi për Institutin e Fizikës Bërthamore, i cili modelon dhe teston, në bashkëpunim me një ekip shkencëtarësh japonezë, situata krize në një reaktor kërkimi të vendosur në vendin e ish-provës. Një tjetër i mbijetuar i epokës sovjetike, Instituti i Sigurisë Radiologjike është ende i mbyllur për publikun. Por mund të vizitohet Muzeu i Vogël Poligon, ku me një mori hartash personeli dhe foto bardh e zi, rikrijohet bomba epike sovjetike. Pajisjet matëse sizmike, aparatet Geiger, kamerat e asaj kohe dhe madje edhe vendi nga i cili u dha urdhri për të plasur bombën, gjithçka është atje, e rreshtuar, me pluhur, solemne. Nëpër shkallë, udhëzuesi ju fiton të mblidheni në "zyrën e Kourtchatov", të paktën atë ku ai punoi gjatë qëndrimeve të tij të shkurtra në vend gjatë provave. Një inkubator i quajtur Parku i Teknologjisë Bërthamore kërkon të ringjallë sojin shkencor të qytetit...

Rrjeti i qyteteve të izoluar të atomit përbënte një komunitet të gjerë shkencëtarësh, studiues, inxhinierë, eksperimentues, të përqendruar plotësisht në një qëllim, i cili ishte shpëtimi i atdheut nga rreziqet e reja që e kërcënonin. "Sado paradoksal të duket, ky qytet i mbyllur për të tjerët ishte i lidhur nga një mijë fije me qindra organizata dhe kompani brenda vendit, shumë më fuqishëm se shumë nga gjigantët e industrisë kombëtare të vendosura në përgjithësi nëpër qytete, shkruan historiani Vladimir Matiouchkine në kronikën e tij të Sarov. Dhe pa dyshim, shumë nga banorët e saj e ndjenin pulsën e pjesës tjetër të botës, të planetit, shumë më fuqishëm se sa bashkëqytetarët e tyre



sovjetikë. Vendin e saj në histori, lidhjen me ngjarjet botërore, çdo banor i qytetit e ndjente, mbase pa vetëdije, dhe ishte krenar për këtë”.

Por kjo epokë heroike nuk mund të zgjaste përgjithmonë dhe mobilizimi total i forcave do të çonte në shterjen e sistemit. Nga veteran i patundur në sekretar i përgjithshëm i vjetërsuar, udhëheqja sovjetike u shkatërrua përfundimisht në një konformizëm të ngurtë, ndërsa aparati industrial ngeci dhe u përkeqësua. Të lodhur duke u shtyrë vazhdimisht për t'u shfrytëzuar nga drejtuesit e saj, banorët ishin të frustruar nga kjo ngecje. Këtë herë, ishin ato që nuk pranuan ta miratojnë këtë regjim, i cili s'ishte në gjendje të siguronte, në vend të idealit të fantazuar të barazisë dhe vëllazërimit, këto mallra konsumatore për të cilat ëndëronin dhe të cilat i janë privuar në emër të emergjencave dhe krizave. Njerëzit po zhvendeshin në zhgënjim dhe madje edhe alkoolizëm. Gorbachev, i cili diagnostikoi saktë problemin, nuk do të ishte në gjendje ta ndalonte atë.

Vitet 1990 do të harxhohen duke u përpjekur të krijonin një ekonomi tregu nga rrënojat e planeve pesëvjeçare, në të njëjtën kohë kur ndodh një përpjekje e rrezikshme demokratike. Ekonomistët rusë dhe të huaj peshojnë meritat e këtij apo atij lloji tranzicioni, ndërsa më shumë oligarkë prosaikë blejnë kompani të naftës, industrinë e çelikut, shkrirësit e aluminit, minierat, fabrikat kimike për shumë lirë. Falimentimet janë në rritje, papunësia po shpërthen dhe kompanitë që i rezistojnë trazirave po paguajnë pagat në rubla jashtmasë të zhvlerësuar. Sektorëve të shoqërisë i ndalohet financimin njëri pas tjetrit, nga shëndetësia në arsim, policia dhe gjyqësori.

Urrejta po rritet, lulëzon separatizmi. Lufta në çeçeni ngjall, midis popullsisë së tronditur dhe të poshtëruar, jo entuziazmin, por një etje jo të shëndetshme për hakmarrje.

Të pyetur për numrin e frikshëm demografik të spastrimeve, shtypjeve dhe kampeve të tjera të internimit të periudhës sovjetike, komunistët rusë, të cilët ishin bërë ofertë elektorale ndër të tjera, nënvizojnë plagët, po aq tronditëse në sytë e tyre, që liberalizmi i shokut ka lënë në piramidën e moshës gjatë pesëmbëdhjetë viteve pas rënies së regjimit sovjetik: midis 1992 dhe 2008, vdekjet tejkaluan lindjet me njëmbëdhjetë milion. Shkaku: degradimi i shërbimit shëndetësor, shpërthimi i krimit, rritja e vetëvrasjeve, aksidentet dhe katastrofa të të gjitha llojeve, përveç luftës në çeçeni. Nga 1990 në 1994, pritshmëritë për jetëgjatësinë e rusëve ranë në mënyrë dramatike, nga 65 në 58 vjet për burrat dhe nga 74 në 71 vjet për gratë, përpara se të rritej me shpejtësi që nga ajo kohë.

Në këtë kontekst, qytetet e izoluar ndiheshin si xhevahirët e fundit të perandorisë. Hapësira relativisht të paprishura, ku njerëzit qëndronin në shoqëri të mirë, të sigurt, nëse jo nga korrupsioni, të paktën nga format e saj më të çoroditura, nga mafia, nga krimi. Mbi të gjitha, aparati shkencor sovjetik, i cili diku tjetër është shitur dhe shkatërruar, këtu mbetet i strehuar nga lakmia e të kthyerve të rinj në liberalizëm. Vazhdohet të merret me detyrat esenciale të tilla si prodhimi i materialit të copëtimit (për përdorim ushtarak dhe civil), përpunimi i karburantit, çarmatimi dhe krijimi i armëve të reja.

Këto qytete, të konceptuara fillimisht si lagje të thjeshta të konvikteve për punonjësit e “qytetit-biznes”, të cilat përbënin pothuajse të gjithë punësimin lokal, qenë diversifikuar. Dyqane, restorante, kinema, qendra tregtare janë ndërtuar, si dhe agjencitë e udhëtimit dhe pasurive të patundshme. Ndërsa aktivitetet kërkimore humbën intensitetin e tyre me katastrofën ekonomike post-sovjetike, forca punëtore migroi në punë civile më fitimprurëse. Shërbimet publike (furnizimi me energji, administrimi i ujit, transporti publik), fshatrat për

pushime, infrastruktura kulturore apo sportive tani ishin përgjegjësia e bashkisë ose transferoheshin në sektorin privat. Edhe qytetet shkencore, të cilat kanë mbajtur statusin e qyteteve të mbyllura, qenë duke u normalizuar ... ndërsa ruajnë veçantinë kulturore.

Po t'i sugjeroni një banori të Sarovit hapjen e qytetit, ai menjëherë do të përgjigjet: “Kurrë në jetë!” Edhe nëse në ditët e sotme avantazhet e kohës sovjetike janë një gjë e së kaluarës, edhe nëse sekretit është zbuluar prej kohësh, ndërsa të gjithë tani mund të korrespondojnë me pjesën tjetër të botës, banorët e qyteteve të izoluar mbajnë “mes njeri-tjetrit” e tyre.

Veteranët e epokës heroike u larguan për një jetë më të mirë, por fëmijët dhe nipërit e mbesat e tyre qëndruan kryesisht këtu. Gjysma e tyre punojnë në ndërmarrjet e qytetit, ku “dinastitë” e studiuesve dhe inxhinierëve po punojnë për përpunimin teknik në një mori sektorësh, civile dhe ushtarake. Institutet e modernizuara të kërkimit atomik dhe fabrikat e kondicionimit dhe ripërpunimit të lëndëve djegëse vazhdojnë kërkimin e tyre për “atomin e duhur”. Edhe nëse nuk arrihet ky ideal, të paktën ato tani veprojnë nën kontrollin e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (ANEA) dhe sipas standardeve shumë të ndryshme nga koha e fillimeve, kur lumi konsiderohej si mënyra më e mirë për të hequr qafe materiale të rrezikshme.

Shumimi i “technoparks”

Gjysma tjetër gjeti punë në startupe dhe në firma kontraktore të kompanive të mëdha. Në Sarov, për shembull, inkubatori Binar pret projekte të larmishme të teknologjisë së lartë për pesëmbëdhjetë vitet e fundit: lentet intraokulare, instrument matës për hollësinë e metalit ndërsa del nga makineria, ose sensorë të destinuar për sigurinë në centrat bërthamore. Niveli i arsimit është në mënyrë të konsiderueshme më i lartë se mesatarja kombëtare,

e kombinuar me atmosferën e qetë dhe të guximshme të qytetit të izoluar, dhe afërsia me kompani ultra të specializuara, inkurajojnë përhapjen e projekteve të teknologjisë së lartë. Shkalla e papunësisë është më e ulët se ajo e qyteteve të tjera me madhësi të ngjashme (4%, krahasuar me 6% në shkallë vendi). Kjo subkulturë “e mbyllur” mirëmbahet edhe nga Klubi i Qyteteve të Izoluara, i cili organizon shkëmbime, stazhe dhe kampe verore për banorët e tyre.

Sidoqoftë, një pjesë e këtyre ish-qyteteve të fshehta është zhvendosur nën ligjin e përbashkët. Ashtu si Obninsk, ku u zhvillua termocentrali i parë civil bërthamor, ose Dubna, një qendër themelore kërkimore, ose Zagorsk-7, qendra kërkimore mbi armët bakteriologjike është çmontuar. Vetëm qytetet që varen nga Ministria e Mbrojtjes ose që i bashkëngjiten Rosatom, ndërmarrjes shtetërore që bashkon të gjitha aktivitetet civile të lidhura me atomin, rreth dyzet gjithsej, mbeten të mbyllura. Arkipelagu i shkencës po shkrihet gradualisht në normalitet.

Rosatom mbikëqyr një duzinë qytete të mbyllura dhe institutet e tyre të kërkimit, qendrat e tyre të pasurimit dhe ripërpunimit të karburantit. Në Iran, Indi, Kinë dhe Bangladesh, lista e porosive tejkalon njëqind miliardë dollarë dhe tridhjetë projekte termocentralesh janë në ndërtim e sipër. Në fushën hapësinore, teknologjijtë ruse kanë vërtetur vlerën e tyre dhe përfaqësojnë një lidhje kryesore në bashkëpunimin ndërkombëtar të përqendruar në Stacionin Hapësinor Ndërkombëtar. Shumë sisteme, nga modulet e back-upit deri te motorët e raketave, janë përdorur prej kohësh në raketa amerikane dhe evropiane.

Regjistrimi i përpjekjeve të tjera më të fundit për përparime teknologjike është më pak i arritur, si në fushën e inteligjencës artificiale, superkalkulatorëve, nanoteknologjisë ose hulumtimeve mjekësore. Krijuar në vitin 2011

me fonde publike nga Anatoly Tchoubaïs (një nga ideologët e “terapisë së shokut” të stilit rus) me qëllim që të inkurajojë zhvillimin e teknologjive të bazuara në nanoparticles, ndërmarrja shtetërore Rosnano, nga shembull, nuk prodhoi revolucionin teknologjik të shpallur nga promovuesit e tij.

A nuk do të jetë më Rusia në gjendje të shfrytëzojë programin shkencor sovjetik të periudhës së pasluftës, një periudhë shumë më e vështirë dhe e dhimbshme se e tanishmja? A ia ka prerë krahët kalimi në kapitalizëm? Nuk është për mungesë përpjekjesh. Që nga fundi i shekullit, secili qytet, secili rajon, çdo kompani e madhe publike është munduar të ketë inkubatorin e tij, parkun teknologjik, qendrën kërkimore, vendin e start-upeve. Ndonjëherë të mbështetur nga institutet kërkimore, shpesh të bazuara në financimin publik-privat, këto “technoparks” kanë lulëzuar si kërpudha pas shiut që nga mesi i viteve 1990. Kishte 169 prej tyre në fund të vitit 2019, duke i ofruar sipërmarrësve krijues mjedisin që i duhet për zhvillimin e projekteve. Por, siç shoqata Technoparks ka vërejtur vit pas viti, shkalla e suksesit të fillestarëve mbetet mjaft e ulët (27% e kompanive mbijetojnë në fund të periudhës së tyre të inkubacionit, krahasuar me 87% në Sh.B.A dhe 88% në Evropë). Ndoshta është efekt i legjendës, ndonjëherë e idealizuar në Rusi, të start-upit në një garazh nga gjeni të panjohur të gatshëm për të revolucionarizuar botën. Sigurisht, Bill Gates, Steve Jobs dhe Mark Zuckerberg të tjerë nuk i zhvilluan teknologjijtë të cilat promovuan shkëlqyeshëm. Sepse përbërësi kryesor i suksesit – historia e qyteteve të mbyllura na e kujton mjaftueshëm, ashtu si dhe ato të Silicon Valley ose MIT – nuk është garazhi, por një hulumtim themelor afatgjatë i financuar përmes fondeve publike. Krejtësisht e kundërta e kësaj tufe të çregullt përpjekjesh.

*Gazetar

"NJË HERË PARATË, PASTAJ ZOTI"

Të jesh këngëtar në Iran

Të përballur me censurën dhe rendin moral të imponuar nga aparati teokratik, artistët iranianë lëkundën mes vetëcensurimit, detyrimit për të kompozuar me administratën, ose mërgimin, qoftë në Londër apo Los Angeles. Të denigruar nga autoritetet, të cilët e përshkruajnë si "të pahijshëm" dhe të cilët ndalojnë koncertet e kësaj rryme muzikore, rap-i ka fituar mbështetjen e një rinie në nevojë për hapje politike.

NGA KORRESPONDENTJA JONË NË IRAN

THELMA KATEBI*

Atmosfera është qetësuar përgjatë rrugës me pemë të Chahar Bagh-it në Ispahan. Në këtë rrugë këmbësorësh, një nga më të njohurat në Iran, jo larg stendave të artizanëve vendas, altoparlantët luajnë hitet më të fundit të popit persian, një përzierje e ritmeve perëndimore dhe elementeve orientale. Dëgjohen gjithashtu këngët e paevitueshme të divas Gougoush, emri i vërtetë i të cilës është Faeqeh Atashin. Kalimtarët shkëmbejnë buzeqeshje përpara këtyrë manifestimi këmbëngulës të bashkatdhetarëve të tyre për luftuar të ndaluarën. Sepse, në varësi të kontekstit politik, të vendosësh muzikë të tillë mund të çojë në probleme serioze me forcat e rendit. Kjo lloj muzike është ndaluar nga revolucioni islamik në 1979 – Imam Khomeini duke dashur të ndalojë çdo formë të muzikës në sferën publike – pastaj është toleruar përsëri dhe ndonjëherë madje edhe inkurajuar gjatë viteve 1990 me shfaqjen e një rryme reformiste brenda pushtetit, statusi i muzikës pop mbetet i luhatshtëm. Artistët e saj kanë një marrëdhënie të mjeçullt dhe paradoksale me autoritetet.

Muzika tradicionale iraniane nuk është imune ndaj turbullirave të shkaktuara nga pushteti. Një nga simbolet e gjalla të kësaj turbullire është Mohammad Reza Shajarian, i cili së shpejti feston 80-vjetorin. Për iranianët, përfshirë gjeneratën e re, ai është një nga muzikantët klasikë "të vërtetë" të vendit. Artist i njohur ndërkombëtar, i vlerësuar në shumë raste me çmime, ai mbetet megjithatë i ndaluar në mediat zyrtare. Tashmë "fajtor" i metaforave poetike që kritikojnë autoritetet, faj i tij ishte që denoncoi në njërin prej këngëve të tij abuzimet e regjimit kundër demonstruesve të Lëvizjes së Gjelbër, në të cilën u protestua kundër rizgjedhjes së Presidentit Mahmoud Ahmadinejad në 2009. "Ule armën, i urrej këto gjakderdhje...", shprehte atëherë ky monument i këngës persiane. Disa ditë më vonë, ai u përjashtua menjëherë nga valët e Radio-Televizionit të Republikës Islamike nga një agjensi që raportonte drejtpërdrejt tek udhëheqësi suprem Ayatollah Ali Khamenei. Më pas, z. Shajarian u shpreh se gjithsesi ai nuk mund të duronte të dëgjonte më zërin e tij në atë radio dhe nuk do të pranonte as vetë të transmetohej...

Keshtu, shumë këngëtarë preferojnë të shmangin terrenin politik dhe t'i përmbahen regjistrit sentimental. Në një vend ku ashpërsia e ligjeve i bën marrëdhëniet romantike jashtëzakonisht të ndërlikuara, por ku poezia zë një vend të rëndësishëm në jetën e përditshme, ata mund të gjejnë përbërësit e nevojshëm për frymëzim në veprat e Saadi ose Hafez, poetët e shkëlqyeshëm të shekujve XIII dhe XIV. Sidoqoftë, tekstet e këngëtarëve të sotëm – shpesh kritikuar për mungesë të thellësisë së tekstit – ende duhet të marrin miratimin e Ministrisë së Kulturës dhe Orientimit Islamik, e njohur zakonisht si Ershad ("Orientimi"). Në këtë organ, përgjegjës për përhapjen e vlerave islamike, në territorin iranian dhe jashtë tij, ata paraqesin jo vetëm përmbajtjen e albumeve të



tyre, por gjithashtu kërkojnë autorizim për t'i vënë në skenë.

Studiuesja Ameneh Youssefzadeh rishikoi kriteret e vlerësimit të aplikuar nga Ershad dhe seksionin e tyre të "muzikës". Ndër këto kritere përfshihet fakti që "muzika dhe teksti nuk duhet të kritikojnë regjimin dhe autoritetet fetare", as "të inkurajojnë ateizmin, kënaqësinë dhe shthurjen". Ata gjithashtu duhet të "forcojnë ndjenjën e unitetit kombëtar dhe të nxisin një ndjenjë shprese në gjeneratat e reja". Zonja Youssefzadeh tregon se shumë artistë i integrojnë këto udhëzime duke u vetëcensuruar. Në praktikë, ata gjithashtu negociojnë çdo fjalë me agjencinë, duke këmbëngulur në njërin fjalë, duke hequr dorë nga një tjetër, në mënyrë që të marrin dritën jeshile aq të çmuar për ta.

Të meta të tilla, disa prej të cilave ekzistonin që në kohën e Shahut, nuk janë të mjaftueshme për të dekurajuar këndimin, sepse në Iran, muzika është pothuajse aq e rëndësishme sa poezia. Më 16 nëntor 2014, dhjetëra mijëra njerëz u mbledhën në rrugët e Teheranit për të ndjekur procesin e varrimit të Morteza Pashaei, "perandorit" të popit persian, i cili vdiq në moshën 30 vjeçare nga kanceri i pankreasit. Marr spontanisht refrenin e një prej këngëve të tij, "premtom se nuk do të më braktisë, sepse për mua dashuria është një rrugë me vetëm një drejtim, unë do të vdes nëse shkon, është hera e fundit..." , turma ishte aq e dendur sa varrosja e kantautorit në varrezat Behesht Zahra u desh të shtyhej. Në qytetin e Mashhad, një qendër e madhe fetare ku rregullat rreth muzikës janë "drakoniane", tubime spontane mbi lajmet për vdekjen e artistit shkaktuan ndërhyrjen e policisë. Trishtimi i humbjes së një artisti të dashur luajti një pjesë të madhe në këto mbledhje, por shumë nga ata që pushtuan trotuarin atë ditë, e panë këtë funeral edhe si një mundësi për të demonstruar vullnetin e tyre për ndryshime politike.

Me bakshishe i blejmë vetes disa liri

Ndërsa skena muzikore po sheh vazhdimisht hyrje të reja, mbetet fakti se,

ashtu si Gougoush, emra të mëdhenj në pop kanë zgjedhur rrugën e mërgimit. Shumica e tyre u vendosën në zonën e Los Angeles, e njohur si "Tehrangeles", në vitet e para që pasuan revolucionin islamik. Që atëherë, fluksi i largimeve nuk është ndalur kurrë. Krijimi i kësaj skene muzikore Persiane jashtë Iranit, pop-i i Los Angelesit ("Los Angeles pop"), ka shoqëruar krijimin e kanaleve radio në internet që transmetojnë vazhdimisht muzikë persiane. E themeluar në vitin 2004, Radio Javan është një nga më të njohurat dhe ka mbi një milion të abonuar.

Për këngëtarët që kanë mbetur në vend, si për ata që kanë emigruar, këto radio përbëjnë një mundësi për t'u transmetuar në një shkallë të gjerë, kryesisht në Amerikën e Veriut por edhe në Evropë. Radio Javan, Bia2, dhe Radio Farda transmetojnë muzikë pop, rap, si dhe shumë këngëtarë klasikë. Sidoqoftë, zyrtarisht, qeveria iraniane ndalon këngëtarët që kanë mbetur në Iran, të "bashkëpunojnë" me këto media. Ajo i mohon atyre gjithashtu të drejtën për të punuar me muzikantë që kanë emigruar në Amerikën e Veriut. Në vitin 2013, pesë artistë u arrestuan sepse, ndër të tjera, punuan me radio dhe kanale televizive satelitore (Channel 1, Nalbeki, Iran TV Network) që transmetonin nga Shtetet e Bashkuara. Në atë kohë, policia e moralit në Teheran i justifikonte këto arrestime duke iu referuar si "luftë kulturore" e zhvilluar kundër Iranit nga këto media.

Soroush Karimi është një artist nga një familje ku muzika klasike ka qenë gjithmonë shumë e pranishme. Pasi ka filluar të mësojë solfshëzhin e instrumentave në moshë të re, ky këngëtar dhe kitarist aspiron një pozicion "jashtë rrjedhës mainstream" të pop-it. Përkundër të gjitha pritshmerive, ai është i kënaqur me atmosferën më të qetë që mbizotëron në muzikë vitet e fundit. Gjykimi i tij për kolegët është megjithatë i formës së prerë: «Ata që kanë vërtet talent mund të numërohen me gishtat e dorës! Për të, paratë e korrupsionit e ndryshojnë situatën. "Pesë vjet më parë, problemi numër një për një artist ishte marrja e lejes [nga Ershad] për të luajtur muzikën

e tij. Sot me para blen gjithçka. »

Në një vend që mbështetet nga sistemi i vendosur nga Republika Islamike, bakshisheet dhe rryshfetet e tjera bëjnë të mundur blerjen e disa lirive dhe privilegjeve. Madje, tetorin e kaluar, edhe klerikë të rëndësishëm njohën natyrën "sistemike" të korrupsionit. Nuk është çudi që bota e muzikës dhe marrëdhëniet me Ershad-in nuk janë imune ndaj saj. Megjithatë, disa yje të mëdhenj vendas refuzojnë ta luajnë këtë lojë. Një reperet më të njohur të Iranit, z. Yaser Bakhtiari, i njohur me pseudonimin "Yas", ishte artisti i parë i hip-hop të cilit i'u dha miratimi nga Ershad për publikimin e disa këngëve. Një arritje në vetvete. Por nëse ai jeton në Iran, ai nuk mund të japë koncerte atje pavarësisht se ka interpretuar në Australi, Kanada, Shtetet e Bashkuara ose Londër. Në një prej këngëve të tij të titulluar Boghz yani ("Hidhërimi"), ai thotë: "Hidhërimi është një logjikë e fshehtë, që do të thotë se mund të shkoj në koncerte, por vetëm si spektator. Hidhërimi është që po plake dhe akoma nuk jam në gjendje të ngjitem në skenë në Iran. Për të shkruar më lart, ekziston një zgjidhje, duke u lëpirë, por Zoti na dha krenari (...) Më në fund mbërrini edhe në aeroportin Imam [aeroporti Imam Khomeini në Teheran] (...) Në njërin anë pasaportën, në tjetrën çantën, kush është në gjendje të kuptojë gjendjen tuaj në këtë moment? Asnjë. Hidhërimi është momenti kur largoheni nga vendi juaj".

Në një shoqëri të pushtuar nga vështirësitë ekonomike dhe nga sanksionet ndërkombëtare, ku një pjesë e tërë e popullsisë shpreh rregullisht dëshirën e saj për më shumë liri, rap-i, dhe vena e saj kundërshtuese, ze një vend special. Autoritetet e konsiderojnë atë si një zhanër muzikor "të pahijshëm", ndaj kjo gjë detyron shumicën e artistëve iranianë të hip-hopit të performojnë në vende të fshehura, zire-zamin ("underground"). Nga ky status "i paligjshëm" që në fillim, rrjedh një liri që nuk jepet nga këngëtarët që presin për dritën jeshile nga Ershad. Për reperet, referenca është Soroush Lashkari, i internuar në Londër që nga viti 2011 dhe i cili njihet me emrin skenik Hichkas (që do të thotë

"askushi"). Ky rrugëtim i këngëtarit përmbledh evolucionin e Iranit gjatë dekadës së kaluar. Në vitin 2009, ai u bë jehona e shpresës për ndryshim. Në Ye rooze kojob miad ("një ditë më e mirë do të vijë"), ai këndon: «Gjaku do të mbetet në vena dhe nuk do të njohë qiellin dhe asfaltin. Nuk do të pranohet më dhe do të mpikset, asnjë nënë nuk do të shkojë më në varrin e fëmijës së saj». Por një vit më vonë, një këngë që përshkruan realitetin e shoqërisë së Teheranit i shkaktoi telashe me drejtësinë iraniane – gjë që shkaktoi largimin e tij. Edhe sot, shumica e iranianëve të rinj i dinë vargjet e kësaj kënge: «Në ditët e sotme, të parat janë paratë, pastaj Zoti; nga më të vegjëlit deri te më të rëndësishmit, (...) Duhet të jesh i verbër që të mos shohësh këtë kotësi kudo; në rrugë, a nuk e sheh mjerimin dhe prostitucionin, Zoti im zgoju, llumi [vetë Hishkas] ka gjëra për t'ju thënë... ».

'Kumbari' i rap-it persian sigurohet që të mos kapet

Dhjetorin e kaluar, pas protestave kundër kostos së lartë të jetesës dhe korrupsionit, Hichkas publikoi një këngë tronditëse në llogarinë e tij në Twitter. Suksesi ishte marramendës. Referuar protestave dhe shtypjes së dhunshme, Dastasho mosht karde ("Ai shtrëngoi grushtat") është një dëshmi e dhunës së regjimit. Në këtë këndim të kthjellët me një sfond muzikor minimalist, artisti flet më shumë sesa rap-on. Toni i tij i ashpër shpreh zemërimin: «Ata nuk duan qytetarë, ata duan skllëvër, tingulli i të qarit po shpëton nga qelizat. Ai [protestuesi] dëshiron t'i japë fund dekadave të vrasjeve dhe plaçkitjeve, ata e bënë atë të qajë për vite me radhë dhe ai nuk ka më më lot për gazin lotësjellës (...). Ai bërret, kush do t'i harrojë këto krime? Jeta është vetëm në buzët e tij [jeta po e lë], dhe ai po ulërin... ». Në fund të këngës, dëgjohet klithmat zemëruese dhe të panikuara të demonstruesve: «Ata po qëllojnë njerëz! "Policia po sulmon, nuk ka turp!», "Mos ki frikë! Përpiqet të qetësojë situatën zëri i një burri, përpara se të mos dëgjohej më asgjë.

Larg vendit të tij, "kumbari" i repit persian e merr me lehtësi rolin e tij si zëdhënës i një rinie që pret më kot për hapjen politike të regjimit. Ai gjithashtu kujdeset që asnjëherë të mos merren kapet nga kundërshtarët e huaj të Republikës Islamike dhe preferon të mos jetojë në "Tehrangeles". Marsin e kaluar, Festivali i Tantara në Al-Ula të Arabisë Saudite, mirëpriti yjet e popit losanjelesi si këngëtar i njohur Ebi, në vitet e shtatëdhjeta e tij dhe ylli në rritje Arash Labaf. Duke i parë ata të performojnë para Princit të Kurorës, Mohamed Ben Salman (MBS) në këtë mbretëri "armi-ku", ka skandalizuar më shumë se një iranian. "A nuk kanë më asnjë gram nacionalizmi?! Rebeluan shumë përdorues të Internetit për të cilët armiqësia ndaj regjimit që disa mendojnë se nuk duhet të çojë në shoqërimin me sauditët, amerikanët ose izraelitët.

*Gazetar

KULTURË

Për çka shërbejnë artistët?

Prej shekullit XIX, artistët brengosen se a do të mund të jetojnë nga puna e tyre dhe për rolin e tyre në shoqëri. Një pyetje që e bën edhe shoqëria. Parazitë të inspiruar? Ofrues të një suplementi për shpirtin? A e ka artisti veçori që mund ta bëjë atë të dobishëm dhe të përdorshëm?

NGA EVELYNE PIEILLER

Fenomenal: politikanët tanë e shohin sot artin me një sy shumë të mirë. Si duket kjo është madje edhe zgjidhja, mrekulli e problemeve të shkaktuara ose të zmadhuara nga « kriza » sanitare dhe sociale e sotme. Ne jse, mos ta teprojmë, kemi të bëjmë më shpesh me artin dhe kulturën, çkado që kuptojmë me këtë.

Por, megjithatë, ky është një moment i çuditshëm. Më 2 maj, si përgjigje ndaj një vështrimi me titull « Kultura e haruar » (Le Monde, 30 prill) i nënshkruar nga shumë artistë të famshëm, Presidenti Emmanuel Macron bëri një postim entuziast në Twitter : «E ardhmja nuk mund të shpiket pa imagjinatën tuaj». Më 6 maj, si përfundim të një takimi me disa artistë të tjerë, ai pohoi fuqimisht se do ta inicioi një program porosish publike (pranë të rinjve, kush e di pse...) dhe që « krijimtaria artistike është diçka esenciale që i është paraqitur ndoshta edhe më fuqishëm qytetarëve tanë përgjatë kësaj kohe ». Gjuha është ngurruese, ideja është e fuqishme. Zaten, gjatë gjithë kohës së izolimit përgjatë pandemisë i janë bërë lavdërat plotë emocione fuqive të artit.

« Ajo që ata bëjnë nuk quhet punë »

Arti përshëndetet si i dobishëm. Madje kërkohet për operacionin presidencial të «verës edukative dhe kulturore», që ka për qëllim t'i « rivendosë artin dhe kulturën në zemër të jetës së të rinjve dhe të familjeve të tyre, qysh prej verës », siç e lexojmë në websajtet e Ministrisë së Kulturës dhe të Ministrisë së Arsimit dhe të Rinisë. Një shembull, për ta bërë më të qartë : Teatri i Odeon -Teatër i Evropës, ofron shfaqje rreth « femrave të Molière » ose të Një Mijë e Një Net. Si edukues dhe agjent i lidhjes shoqërore, artistit i jepet një vend në mesin e profesionistëve të dobishëm, madje edhe të domosdoshëm.

Kjo çështje e dobisë shoqërore, e cila mund të merr përgjigje ekstremisht të ndryshme, nuk është shtruar ende, qoftë për artistët, apo edhe për financuesit e tyre ose më gjërësisht për publikun. Me shekuj, roli i tyre nuk është vërë në pyetje : pranojnë porosinë e para nga të fuqishmit dhe me veprat e tyre i këndojnë lavdisë së tyre. E bëjnë më të ndieshëm shkëlqimin e tyre, tregojnë madhësinë e një bashkësie kombëtare ose fetare, madje edhe të një klase në ngritje, edhe përmes argëtimit. Piktore, autorë dramash, apo muzicentë; ata nuk kanë shqetësime shpirtërore. Por kjo nuk i pengon të kenë probleme parash dhe të ego-s nëse largohen financuesit. « Krijues » ose « artizanë », ata e gjejnë vendin e tyre në shoqëri. E bëjnë një punë për të cilën rralleherë e ndjejnë nevojën të arsyetohen ose të thurin teori, përveç përpara artistëve si vet ata, siç e bëri Pierre Comille për Sidin (Le Cid) para sulmeve të Akademisë franceze e cila konsideronte se vepra kishte marrë tepër liri ndaj vërtetësisë dhe se ishte pak shokuese për moralin.

Shoqëria nuk pyet fort për

arsyeshmërinë e ekzistencës së artistëve. Duhet të pritet në fakt shek.XIX që shoqëria dhe vetë artistët ta parashtrorin pyetjen se pse krijojnë, nga kush dhe pse mund të paguhen. Porosibërësit e Rëzhimit të Vjetër (Ancien Régime) ishin zhdukur krejt. U krijuan rrjete të reja të shpërndarjes, vlera të reja gjithashtu, sa estetike, ashtu dhe morale. Për opinionin dominues, siç do ta definoj me dashakeqësi, por duke mos u çuditur shumë, Fjalori i Paragjykime (Le dictionnaire des idées reçues) të Gustave Flaubert-it, Arti tanimë « çon në spital, përndryshe, në mjerim », kurse Artistët : « ajo që ata bëjnë nuk quhet punë ».

Po dominon një ndjenjë e keqe tek artistët. Çdo herë e më të shumtë, çdo herë e më shumë subjekt i miratimit të shumicës, nëse duan « të kenë sukses », ata mendojnë : të punojnë për « borgjezët » të cilët nuk i duan ? Për popullin që s'ka të bëjë me këtë punë ? Në një botë që i jep përparësi të dobishmes dhe fitimprurjes, pse duhet kërkimi falas i idealit të së bukurës? Atëherë do të zhvillohen qëndrimet e « artistit të mallkuar, të të paktuarit, edhe të atij i cili strehohet në 'kullën e tij të fildishtë', duke e vërë përpara « padobishmërinë » e tij, i cili është i destinuar vetmisë së madhe të artit për art, derisa po thellohet një hendek midis novatorëve dhe publikut ».

Sikur Honoré Daumier apo Camille Pissaro të cilët shkruanin në gazetë, apo Gustave Courbet i cili organizonte vetë ekspozitën e veprave të veta, të ndryshme nga përzgjedhja zyrtare të refuzuar në Ekspozitën Universale të 1855, sikurse Vicor Hugo i cili do të duhet të zgjedh të shkruaj për popullin, të gjithë artistët e shek.XIX të madh nuk lavdërohen që janë të padobishëm, që nuk vyejnë më, apo që janë anëtarë të një elite e cila merret vetëm me kërkimin e vet. Por kjo pozitë e tërheqjes aristokratike, të mospranimi të masës dhe nga masa, e shtyrë nga kuadri politik dhe social e pastaj e teorizuar, sikur e bashkëshpikur në një lojë pasqyreje, nga publiku i cili tërhiqet dhe nga artistët të cilët i marginalizojnë, dëshiron ta rrenjos për një kohë të gjatë një imazh të artistit si parazit pak a shumë të inspiruar, ndryshe nga qytetarët e tjerë, të cilët puna dhe talenti i tij eventual e vëjnë « anash ». Pra, një imazh të artit, mundësisht i cili nuk është fitimprurës si një « suplement i shpirtit ». Gjë që megjithatë tregon se jemi afër së panevojshmës, edhe pse është e mjegull në një mënyrë gracioze.

« Me kërkesë të qytetarëve »

Megjithatë, në momente të veçanta të historisë kolektive; qeveri, shoqëri, piktore dhe shkrimtarë do ta ndërmarrin definimin dhe shpjegimin e dobishmërisë së artistëve. Në plane të ndryshme. Kështu, ata rizbulojnë para pak kohë New Deal-in, në gojë e udhëheqësve dhe përcjellësve të vendimeve të tyre. New Deal rezulton përmjërherë si një model për kohërat tona të « krizës ». Është e vërtetë se tronditëse ishte kjo situatë



e re e lansuar nga presidenti Franklin Delano Roosevelt prej 1933 e cila do të zgjas deri në luftë. Artistët u konsideruan si punëtorë, të cilët kishin shkathësi të veçantë të cilat mund të paguheshin si të tilla. New Deal mundësoi të angazhoheshin aktorë (13 000), shkrimtarë (7000), muzicentë (2500)... të cilët ishin të gjithë të ngarkuar me një mision për interes të përgjithshëm: ta bëjnë edukimin popullor, të animojnë grupe amatorësh, të propozojnë teatër aty ku nuk kishte, të regjistrojnë muzikat negro të Jugut, të mbledhin rrëfimet e pasardhësve të skllëvërve, të zbukurojnë lagjet me freska (2500) në frymën e artistëve meksikanë të muraleve si Diego Rivera ose David Siqueiros, të shkruajnë historinë e qyteteve, të dëshmojnë me fotografi për Depresionin e Madh, etj. Ishte diçka e pabesueshme.

Prej Orson Welles te piktori Jackson Pollock, fotografët Dorothea Lange dhe Walker Evans deri te shkrimtarët Richard Wright, Saul Bellow ose John Steinbeck, një pjesë e mirë të atyre që janë gjithmonë të dobishëm punojnë për këtë mision. Veçoria e tyre është në shërbim të interesit kolektiv. Jemi larg suplementit të shpirtit dhe të vetmisë së ekscentrikut të inadaptuar. Ky integrim i artistit me greva masovike në industri në prapavijë, marshe të urisë, të kërkesave të paraqitura ndër të tjera nga një Parti komuniste shumë aktive, arsyetohet me një qëllim ekonomik – të ulët numri i të papunëve – dhe me vullnetin që t'i jipet vendit një kulturë të madhe nacionale. Rezultatet do të jenë të çuditshme, ku do të takohen aktorë -punëtorë dhe komedia muzikore, ku do të zgjerohet piktura rajonaliste, ku do të shumëzohet konfrontimi i profesionistëve dhe i amaterëve, apo edhe ku do të lulëzoj estetika e inspiruar nga Bertold Brecht.

Ata po punojnë për kombin – disa po mendojnë të punojnë për popullin – dobia e tyre njihet pa kundërshtim (25 milion amerikanë po e zbulojnë teatrin), por kjo shumë shpejt do t'i duket tepër e « kuqe » anëtarëve të Komisionit mbi Aktivitetet Antiamerikane, në kohën e maccartizmit.

Dhe saktësisht në të njëjtën kohë, hapet një rrugë e re në Bashkimin Sovjetik për t'i përcaktuar detyrat që do t'ia japin artistit të drejtat e tij : ai do të duhet ta ndjek doktrinën e realizmit socialist. Në vitin 1934, në Kongresin e parë të shkrimtarëve sovjetikë, statuti i shoqatës së tyre do ta definojë këtë etikë : « Realizmi socialist, si metodë themelore [...] kërkon nga artisti një paraqitje reale, historikisht konkrete, të realitetit në zhvillimin e saj revolucionar. Me karakterin historikisht konkret dhe të vërtetë, të paraqitjes së tij të realitetit, ai duhet të kontribuojë në transformimin ideologjik dhe në edukimin e punëtorëve në shpirtin e socializmit ». Duhet gjithashtu me qenë i dobishëm, këtu, në ndërmarrjen revolucionare, por me përshtatjen e formës dhe përmbajtjes. Përdërisa New Deal është harruar deri sot kur është bërë shembull, nuk është harruar ky legjitimim i artistit nga politika, konsideruar si një përlule e lirisë së krijuesit ndaj normave dhe qëllimeve ideologjike. Diskreditimi i tij vazhdon të jetë kumbues. Megjithatë mund të pyetet, çfarëdo qofshin meritat e mëdha të New Deal : çfarë vendi i mbetet « lirisë së krijuesit » kur për të marrë pagë, ai duhet të jetë në shërbim të kombit?

Si të evitohet që artisti të njihet si i dobishëm për shoqërinë, pa i kërkuar, sipas zgjedhjes apo në tërësi, të kontribuojë për madhësinë e vendit, të edukojë popullatën, të shërbejë për kohezionin e saj, të merr pjesë në një vullnet kolektiv, gjë që mund të implikojë që duhet të kufizohen aspiratat, të preket ajo që e ka më intime? « Sponsorët e Rinj » po mendojnë se e kanë zgjidhjen. E filluar në vitin 1991 nga fotografi François Hers, e mbështetur nga Fondacioni i Francës, e inkurajuar nga sociologu Bruno Latour, kjo lëvizje dëshiron ta ndihmojë lindjen e një « Arti të demokracisë », sepse siç e thotë historiani i artit Thomas Schlessler, si përgjigje fjalëve të Presidentit mbi porosinë që do të bëhen, « qëllimi nuk mundet të jetë tani e tutje vetëm mbështetja e ofertës krijuese të artistëve, arkitektëve, kompozitorëve ose shkrimtarëve. Në demokraci, qëllimi duhet të jetë ai i cili i përgjigjet kërkesës së qytetarëve ». Me qëllim, për shembull, që « një vend ose një aktivitet i pavërtetur të bëhet i dukshëm, t'i jipet jetë një

kujtesejë, të materializohet një përkatësi identitare, të përmirësohet një kuadër jetësor ». Një protokoll diskutimi dhe negociata nisët me artistin e propozuar nga një ndërmjetës (artistët Daniel Buren ose Xavier Veilhan, arkitekti Patrick Bouchain...). Gjë që « supozon nga ana e tij një vëmendje të mirë dhe pranimin e një horizontaliteti të vërtetë ». Kështu ka lindur pas kërkesës së nëntë banorëve të lagjës, zemra që rreh në maje të një direku tek metra i lartë, që shkëlqen në të kuqe të Porte de Clignancourt në Paris – vepër e artistes portugeze Joana Vasconcelos. Në këtë « art të demokracisë », nuk « i takon më ministrisë të bëjë politikë kulturore, por neve – qytetarë dhe qytetare, neve artistëve që ta udhëheqim bashkë », me detyrim që ministria ta ndërtoj një « sistem delegimi për ndërmarrjet private. » Mund të vëjmë bast që ky model i promovuar nga një institucion i së drejtës po aq private, ka perspektivë të mirë : e fton artistin që të përqafojë tema të zgjedhura nga ideologjia dominuese, e shenjtuar nga « qytetaria » dhe horizontaliteti, gjë që lejon që t'i jepet fund parimit të politikë publike, e fton porositesin e ri të zgjedh brenda një katalogu artistësh të pranuar mirë nga tregu. Prej klienti te ofruesi i shërbimeve, artisti është një zbukurues i cili i përgjigjet një kërkesë lokale të « care ».

Në vitin 1935, pra në kohën e fashizmit, nazizmit, të fillimit të mizorive të mëdha të Stalinit, dhe të agimit të Frontit popullor, mbahej në Paris Kongresi ndërkombëtar i shkrimtarëve për mbrojtjen e kulturës, me 230 pjesëmarrës, prej të cilëve një numër i madh të ekziliuar (Bertolt Brecht, Ernst Toller, Heinrich dhe Klaus Mann, etj.). Ata diskutuan mbi kuptimin e punës së tyre në atë moment. Për kënd, për çka... Të eksperimentoi, të iluminoi ? Të zgjedh intimen ose politikën ? Ndoshta filozofi Ernst Bloch profilizoi një përgjigje : « Ka mbetur në botë, një pjesë e madhe si ëndërr që nuk është përjetuar ende, historia që nuk është elaboruar ende, natyra që nuk është shitur ». Të bëhet të ndihet ajo që na mungon dhe të zgjerohet dëshira për të, kjo është lartësisht e dobishme. Për të gjithë.

Lianke, të bërit letërsi midis censurës dhe autocensurës

Paraqitja e historisë dhe realitetit kinez, me një gjuhë të mbrehtë e të thellë, satira dhe alegoria krijuese, si dhe guximi për t'u përballur me tema të vështira të 'realitetit të padukshëm', kanë bërë që disa nga veprat e shkrimtarit më të njohur e më të diskutueshëm kinez Yan Lianke të ndalohen. Lianke është i vetëdijshëm që ai i cili zbulon të vërtetën - apo thjesht realitetin - mund ta paguaj edhe me vdekje, sikurse në tregimin e shkruar enkas për « Le Monde Diplomatique ». Prandaj, si metodë mbijetese, që të shmangë censurën, Lianke ka zgjedhur ndonjëherë autocensurën.

NGA YAN LIANKE*

Djali shkante në qytet.
Kah lindja, në agimin e ditës së re.
Pushimet e verës shpërthenin si djersa.
Një ditë më herët, ora e fundit e shkollës që shumë e thjeshtë, sikur një problem matematikor i zgjidhur qysh gjatë leximit të detyrës.

Fundi i orës.
Pushimet fillonin.
Djali vrapoi drejt jashtë klasës. Në hyrje të shkollës, muri i lajmërimeve ishte i mbuluar me copëza letrash. Te njëra ishte shkruar: "E dashur xxx, të dua kaq shumë sa që çdo mbrëmje po detyrohem ta kryej vetë atë punë". Në një tjetër: "Zhang, ende nuk m'i ke kthyer tre yanet që m'i huazove gjatë semestrit!". Në mesin e gjithë këtyre copëza letrash, ishte një, ngjyrë kuqe e mbyllët, e cila mbante të shkruar me laps kimik me ngjyrë të zezë dhe të trashë, një fjali të panjohur, në anglisht: « I fuck your mom ».

Ky rresht shkronjash i shkaktoi efektin e një fluturim patash të egra që vinin drejt tij. Pasi e lëshoi çantën e shkollës, shkoi në pjesën e mbrapme të fshatit, te mësuesi. Mësuesi po i ushqente demat. Djali ia zgjati letërën e kuqe, mësuesi e lexoi dhe u skuq para se t'i thotë tri gjëra:

— Nuk e di fare se çka do të thotë kjo fjali. Nuk ka nevojë ta pyesësh dike tjetër se çka do të thotë kjo; ash-tu-kështu vitin e ardhshëm kalon në klasën më të lartë dhe do ta mësosh anglishten."

Vërejtja e tretë që vetëm një rekomandim insistues, denisa sa e ndalte djalin që kthehej në shtëpi.

— He! Kunsesi mos e pyet askënd, kjo fjali sigurisht nuk është e mirë për t'u dëgjuar!

Djaloshi edhe më shumë donte të merrte vesh. Edhe më shumë kishte dëshirë të dinte se çka do të thoshte "I fuck your mom!". Të nesërmen, vendosi të shkoi në qytet për ta pyetur profesorin e anglishtes. « U zgjua herët, hëngër mëngjesin që ia kishte përgatitur nëna, mori paratë e xhepit që ia kishte dhënë babai dhe denisa dielli po ngriste flamurin, doli nga shtëpia. Eci disa lis[1], mbënjiti të muga e majës së malit për të prituri te një dru sophora të moçëm një autobus fshatash. Në atë çast, një grup mollëkuqesh kaloi para tij, të shpejta sikur vetëtimat, e pastaj u sollën ca flutura. Mendoi atëherë se më mirë ishte të ecte. Kur ecën në këmbë, mund ta shikosh peizazhin. E kështu shkoi, ngadalë-ngadalë, deri te hyrja e qytetit. Më në fund, ju duk se po e përqaftonte Idealin. Ndërtesa të larta, shtëpi të reja dhe porta e madhe mbi një bulevard të gjatë. Dhe restorante përkajmë murgës, pazardhe tregtarë të shpërndarë. Ky ishte pikërisht destinacioni i tij. Edhe pse ishte i maskapitur, veç ideja që do ta gjente së shpejti profesorin e anglishtes e bënte që të mos e ndjente lodhjen më. E nxori copëzën e letrës së kuqe nga xhepi, ia hodhi një sy, dhe i siguruar që letra me fjalinë: "I fuck your mom" ishte aty, e kaloi portën. Nja dhjetë metra më larg, pa një

grua të re që shiste funde. E pyeti nëse e dinte adresën e profesorit të anglishtes; ajo ju përgjigj se jo. Në atë çast, një burë i ri doli nga mbrapa saj duke bartur një valixhe fundesh të cilën e lëshoi në tokë para se ta pyeste:

— Zotin Zhao, profesorin e anglishtes, po e kërkon?

Djali hapi sytë.

— Është kushëri im. Shtoi se ishte e kotë të kërkohet në shtëpi, sot ishte ditë tregu, profesor Zhao ishte sigurisht në Botërorin e teknikës së bardhë, në mugën e dytë. I tha djalit që të shkoj atje. Djali u hamend dhe u drejtua kah vendi të cilin ia kishin përkshuar. Një bulevard i gjatë dy lisa në fund të së cilit e gjeti dyqanin. Profesori i anglishtes gjendej vërtet aty. Ai ishte pronari i dyqanit, dhe nëse vëllai dhe kunata e mbanin atë zakonisht, zoti Zhao minte mbrapa banakut gjatë pushimeve të verës. Ai ishte një burë dyzetvjeçar, i një gjatësie mesatare, i veshur me një këmbishë të bardhë, flokët e shkurtra të prera afër, kishte të mbathur këpuce të lëkurës të vjetra dhe të pista, një palë xhinse vjetërsia e të cilave nuk mund të përcaktohet, të njëjta sikur kur shkante në shkollë. Dyqani ishte i përbërë nga tri dhoma, raflet ishin përplot tenxhere ekspres elektrike, bokallë, llamba, prizat. Mbi dysheme, përgjatë mureve, televizorë të madhësive të ndryshme, të prodhuar në Kinë ose të importuar. Një adoleshent, pak më i madh se protagonistin jonë, shkante dhe vinte para kasës, i humbur. Profesori i anglishtes fliste me një çift pleqsh para një televizori të madh qmiminë të cilit e bisedonin.

Djali hyri në dyqan

Qëndroj i turpëruar te pragu. Nuk lëviz, duke prituri me durim që profesori dhe personat e moshuar të mbarojnë bisedën. Në fund, çifiti nuk e bëri blejen, profesori i përcolli deri te dera, u kthye dhe e pyeti djalin që e shikonte duke u skuqur:

— Dëshiron të blesh diçka?

— Vj nga shkolla e qytetit.

Ia zgjati letërën e palosur në katërsh dhe shtoi:

— Desha të ju pyes se çfarë domethënie ka fjalia e shkruar në gjuhën angleze në këtë letër.

Profesori e mori letërën, e shpalosi. U zbeh lehtë, fytyra ju tendos. E pyeti djalin se kush ia kishte shkruar këtë fjali. Djali u përgjigj se e kishte parë këtë fjali një ditë më parë, para se të dal në pushim, në murin e lajmërimeve në hyrje të shkollës.

Profesori e shikoi drejtë në sy dhe pyeti prapë:

— Vërtet nuk e di se çka do të thotë kjo fjali?

— Do të filloj të mësoj anglisht tek në gjysëmvetorin e ardhshëm.

Profesori ia ktheu letërën.

— Pra do ta kesh përgjigjen



gjysëmvetorin e ardhshëm.

Djali refuzoi ta marr letërën, ngriti pak zërin, u bë insitues:

— Kam ardhur enkas për t'ua shtruar pyetjen, kam ecur njëzet lisa!

Profesori dukej si në dyshim, sytë u drejtuan, të ngritë, mbi fytyrën e fëmijës:

— Njëzet lisa?

— Njëzet lisa.

Kjo replikë e fundit i pëlqeu djalit. E pa në fytyrën e tij që profesori ishte i habitur dhe i pafuqishëm, kështu që vazhdoi: « Kam ardhur në qytet gjithashtu për të blerë libra. »

Tani i qetësuar, profesori ia përkëdheli pak kryet dhe i tha: "Pasi që duhet të shkosh në libran, blejë gjithashtu një fjalor anglisht-kinezisht, aty do të gesh se çka do thotë kjo fjali." Ai shtoi: « Nuk e kam fjalorin me vete, vërtet nuk e di se si të ta përkthej si duhet këtë fjali. » Pastaj, e palosi letërën dhe e lëshoi në dorë të djalit. »

Djali doli nga dyqani paksa i humbur dhe u ndal, i hutuar, te pragu. Në mugë, një tumë njerëzish shkante në treg, vapa e muajit qorshor zgjatej dhe avuj djersje përveçse kaplonin botën. U hamend dhe ngadalë eci mugës në drejtim të librarisë. Dhe pënjehë, dikush erdh mbrapa tij dhe i mësoi krahut.

U ndal. U kthye. Pa adoleshentin që ishte në dyqan më herët. Më i gjatë se ai për pesë centimetra dhe më i madh, si dukej, për tri apo katër vjet.

« E di se çka do me thanë fjalja që ia tregove profesor Zhaos » i tha duke ia zgjatur dorën që të ia jepte letërën e kuqe. Djali ia dha. Djali i madh e çeli dhe fytyra e tij u ndriçua nga një buzëqeshje të çuditshme: "Do të të tregoj se çka do të thotë kjo fjali por duhet të ma blesh një shalqi."

Djali e shikoi.

Djali i madh shikoi përreth dhe e tërhoqi në skaj të mugës. Aty ishte një tezgë me shalqinj. Shtësi ishte pikërisht duke i shikuar për t'i lëshuar në tokë. Mbi një tavolinë të vendosur para makinës së tij gjendej një frut i cili sapo ishte prerë dhe nezatonte një shkëlqim të kuq sikur një diell i cili ngritët mbi malet. Adoleshenti zgjodhi me shkathtësi një shalqi te tezza, ia zgjati shtësit që ta peshonte, e la djalin që të paguante tri yuan dhe njëzet cent, dhe pastaj e tërhoqi anash:

— Kjo fjali do të thotë: Ta qifsha nanën

Djali e shikoi i habitur, sikur nuk e kuptonte.

Djali i madh e përsëriti shumë seriozisht:

— Po, po! Do me thanë "Ta qifsha nanën"!

Nga frika se djali nuk e besonte, për të tretën herë, e rilexoi fjalinë në anglisht dhe e përsëriti përkthimin: « Ta qifsha nanën ». Djali vazhonte thjesht ta shikonte, me një dridhje të lehtë në skaj të buzëve, dhe kur djali i madh ia zgjati letërën për t'i a kthyer, u kthye kah tavolina, kapi thikën e shalqint dhe ia nguli, pënjehë, në bark. Çdo gjë shkoi kaq shpejt sa që askush nuk pati kohë ta kuptoj se çka po ndodhte. Djali i madh nuk ndjehi asnjë dhimbje, tregoj një farë habie përballë kaljes që kishin marrë gjërat, lëshoj një « Oh » të lehtë, lëshoi pemën dhe u rëzua, me gjunjë në tokë. Toka u skuq me një pellg, ku nuk mund të dallohej a ishte e gjakut apo e lëngut të shalqinj.

Sapo e futi thikën, djali u largua, pa ngut. La skajin e mugës për t'u futur në tumën e njerëzve, aq sa një pikë që bie nga kulmi të prek tokën.

Ishte muaji qorshor, vapa bëhej edhe më përveçse. Bota kundëmonte një ere qelbësire. Në kohën e drekës, djali hipi në autobus për t'u kthyer në shtëpi. Prindërit që hanin në oborr e pyetën pse po kthehej kaq herët, a nuk kishte shkruar në treg?

Djali u përgjigj se kishte tepër njerëz në qytet, që s'ia vlenite, dhe hyri në kuzhinë ku mori një tas ujë të ftohtë të cilin e piu me ëndje. Kur doli prapë në oborr te prindërit, një zhumë e akullt dhe e çjerrtë u dëgjua te hyrja e fshatit: ishte bilbili i policëve me motor. Dëgjohet edhe zhumat e hapave të fshatarëve që vraponin pas. Motoristët sikur vini këndej. Babai dhe nëna e tij zgjatnin veshin, plot kureshtje, por djali, me një re të bardhë mbi fytyrë, sikur ndjehi që kërcëno në kokën e tij gjarpri i një fjalie që e kishte mësuar disa ditë më herët. Atëherë me një buzëqeshje të ngritë, tha në anglisht: Dad, mom: I love you [2]

Pekin, 20 maj 2020[3]

* Shkrimtar. Ka shkruar ndër të tjera "Të shërbehët popullit", "Një këngë qiellore" dhe "Vdekja e diellit", të gjithë të botuar te botuesi Philippe Picquier, Arles, me 2018 (ribotim), 2019 dhe 2020.

[1] Li-u është njësi matëse kineze e barabartë me 500 metra

[2] « Bab, Mam, ju dua! »

[3] Shqiptimi i kësaj date në kinezisht është shumë afër me themënin "Të dua". Me zhvillimin e internetit, që disa vite, kinezët shprehin dashurinë e tyre me 20 maj.

REDAKSIA E BOTIMIT NË SHQIP
Botues: Instituti "Musine Kokalari" - Prishtinë (Kosovë)
Drejtor: Belgzim Kamberi
Kryeredaktor: Ardit Rada
Redaksia: Leart Kola, Shkodran Hoti
Përkthimi: Lemane Muriqi, Nerimane Kamberi, Bora Deda, Belgzim Kamberi
Layout design: Josif Xhemali
Email: botadiplomatiqe@gmail.com

Édité par la SA Le Monde diplomatique.
Actionnaires: Société éditrice du Monde, Association Gunter Holzmann, Les Amis du Monde diplomatique
1, avenue Stephen-Pichon, 75013 Paris
TEL: 01-53-94-96-01. Télécopieur: 01-53-94-96-26
Courriel: secretariat@monde-diplomatique.fr
Site Internet: www.monde-diplomatique.fr

Directeur: Serge HALIMI, président, directeur de la publication
Autres membres: Vincent CARON, Bruno LOMBARD, Pierre RIMBERT, Anne-Cécile ROBERT
Directrice des relations et des éditions internationales: Anne-Cécile ROBERT
Secrétaire générale: Anne CALLAIT-CHAVANEL

Directeur de la rédaction: Serge HALIMI
Rédacteur en chef: Benoît BRÉVILLE
Rédacteurs en chef adjoints: Martine BULARD, Renaud LAMBERT
Cheffe d'édition: Mona CHOLLET
Rédaction: Akram BELKAID, Philippe DESCAMPS, Evelyne PIEILLER, Hélène RICHARD, Pierre RIMBERT, Anne-Cécile ROBERT
Cartographie: Cécile MARIN
Site Internet: Guillaume BAROU, Thibault HENNETON

Conception artistique: Maria HERARDI, Boris SÉMÉNIAKO (avec la collaboration de Delphine LACROIX pour l'icongraphie)
Rédacteur documentaliste: Olivier PRONET
Mise en pages et photographie: Jérôme GRILLIÈRE, Patrick PUECH-WILHEM
Correction: Xavier MONTHEARD, Sarah ZHIRI

Directeur de la gestion: Bruno LOMBARD
Directeur commercial, chargé de la diffusion numérique: Vincent CARON
Contrôle de gestion: Zaita SAHALI
Secrétariat: Yuliya DAROUKA (9621), Sophie DURAND-NGÔ, attachée communication et développement (9674), Eleonora FALLETTI (9601)
Courriel: prenom.nom@monde-diplomatique.fr
Fondateur: Hubert BEUVE-MÉRY. Anciens directeurs: François HONTI, Claude JULIEN, Ignacio RAMONET

Publicité: Hélène FAVERIE (01-57-28-38-03)

Diffusion, mercatique: Brigitte BILLIARD, Saveria COLOSIMO-MORIN, Sophie GERBAUD, Sabine GUDE, Carole MERCERON, Christiane MONTILLET
Relations marchands de journaux (numéro vert): 0805-050-147
Service relations abonnés
● Depuis la France: 03-21-13-04-32 (non surtaxé) www.monde-diplomatique.fr
● Depuis l'étranger: (33) 3-21-13-04-32

Reproduction interdite de tous articles, sauf accord avec l'administration
© ADAGP, Paris, 2019, pour les œuvres de ses adhérents
Prix de l'abonnement annuel à l'édition imprimée: France métropolitaine: 59 €
Autres destinations: www.monde-diplomatique.fr/abo

FAQE 2
U dridh mali, polli miul, **NGA VISAR YMERI**

FAQE 3
Lufta njëzetvjeçare? **NGA SERGE HALIMI**
Haxhi, nafta tjetër e sauditëve **NGA MOHAMED LARBI BOUGUERRA***

FAQE 4-5
Tingujt e tranzicionit **NGA SHKODRAN HOTI**

FAQE 6
Konformizmi i artistëve ndaj së kaluarës socialiste, **INTERVISTOI: NIKOLLA RADIQ**

FAQE 7
Drejt paradigms së ekonomisë qarkulluese, **NGA DITJON BABOÇI**

FAQE 8-9
Konspiracionet ballkanike dhe shteti-komb, **NGA SINISHA MALLESEHEVIQ***

FAQE 10-11
Borgjezia intelektuale, një elitë trashëguese, **NGA PIERRE RIMBERT**

FAQE 12-13
Popullistët amerikanë kundër lobit të mjekëve, **NGA THOMAS FRANK***

FAQE 14
Në origjinën e shtypit arab, **NGA ARTHUR ASSERAF ***

FAQE 15
"Terrorist" një herë, terrorist gjithmonë?, **NGA PIERRE CARLES***

FAQE 16-17
Izolimi në qytetet sekrete të atomit sovjetik, **NJË REPORTAZH NGA CHRISTOPHE TRONTIN***

FAQE 18
Të jesh këngëtar në Iran, **NGA KORRESPONDENTJA JONË NË IRAN THELMA KATEBI***

FAQE 19
Për çka shërbejnë artistët?, **NGA EVELYNE PIEILLER**

FAQE 20
Lianke, të bërit letërsi midis censurës dhe autocensurës, **NGA YAN LIANKE***

PËRMBAJTJA
GUSHT 2020